

Viti XXI - Nr.220 • Shtator 2009 • Ramadan/Shawwal 1430 h • Çmimi 50 den

ehëna

Revistë kulturore informative islame

www.bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk



**Mesazhi i Reis ul Ulemasë
me rastin e Festës
së Fitër Bajramit 2009**

Faqe 2



**Përshesh puna me
enciklopedinë**

Faqe 29



**Haxhi kërkim i
identitetit shpirtëror**

Faqe 48

Mesazhi i Reis ul Ulemasë me rastin e Festës së Fitër Bajramit 2009

Bismil-lahir-rahmanir-rahim

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqia dhe të besoni Allahun...”(Suretul Ali Imran: 110)

BESIMTARË TË NDERUAR, VËLLEZËR DHE MOTRA

Falënderojmë Allahun xh.sh. që na mundësoi ta përcjellim këtë muaj të kënaqësisë dhe bukurisë së përgjithshme, për të gjithë ne që shprehëm dashurinë dhe besimin tonë të sinqertë e të paskajshëm ndaj Allahut xh. sh., Krijuesit të të gjitha botërave.

Me këtë Festë të Bajramit besimtarët muslimanë në tërë Botën shënojnë fundin e muajit të Ramazanit, muajit që paraqet periudhën më të ndritshme të hixhrit, gjatë të cilit me plot përkushtim bëjmë përpjekje që ti afrohem sa më shumë Krijuesit tonë.

Solidariteti dhe ndihma ndërvëllazërore janë parime të Islamit, të cilat duhet afirmuar dhe realizuar në përditshmërinë tonë. Prandaj gjatë këtyre ditëve feste, duhet ti kujtojmë edhe ata që për shkaqe të ndryshme nuk mund t'i gëzohen tërësisht çasteve të lumturisë së përgjithshme.

Duke u mbështetur përherë në urdhrat e Allahut dhe në parimet esenciale të fesë Islame, ne edhe sot si gjithmonë do të jemi afër të varfërve, skamnorëve, të sëmurëve dhe të gjitha kategorive të tjera që kanë nevojë për ndihmën dhe zemërgjerësinë tonë, të pajisur me moralin Islam.

Si pjesëtarë të islamit, kemi



për obligim të jemi bartës të shpirtit të tolerancës. Kooperimi dhe bashkëpunimi ndërshtetëror duhet të jenë moto e jona me të cilat do të shprehim vlerat islame.

Në këtë ditë, ne duhet të jemi të bashkuar, sepse kemi zgjedhur shpresën në vend të dëshpërimit, kemi zgjedhur ta vazhdojmë rrugën të cilën na e ka plasuar Allahu i Plotfuqishëm, sepse në mesin ku nuk ka dhunë, vrasje dhe kidnapime, aty qëndron esenca e dashurisë.

Prandaj, veprimtaria e çdo muslimani duhet të inspirohet dhe mbështetet në mësimet e Kur'anit të Madhërishëm si dhe të mbështetet në drejtësinë Hyjnore, duke mos e injoruar asnjëherë përgjegjësinë personale. Në riafirmimin e madhësisë së Fesë tonë, ne e kuptojmë se kjo madhështi asnjëherë nuk dhurohet, por ajo duhet të meritohet.

Islami është fe e paqes dhe tolerancës, ndaj edhe predikon paqe dhe tolerancë, si dhe gjykon në formën më të ashpër dhunën dhe përdorimin e saj.

Andaj është larg çdo primitivizmi, dhe qëndron larg çdo fanatizmi, racizmi dhe padrejtësie. Islami i trajton të gjithë njerëzit njësoj, duke u bazuar në parimin se të gjithë janë njerëz dhe njeriu duhet të respektohet dhe ka të drejtën e jetës.

MIQ TË DASHUR,

Gjatë muajit të Ramazanit, përmes Kur'anit dhe namazit, përmes agjërimit dhe durimit tonë, përmes mirësisë dhe humanitetit, ne dëshmuam bindjet tona.

Si krijesa të Allahut të madhërishëm, ekzistojmë në një balancë të natyrshme mes Tij dhe gjithësisë, ku gjëja më e madhe në Botë nuk është se ku ndodhemi ne, por në çfarë drejtimi po lëvizim. Pikërisht për këtë gjë, çdo besimtar musliman duhet të jetojë në harmoni me vetveten dhe me të tjerët, me miqtë e me shokët, me bashkëkombësit dhe me ata që bashkëjetojmë.

Burgu më i errët për njeriun, është zemra e mbyllur. Prandaj le ti hapim zemrat, se

lumturia dhe gëzimi për shpirtin e njeriut vjen vetëm nga Allahu Fuqiplotë, i cili e drejton atë që e ka humbur rrugën, e ngushëllon njeriun që ka dhembje, i jep forcë të dobët dhe e shëron të sëmurin.

VËLLEZËR BESIMTARË

Duke ju dëshiruar gëzime dhe lumturi në këto ditë Bajrami, i ftoj të gjithë besimtarët muslimanë, si dhe të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, që të kultivojnë vlerat njerëzore e civilizuese, dashurinë ndaj familjes dhe miqve e fqinjëve, të respektojnë konceptin universal për lirinë e të nderojnë ndryshimet me të cilat na ka karakterizuar Allahu.

Njëkohësisht i lutem Allahut të na i pranojë ibadetet dhe të na udhëzojë në rrugë të drejtë, të na ndihmojë që edhe pas Bajramit të vazhdojmë të jetojmë me principet islame, bile edhe të rritim sasinë e veprave tona të mira.

Uroj që nga ky Ramazan dhe nga ky Bajram të dalim më të fortë dhe më të fuqishëm për të ndjekur rrugën e Allahut.

Me këtë rast përkujtojmë fjalën e Allahut të plotfuqishëm.

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun, Ai u ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja” (Suretu Muhammed:7)

Prandaj më lejoni që në emrin tim personal dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të gjithë muslimanëve tua uroj për shumë vjet Ramazan Bajramin – Me fat Fitër Bajrami!

Reis ul Ulema i BFI në R.M H. Sulejman ef. Rexhepi



ALBUM - ENCIKLOPEDIA

Këto ditë, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve (AMSHA) botoi një libër të titulluar “Enciklopedia maqedonase”, botim ky i cili hasi në reagime të ashpra, si nga subjektet e brendshëm ashtu edhe nga ata ndërkombëtare, për shkak të subjektivitetit, tendencës, shtrembërimeve të fakteve në përmbajtjen e tij.

Pa fije turpi, devijohet historia dhe kultura e shqiptarëve autokton të këtyre trevave, bile ata paraqiten si njerëz të maleve. Po ashtu pa fije turpi Bashkësia Fetare Islame, roli dhe veprimtaria e saj minimizohet në skajshmëri edhe pse gjysma e popullatës së këtij vendi janë me përkatësi islame. Minimizimi i këtillë është i qartë dhe i pritur, sepse ishte kjo Akademi dhe këta “akademik”, të cilët BFI-së dhe Kryetarit të saj, H. Sulejman ef. Rexhepit, para disa viteve, ia zunë për të madhe mbajtjen e seminarit për shqiptarët e Maqedonisë në SHMI “Medreseja Isa Beu” në Shkup dhe më pastaj botimin e librit “Shqiptarët e Maqedonisë” me materialin e këtij seminari. Skandaloze është edhe fakti se xhamitë me renome, siç është Burmali Xhamia në Shkup, dezinformohet se janë ndër-tuar mbi themelet e kishave!

Botimi i kësaj Enciklopedie është një skandal dhe turp i paparë aq më shumë kur kihet parasysh se të dhënat që janë përmbledhur në të janë pa asnjë bazë faktike, pa burim literature, pa kritere që e kërkon një punim shkencor i këtij lloji dhe të punuara nga autorë jo të profesionit, autorë të ngarkuar me nacionalizëm, të cilët punën e tyre e mbështesin në paragjykime dhe fiksiione.

Madje, po ta shikojmë përmbajtjen dhe dizajnimin e saj, do të shohim se ajo më së shumti i përngjanë një albumi se sa një enciklopedie. Përmbajta e saj është e mbushur me foto të personave të ndryshëm, ku më së shumti dominojnë politikan, spikerë, gazetarë e këngëtarë, puna dhe veprimi i të cilëve kualifikohet në mënyrë subjektive dhe në bazë të politikës ditore. Shumica e personave që fotoja e tyre është e vendosur në këtë album-enciklopedi ende janë të gjallë dhe se veprimtaria e tyre ende nuk ka përfunduar, që do të thotë dikush që kualifikohet si dashamirë në të ardhmen mund të jetë dashakeq i këtij vendi, dhe e kundërta. Pra, kjo është edhe një fakt që e zhvlerëson këtë Enciklopedi dhe plotësisht jep të drejtë që e njëjta të kualifikohet si album-enciklopedi, nga se gjatë përpilimit të saj nuk janë marrë për bazë kriteret shkencore dhe kriteret të cilat kërkohen për përpilimin e një vepre kaq të rëndësishme.

Deshi Zoti që përmes botimit të kësaj Album enciklopedie që edhe njëherë të dalë në shesh e vërteta mbi punën tendencioze të kësaj Akademie nga e cila vuajnë ata që nuk janë të klanit të tyre, që nuk i takojnë etnikumit apo konfesionit të tyre. Ajo ka bërë eksperimente të ndryshme, bënë dhe do të bëjë sepse “truri” i kësaj Akademie është diku tjetër, dhe se ky “tru” nuk pushon së punuarit deri sa të ekzistojë ky shtet i përbërë nga maqedonasit, shqiptarët dhe etnikumeve tjera. Faktori ndërkombëtar tanimë e ka të qartë se cilët qarqe punojnë kundër bashkëjetesës në vendin tonë.

Besojmë se kritika ende do ta thotë fjalën e vet për këtë album-enciklopedi dhe dita ditës do të kemi edhe reagime të shumta për gabime të natyrës së ndryshme bile edhe nga vetë maqedonasit. Andaj, më së miri është që kjo përmbledhje dezinformatash të tërhiqet, dhe t`u jepet në dorë profesionalistëve për përpilimin e një Enciklopedie e cila do t`i përshkruaj të dhënat në mënyrë objektive dhe reale.

REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME



Botues:
Rijaseti i BFI në RM



Redaksia:
Abaz Islami
Abaz Jahja
Skender Buzaku
Ibrahim Idrizi
Qufli Osmani
Shaban Sulejmani
Ismet Osmani
Driton Dikena
Agron Vojnika



Bashkëpunëtor:
Agim Mehmeti
Valbona Zunçe
Rejhan Neziri



Redaktori teknik:
Halil Berisha



Telefonat e redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk
e-mail: bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen


P ë r m b a j t j a




8

INVESTIMI I GARANTUAR PËR ARDHMËRINË

ME MERCENARË S`MUND TË PËRMBYSET ISLAMI TRADICIONAL



30



STRATEGJIA E HUAJ PËR DEFORMIMIN E TRADITËS ISLAME

32



TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS SHERIATIT


35

MENDO MIRË PARA SE TË FLASËSH



37

KOCKA DELIKATE- FENOMENI I RILINDJES



41

Një iftar me Presidentin
Ivanov ...6

Islami në Maqedoni është
praktik, e jo vetëm teorik! ... 9

Hidhet gurr-themeli i sallës
sportive në Kumanovë ... 9

Vizitë qendrave Islame në
Gjermani ... 10

Vatër e edukimit fetar dhe
kombëtar ... 13

Informatë ... 14

Bashkatdhetarët dhe Islami në
Evropë ... 15

Nata, në të cilën filloi të zbret
fjala hyjnore ... 18

Ripërtërirja e vlerave fetare
dhe shoqërore ... 19

Drejtuar: Besimtarëve në vend
dhe Diasporë ... 21

Manifestimi i festës së Fitër
Bajramit ... 22

Tradita e bakllavës në BFI ...
23

Mirënjohje për vigjilencën ...
24

U shënua dita e shtetit të
mbretërisë së Arabisë Saudite
në Tiranë ... 24

Islami na fton në dituri .. 25

Reportazh me Qendrën Islame
Shqiptare të Çikagos ... 27

Përshesh
puna me
enciklopedinë ... 28

Martesa në Islam (2) ... 40

Nën rrezet e sures
el-GASHIJE ... 43

Veglat muzikore në Islam dhe
ndikimi i tyre
në muzikën perendimore ... 45

Atributet e Kuranit fisnik ... 46

Haxhi kërkim i
identitetit shpirtëror ... 48

Triniteti
dhe vërtetësia e tij (2) ... 49

REIS UL ULEMA NIKOQIR I KREUT TË SHËTETIT

Një iftar me Presidentin Ivanov

Agron Vojnika

Për herë të parë në jetëgjatësinë e Republikës së Maqedonisë si shtet sovran, Presidenti i shtetit z. Gjorgje Ivanov e theu akullin dhe më datën 02 Shtator 2009, gjatë ceremonisë fetare – Faljes së Iqindisë, vizitoi Xhaminë e Sahatit në Qytetin e Gostivarit.

Besimtarët e shumtë që ishin mbledhur në këtë xhami për t'ji kryer obligimet e tyre fetare, u befasuan këndshëm nga fakti që personalisht Kreu i Bashkësisë Fetare Islame H. Sulejman ef. Rexhepi bëri faljen e Iqindisë dhe bashkërisht me të gjithë të pranishmit, myftinjët e të gjitha Myftinive të Bashkësisë Fetare Islame, Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame dhe shumë figura relevante të jetës fetare në vend, i shprehën falënderime të përzemërta Presidentit

të Shtetit z. Ivanov, i cili ndau kohë dhe ndryshe nga paraardhësit e tij, vendosi që të vizitojë një xhami myslimane, duke dëshmuar edhe një herë për përcaktimin e tij, se është Kryetar i të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, pavarësisht besimit, etnisë apo racës.

Fillimisht Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi e falënderoi në emrin e tij personal dhe në emrin e BFI-së, si dhe të gjithë të pranishmit në xhaminë Sahatit, ndërsa si shenjë falënderimi i dhuroi një fotografi të vjetër të xhamisë Sahatit në Gostivar, të bërë në vitin 1929.

“Më lejoni që në emrin e të gjithëve, në emrin e Myftinisë së Gostivarit, në emrin e Riastetit të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, t’ua dhuroj këtë fotografi të vjetër e cila gjithmonë do t’ua kujton këtë vizitë dhe për këtë respekt që ia bëtë këtij xhemati dhe tërë

popullatës myslimane që jeton në Maqedoni”, i tha mes tjerash Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi Presidentit Ivanov. Kreu i BFI-së, gjithashtu theksoi faktin se Presidenti i Respektuar Gjorgje Ivanov, është Presidenti i parë i Republikës së Maqedonisë, i cili ka shprehur dëshirën që të merr pjesë në një ceremoni fetare gjatë muajit të Bekuar të Ramazanit, me ç’rast jo vetëm që na ka respektuar neve të pranishmëve në këtë Shtëpi të Allahut, por njëkohësisht me këtë veprim ka respektuar të gjithë qytetarët që i përkasin besimit Islam në vend, dhe njëherësh ka vërtetuar premtimet e tija gjatë fushatës zgjedhore, se do të jetë president i të gjithë qytetarëve të vendit, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare, etnike apo racore”, tha Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, i cili më tej ia dha fjalën Presidentit Ivanov.

MULTIKONFESIONI - PASURI E MAQEDONISË

“I nderuari Reis, të nderuar besimtarë dhe të pranishëm, më lejoni që nga zemra t’ju përsërisht të gjithëve që ndodhni në këtë xhami dhe, njëkohësisht shfrytëzoj rastin që të gjithë besimtarëve myslimanë t’ua uroj muajin e bekuar të Ramazanit. Mua personalisht, më paraqet një kënaqësi e veçantë që sot ndodhem këtu me ju, në këtë Tempull të Zotit gjatë këtij muaji të Bekuar të Ramazanit. Ky është muaj i solidaritetit dhe barazisë mes njerëzve, muaj i paqes dhe mirëqenies, të cilat janë shumë të rëndësishme për bashkëjetesën, si në vendin tonë, po ashtu edhe në tërë botën”, tha Presidenti Ivanov, i cili më tej shtoi: “Jam thellë i bindur se Bashkësia Fetare Islame, ashtu



si deri më tani, edhe në të ardhmen do të vazhdojë me kontributin e saj në realizmin e reformave dhe proceseve integruese të vendit tonë, krijimin e klimës demokratike dhe tolerancës ndërfetare, sepse bashkëjetesa dhe bashkëpunimi ndërkulturor dhe ndërfetar janë shtyllat e çdo shoqërie demokratike”.

Gjatë fjalimit të tij, presidenti disa herë u ndërpre nga duartrokitjet, ndërsa pas fjalimit ai i shoqëruar nga Reis ul Ulemaja dhe të gjithë myftinjët e vendit, shtrënguan duart dhe biseduan me besimtarët në xhami dhe me qytetarë të ndryshëm të Gostivarit.

Në dalje nga Xhamia, një grup femijësh i dhuruan Presidentit dhe mysafirëve trëndafila të freskët, duke shprehur dhe dëshmuar edhe një herë zemërgjerësinë islame.

NJË SHËTITJE NË ÇARSHINË E GOSTIVARIT

Data 2 Shtator tërhoqi vëmendjen e shumë qytetarëve të Gostivarit, sidomos fakti që Presidenti i Shtetit Gjorgje Ivanov po ecte në këmbë nëpër Çarshinë e këtij qyteti, i shoqëruar nga Reis-ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, myftinjët e Myftinive të BFI-së dhe shumë hoxhallarë të tjerë, të cilët dukeshin qartë nga xhybet dhe shallët. Disa qytetarë që po kalonin ballë përballë me delegacionin, afroheshin dhe zgjasnin duart për tu përshëndetur të dy krerët e dy institucioneve me relevancë në vend.

Gjatë këtij rrugëtimi, Reis ul Ulemaja, i shpjegoi presidentit Ivanov për historinë e çarshisë, sheshin e qytetit, si dhe për pronat e vakëfit, të cilat, në qytetin e Gostivarit i janë kthyer përfundimisht pronarit legjitim - Bashkësisë Fetare Islame.

Sapo delegacioni e kaloi sheshin, vëmendjen e presidentit e tërhoqën ëmbëlsirat e shumta që ishin të vendosura në vitrinën e ëmbëltores “Rekord” dhe nga të pranishmit kërkoi që të kthejnë bashkërisht për të blerë bakllavë. Edhe pse shumica e të pranishmëve agjëronin në ato momente, Presidenti bleu bakllavën për të gjithë të pranishmit, e cila do të shtrohej më pas gjatë Iftarit.

Delegacioni i Bashkësisë

Fetare Islame me në krye Reis-ul-Ulemanë, bënë përcjelljen e Presidentit Ivanov deri në afërsi të komunës së Gostivarit, dhe nëpër të njëjtën rrugë u kthyen në hapësirat e Myftinisë së Bashkësisë Fetare Islame të Gostivarit.

IFTARI I PARË ME KREUN E SHTETIT

Që në fushatën e tij presidenciale, profesori Gjorgje Ivanov kishte premtuar se do të ishte President i të gjithë qytetarëve të Maqedonisë. Kjo edhe ishte motoja e tij që i garantoj dhe siguroi fitoren si President i Shtetit.

Gjatë ngrënies së iftarit, në sofrën e që e shtroi Reis-ul-Ulema për nder të Presidentit të shtetit, në disa raste u përmend ky element, mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e vendit dhe për bashkëjetesën mes qytetarëve që u përkasin konfesionëve të ndryshme.

Në shumë raste, u tha se Republika e Maqedonisë është shtet multikonfesional dhe multietnik, dhe si i tillë duhet të ecë me hapat e kohës, bazuar në principet e demokracisë, ku të gjithë njerëzit janë njësoj dhe të barabartë në të drejta dhe obligime. Në lidhje me këtë, u bë edhe një komparacion, pikërisht për faktin se që nga shpallja e Kuranit e deri më sot, ky libër i shenjtë në këtë aspekt, predikon demokracinë e mirëfilltë. Një mësim i të madhit Muhamed a.s. për këtë çështje thotë se të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejta dhe obligime. “Arapit nuk ka më shumë të drejta se jo arapit, myslimani nga jomyslimani, i bardhi nga i ziu, i ziu nga i kuqi...”.

Pikërisht kjo temë, e nxiti Presidentin Ivanov që të mbajë një fjalim para të gjithë të pranishmëve në sofrën e Iftarit.

“I nderuar Reis, të nderuar myftinj dhe të pranishëm. Edhe një herë ju falënderoj nga zemra për këtë pritje madhështore, por edhe për zemërgjerësinë tuaj dhe për respektin që po ma bëni. Unë edhe pse jam pjesëtar i një besimi tjetër – ortodoks, sërish e ndjej si obligim për të ardhur këtu dhe për t’i respektuar zakonet tuaja. Premtimin, se do të jem Kryetar i të gjithë banorëve të Maqedonisë e bëra që në kohën kur po kandidoja

për Kryetar Shteti, e këtë tani e ndjej si obligim që vërtetë të veproj si i tillë, pavarësisht besimit apo nacionalitetit të qytetarëve të këtij shteti. Para një jave isha në Maqedoninë lindore për nder të festës ortodokse “Ujërat e bekuar” dhe bashkë me përfaqësues të Kishës Ortodokse vizitua disa kisha të vjetra atje, ndërsa sot e pashë të arsyeshme që po ashtu të jem me bashkëkombësit e mi në një xhami, për nder të Muajit të Ramazanit”, tha Presidenti Ivanov, i cili më tej shtoi: “Si i vogël jam edukuar se duhet të respektohen të gjitha religjionet. Madje, gjyshi shpeshherë më thoshte se duhet të respektohet ligji i natyrës, të respektohet Zoti, prindërit, miqtë dhe shokët. Atë kohë nuk e kuptoja këtë, por më vonë e kuptova se çka ishte ai ligji i natyrës. Pra, njeriu në moshën 20 vjeçare duhet të jetë i bukur, në moshën 30 vjeçare i mençur, ndërsa në moshën 40 vjeçare, duhet të jetë i pasur. Imagjinoni sikur kjo të ishte e kundërta...”

Pas një duartrokitje, fjalën e mori Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili u tha të pranishmëve: “I nderuar Kryetar i Shtetit, të nderuar kolegë dhe mysafirë, këtë herë nuk do të mbaj ndonjë fjalim, por do të tregoj një gjë të vërtetë.

Kur po zhvillonte fushatën presidenciale, Z. Ivanov erdhi për të kërkuar Bekimin e Bashkësisë Fetare Islame dhe, që atëherë e kuptova se kishim të bënë me një lider, i cili do të jetë i të gjithë qytetarëve. Prandaj, duke i parë këto kualitete dhe parime, isha i bindur në fitoren e z. Ivanov dhe që atëherë ia urova fitoren dhe postin Presidentit të ardhshëm të vendit.

Edhe pse të nesërmen disa medime me qëllime ofenduese e komentuan atë veprim dhe mua më quajtën Hoxhë parashikues (Vidovit Oxha). Por, dua të them se vendi ynë, edhe pse një vend me demokraci të shkurtër kohore, ka bërë që politikanët dhe liderët të zgjidhen në bazë të fjalorit të tyre optimist, pra të zgjidhen ata që i japin përparësi ndërtimit, e jo shkatërrimit, afrimit mes njerëzve e jo përçarësit e njerëzve”, tha Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi.

KUR NUK RESPEKTOHET FJALA E DHËNË

Vizita në qytetin e Gostivarit e Presidentit Ivanov u organizua në bashkëpunim me protokollin e Presidentit dhe të Bashkësisë Fetare Islame. Më pas në këtë protokoll u ftua edhe Kryetari i Komunës së Gostivarit z. Rufi Osmani.

Pas gjitha konsultimeve dhe bisedave trilaterale që u zhvilluan midis kabineteve, protokollin përfundoi dhe u vendos që sipas atij protokollit të zhvillohen edhe takimet. Në kohën kur gjithçka kishte përfunduar, nga kabineti i z. Rufi Osmani u kërkua të ndryshohej protokollin, gjegjësisht restoranti ku do të shtrohej Iftari dhe njëkohësisht u sugjerua restoranti në të cilin z. Rufi do të kishte dëshirë të merr pjesë në Iftar. Ashtu edhe ndodhi. Edhe pse paraprakisht kishte përfunduar gjithçka, dëshira e z. Rufi u plotësua dhe në konsultim mes Kabinetit të Presidentit Ivanov dhe Kreut të BFI-së u ndryshua protokollin dhe u fut në rend të ditës restoranti i sugjeruar pikërisht nga kabineti i Kryetarit të Komunës së Gostivarit.

Fillimisht, për këtë ditë ishte paralajmëruar një takim midis Kryetarit të BFI-së dhe z. Rufi Osmani, përpara se të vinte Presidenti Ivanov në Qytetin e Gostivarit. Ky takim nuk u mbajt nën arsyetimin se Kryetari i Gostivarit ka obligime në Fakultet.

Më pas ishte paraparë që Z. Rufi Osmani të merr pjesë në faljen e namazit, ku edhe do të bëhej pritja e Presidentit. Edhe kjo nuk u respektua dhe Z. Rufi Osmani nuk erdhi në xhami.

E për të qenë çudia edhe më e madhe, z. Rufi Osmani nuk erdhi as në restorantin që paraprakisht e kërkoi për t’u shtruar Iftari dhe në vend të tij erdhi Kryetari i Këshillit Komunal, të cilit i jemi mirënjohës.

Tri dështime për një ditë, e për këtë, një fjalë e urtë thotë: “Mënyra sesi njeriu e luan lojën, tregon diçka për karakterin e tij. Por mënyra se si njeriu e humbën atë, tregon gjithçka për të”.

**Autori është Shefi i
Kabinetit
të Reis ul Ulemasë**

KONFERENCË BASHKËPUNIMI I UNFPA-SË ME INSTITUCIONET FETARE

Investimi i garantuar për ardhmërinë

Në organizim të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë – UNFPA, nga data 31 Gusht e deri më 2 shtator 2009, në kryeqytetin e Bjellorusisë - Minsk u mbajt konferenca ndërkombëtare e Forumit të Bazuar mbi Organizatat Religjioze të Pupullatës dhe Zhvillimin në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore.

Në këtë Konferencë morën pjesë përfaqësues nga SHBA-të, Venezuela, Egjipti, Indonezia, Malajzia, Turqia, Tashikistani, Kirgistani, Bullgaria, Serbia, si dhe shtete të tjera dhe të ish-Bashkimit Sovjetik.

Në këtë konferencë, Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë e përfaqësoi sekretari gjeneral i BFI-së h. Afrim ef. Tahiri, i cili menjëherë pas mbarimit të konferencës është shprehur se kooperimi me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë lidhur me temat në fjalë, padyshim se do ta lehtësojë veprimin tonë dhe do të mundësojë arritjen e shpejtë të rezultateve të kërkuara.

Tema diskutimi në këtë konferencë ishin:

– Partneriteti midis Bashkësive Fetare në avancimin e shëndetit të nënave që lindin dhe përgjigja ndaj virusit HIV/Aids.

-Puna e Bashkësive Fetare për të krijuar familje të shëndosha dhe shoqëri të shëndoshë.

-Edukimi i gjeneratave të reja dhe zhvillimi i tyre: Investimi në ardhmërinë.

Redaksia e Hënës së Re, mori një prononcim nga Sekretari Gjeneral h. Afrim ef. Tahiri, i cili u shpreh mjaft optimist, për kontributin që Bashkësia Fetare Islame e RM-së, e jep në vazhdimësi në këtë aspekt.

“Shumë përfaqësues të Bashkësive Fetare të vendeve të ndryshme prezantuan se si Bashkësitë e tyre Fetare po veprojnë në raste të veçanta, siç janë ato për të cilat fliteshin temat në vijim. Pas gjithë asaj që dëgjova, mund të them me plot bindje se Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë ka kohë të



gjatë që po vepron në këtë drejtim, në edukimin e nënave të reja, në krijim e një shoqërie të shëndoshë, në preventivin e sëmundjeve të ndryshme, përfshi këtu edhe virusin HIV/Aids, si dhe në krijimin e familjeve dhe shoqërive të shëndosha. Falënderuar udhëzimeve të Pejgamberit a.s. dhe Fjalëve të Kur'anit të Madhërishëm, ne si Bashkësi Fetare Islame, duke u bazuar në këto principe, e kemi pasur shumë më të lehtë punën në këtë drejtim. Që nga vitet 90-ta, Bashkësia Fetare Islame ka pasur aktivitete. Mua personalisht si student më kujtohet se kam mbajtur disa tribuna – ligjërata nëpr mediueme, lidhur me dukuritë negative në shoqëri, siç janë: narkomania, alkoolizmi, amoraliteti, migracioni. Si rezultat i këtyre angazhimeve, në vitin 1996, BFI i botoi këto tema në librin me titull: “Moshatarëve të mi”. Ky libër pikërisht mban udhëzime të cilat ekskluzivisht i shoshitin këto tema. Ky libër gjithashtu mund të lexohet edhe në formën elektronike në ueb faqen e Bashkësisë fetare Islame: ëëë.bim.org.mk. Nga ana tjetër,

këto tema shpesh herë edhe ligjërohen nga Imamët dhe vaizët nëpër xhamitë tona.

Por edhe përkundër këtyre fakteve, ne gjithashtu kemi dhënë maksimumin edhe në aspektin e edukimit të vajzave si në Medresenë Isa Beu, ashtu edhe duke organizuar seminare posaçërisht për gratë, ku kanë ligjëruar emra të njohura të medicinës dhe punëve sociale në vendin tonë. Shumë gjëra që u thanë në këtë konferencë, për ne janë të njohura. Veç më dhe ne si BFI, kemi krijuar një traditë në organizimin dhe transmetimin e këtyre mësimëve”, tha h. Afrim ef. Tahiri, i cili më tej shtoi: “Para disa javëve, në ambientet e Bashkësisë Fetare Islame të RM-së u mbajt një ligjëratë e përkushtuar pikërisht shëndetit të gruas dhe nënave të reja. Ndërsa në gjitha xhamitë e vendit, vazhdimisht po jepen udhëzime deri te imamët për tema të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me moralin dhe sjelljet e njeriut, të cilat në masë të madhe veprojnë edhe në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, e posaçërisht Sidës dhe virusit HIV. Fatmirësisht për herë të

parë, ishim pjesëmarrës në një konferencë e cila ka për qëllim shpërndarjen e eksperiencave dhe mësimëve të ndryshme të cilat vijnë si rezultat i studimeve dhe analizave të bëra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Ato eksperiencia gjithsesi janë të mirëseardhura edhe në shoqërinë tonë dhe ne shpresojmë se të njëjtat do ti jetësojmë për të mirën e shoqërisë sonë”.

Sidoqoftë, UNFPA është lider botëror në organizimin dhe edukimin e Organizatave të ndryshme që veprojnë në vende të ndryshme të Botës dhe që merren me edukimin direkt të popullatës për sa i përket çështjes së popullimit, natalitetit, shëndetit dhe sëmundjeve të ndryshme. Vlen të përmendet fakti se në të kaluarën shumë projekte të cilat u janë dhënë organizatave të ndryshme joqeveritare apo qeveritare në këtë drejtim, nuk kanë dhënë rezultate të pritura. Implikimi i organizatave të bazuara në Religjionin – pra Bashkësive Fetare, është një garanci në suksesin më të madh të këtyre projekteve që kanë të bëjnë drejt për drejt me shëndetin e njeriut dhe me popullimin në përgjithësi, për shkak të organizimit shumë vjeçar dhe ndikimit të madh në popull. Padyshim se në këto raste duhet theksuar se investimi i organizatave të kutive për projektet e Bashkësive Fetare në luftën kundër dukurive negative në shoqëri, gjithsesi duhet mirëpritur, në veçanti kur kihet parasysh se në të kaluarën dhe në shumë vende aktualisht, nga lëvizje partiake, ideologjike apo shtete, është investuar që jeta fetare të jetë e mbyllur vetëm brenda mureve të objekteve fetare. Me këtë lloj investimi, bashkëpunimi që tani është parë si i domosdoshëm, është një argument se Feja nuk është brenda mureve, por ajo duhet të jetë aktive edhe në jetën shoqërore, gjithandej ku mund të jep kontributin e saj për një progres sa më të madh në shoqëri.

A.V.

NJË IFTAR SOLEMN ME LIDERËT FETAR TË BALLKANIT NË BUKURESHT TË RUMANISË

Islami në Maqedoni është praktik, e jo vetëm teorik!

Jeta fetare islame në vendet ballkanike po merr një kahe shumë pozitive, sidomos në vendet me sisteme të ngulfatura komuniste. Një gjë e tillë u dëshmuar edhe në takimin e liderëve fetar të shteteve ballkanike që u mbajt më 04.09.2009 në Bukuresht të Rumanisë nën organizimin e Myftiut të myslimanëve të Rumanisë, Jusuf Murat. Me këtë rast, myftiu i Rumanisë shtroi iftar solemn për liderët fetar të shteteve ballkanike dhe korin diplomatik të shteteve islame në Rumani. Në këtë solemnitet mori pjesë edhe Kryetari i Rumanisë, Traian Basescu, pastaj ministrat nga kabineti qeveritar të Rumanisë si dhe funksionarë të lartë të shtetit.

Në këtë iftar, ishin të pranishëm kryetari i Dijanetit të Turqisë me bashkëpunëtorët e tij, Ali Bardakoglu, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reisul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, Kryetari i komunitetit mysliman të Shqipërisë Selim Muça, Kryemyftiu i myslimanëve të Republikës së Bullgarisë, Mustafa h. Alis, Kryetari i Bashkësisë Islame të Malit Zi, Rifat Fejzić, kryetari i myslimanëve të Sllovenisë, Nevzat Poriç, Myftitë nga Trakia perëndimore të qyteteve Iskexhe dhe Gumulcine, Ibrahim Sherif dhe Ahmet Mete si dhe Myftiu i Bosnjës dhe Hercegovinës, Mustafa Ceriç.

Me këtë rast, në fjalën e tij të rastit, kryetari i Rumanisë



vlerësoi angazhimin e organizimeve të tilla, dhe vuri në dukje se kështu kontribuohet në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të bashkësive fetare, si dhe të myslimanëve të cilët jetojnë në Rumani, që gjithashtu kontribuojnë edhe mbi fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale me shtetet islame. Ai më tej tha se: “këto janë shenja të rrugës që duhet ndjekur për bashkëpunim ndërfaqetar dhe zhvillimin e dialogut ndërreligjioz në botën moderne”

Ndërkaq, në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i Dijanetit të Turqisë, Ali Bardakoglu falënderoi kryetarin Basescu për pjesëmarrjen e tij, gjë që u bë në nder të respektit të veçantë myslimanët të Rumanisë, si dhe liderëve fetar të Gadishullit Ballkanit. Ai më tej i uroj sukses në punën e tij të mëtutjeshme, në ndërtimin dhe fuqizimin e dialogut ndërkonfe-

sional.

Pas iftarit solemn, u realizua një takim midis kryetarëve të bashkësive fetare të shteteve ballkanike, me ç'rast u bisedua për përvojat e fituara deri më tani nga institucionet e lartpërmendura fetare.

Në takimin e tyre u konstatua se bashkëpunimi midis liderëve fetar të këtyre shteteve është tejet me rëndësi bile i patjetërsueshëm për ndërtimin e ardhmërisë më të mirë të myslimanëve që jetojnë në këto hapësira. Me këtë rast, u konstatua se takimet që realizohen pas çdo gjashtë muajsh, po japin rezultate pozitive, progres dhe të arritura të mëdha. Prandaj, bashkëpunimi midis këtyre institucioneve nga dita në ditë fuqizohet dhe rritet. Esenca e realizimit të këtyre takimeve, siç theksoi kryetari i Dijanetit, Bardakoglu është njoftimi për së afërmi me prob-

lemet e myslimanëve të Ballkanit, me sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe me të arriturat e tyre në jetën fetare. Në këtë aspekt, me këmbimin e përvojave do të mund t'u ofrojmë mundësi që të përfundojnë dhe t'i zgjidhim problemet e tyre dhe, njëkohësisht t'u ndihmojmë në ngritjen dhe zhvillimin e jetës fetare në nivel edhe më të lartë.

Me këtë rast, Kryetari i BFI-së Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi duke theksuar rëndësinë dhe peshën e këtyre takimeve, vlerësoi se Islami në hapësirat ballkanike me traditë shumëshekullore është i ngritur në bazë të shkollës së medhhebit Hanefi. Jeta fetare Islame në Maqedoni organizohet në aspektin praktik, e jo vetëm në atë teorik. Shikuar në këtë aspekt, është tejet i rëndësishëm roli i liderëve të Dijanetit të Turqisë si subjekt kryesor në organizimin e jetës fetare në R. Turqisë, q[organizohet gjithashtu në bazë të islamit tradicional të medhhebit Hanefij. Megjithatë, ne kemi nevojë të këmbëjmë përvoja institucionale, e në veçanti pa fije rezerve do të përkrahim dhe do të pranojmë çdo projekt që do të propozohet nga Dijaneti i Turqisë- tha mes tjerash Reis-ul-Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi. Në fund të këtij takimi u miratua një konkluzë e përbashkët që takimi i radhës, pas gjashtë muajve të realizohet në Prishtinë.

Hidhet gurr-themeli i sallës sportive në Kumanovë

Të shtunën më datë 5 Shtator, në qytetin e Kumanovës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendosi gur-themelin e Sallës së Re për sport dhe edukatë fizike SSF "Kiro Burnaz".

Në ceremoninë e hedhjes së gur-themelit morën pjesë Kryetari i Komunës së Kumanovës, Ministri për Arsim dhe Shkencë z. Nikolla

Todorov, përfaqësues i Kishës Ortodokse Maqedonase si dhe Sekretari Gjeneral i Bashkësisë Fetare Islame të RM-së h. Afrim ef. Tahiri. Në praninë e shumë pjesëmarrësve u fol për rëndësinë e kësaj sale sportive, e cila njëherit do të ndikon në pasurimin e jetës shoqërore dhe do të jetë një garanci për ardhmërinë e shëndoshë të rinisë.



Vizitë qendrave Islame në Gjermani

Gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit BFI zhvillon aktivitete të shumta kulturore-fetare. Kështu, përveç vizitave që ju bëhen myftinive të BFI-së në vend, përkatësisht xhematëve të këtyre myftinive, BFI kultivon edhe një traditë të saj duke i vizituar qendrat islame të bashkatdhetarëve tanë në Europë dhe në botë. Kështu, një komision i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame, i përbërë H. Jakup Selimovski dhe Abaz Islami këtë Ramazan ju ka bërë vizitë qendrave islame të bashkatdhetarëve tanë në Gjermani. Shtet ky, i njohur demokratik, modern, qendër e qytetërimeve dhe kulturave të shumë popujve që jetojnë dhe veprojnë në këtë vend. Zhvillimi i jetës fetare në këtë vend gjatë muajit të Ramazanit begatohet me aktivitetet të ndryshme nga bashkatdhetarët tanë. Kështu, ky vend me nivel të lartë të zhvillimit të demokracisë, të krijon mundësi të një jete të barabartë fetare për të gjitha religjionet. Të bënë të ndjehesh atje ku të dëshiron zemra dhe shpirti.

Gjatë qëndrimit në Gjermani, ky delegacion ka vizituar rreth 10 qendra islame të bashkatdhetarëve tanë, duke filluar nga Hamburgu, pastaj në Berlin, Frankfurt, Nirnberg dhe Manhajm, pastaj në Shtutgart, Dortmund, Duseeldorf, Duisburg, dhe Leverkusen.

Me këtë rast, delegacioni ka pasur mundësi të takohet me xhematin dhe imamët e këtyre xhamive. Kështu,

HAMBURG

Në Hamburgu janë pritur nga xhemati i kësaj qendre në krye me Imamin e tyre Zulhajrat ef. Fejzullahi. Gjatë takimit dhe bisedës së zhvilluar me xhematin, delegacioni ua ka përcjellë urimet e Reisul



• XHEMATI I BERLINIT



• XHEMATI I NIRNBERGIT



• FRANKFURT

Ulemasë së BFI-së në RM, H. Sulejman ef. Rexhepi, duke i përshëndetur në emër të tij, ua kanë uruar Muajin e shenjtë të Ramazanit. Me këtë rast, pas përfundimit të namazit të teravisë, është organizuar edhe një tribunë fetaro-shkencore. Në këtë tribunë, xhemati ka pasur rastin për së afërmi të njihet me zhvillimin e jetës fetare në RM, si dhe me aktivitetet tjera. Ky delegacion e ka njoftuar këtë xhemat me zhvillimin e jetës fetare arsimore, Medresenë Isa Beu, si dhe me paralelet e saj nëpër qytetet e Maqedonisë, Fakultetin e Shkencave Islame. Përmes pyetjeve të shtruar me këtë rast, është vërejtur një interesim jashtëzakonisht i madh i xhematit për të njohur jetën e begatshme fetare islame në vendlindje.

Me këtë rast, përgjegjësi i revistës Hëna e Re, Abaz Islami, i ka premtuar këtij xhemati, se së shpejti revista Hëna e Re do të gjendet në duart tuaja, ashtu siç ndodh me botimin e saj edhe në Zvicër, duke shtuar se me kalimin e kohës, kjo revistë do të mu d të gjendet në duart e të gjithë bashkatdhetarëve tanë anekënd botës, në Europë, pastaj në Amerikë, Kanada dhe Australi.

BERLIN

Edhe ky takim i delegacionit të BFI-së me xhematin dhe imamin e tyre Remzi ef. Xhaferi zgjoi interesimin i xhematit për shumë çështje të rëndësishme dhe për t'u njohur për së afërmi me zhvillimin e jetës fetare në vendlindjen e tyre. Vërehej një mall, entuziazëm tek ata. Kështu, pas faljes së namazit të teravisë, delegacioni i njoftoi të pranishmit për të gjitha projektet e realizuara dhe ato që duhet të realizohen në të ardhmen.

FRANKFURT

Vizita e delegacionit të BFI-së në qendrën islame të këtij qyteti zgjoi interesim të madh te bashkatdhetarët tanë të të gjitha trojeve, duke filluar nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, gjë që e bëri shumë interesant këtë takim. Për nderë të mysafirëve imami Ahmed ef. Kajoshi së bashku me përfaqësuesit e të gjitha qendrave tjera fetare shtroi një iftar solemn, duke e shndërruar këtë takim edhe si në takim tradicional të xhematëve të të gjitha qendrave islame të xhematit nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Ishte ky një rast i mirë për t'u njohur me aktivitetet e ndërmarra në realizimin e shumë projekteve nga BFI e Maqedonisë.

NYRNBERG

Mikpritja e xhematit të Nirnbergut për Abaz Islamin, përfaqësuesin e BFI për vizitë në qendrat Islame në Gjermani edhe njëherë dëshmoi për karakterin e tyre të pastër fetar Islam dhe besimin e tyre të fuqishëm në realizimin e parimeve dhe obligimeve fetare. Këtë e dëshmonte vepra e tyre e madhe që ishte në përfundim e sipër ku xhemati i Nirnbergut kishte hapë xhaminë dhe për të njëjtën në një të ardhme shumë të shkurt do të bëjnë edhe hapjen solemne apo lëshimin në përdorim të kësaj qendre. Në ligjëratën e tij, Abaz Islami uroi për punën e bërë nga xhemati në fjalë të njëjtëve u dëshiroi që edhe më tej t'i përcjellin suksese të njëpasnjëshme dhe se vepra e tyre të reflekton edhe më tej tek gjeneratat e reja në predikimin e fesë dhe ruajtjen e traditave familjare dhe shoqërore islame. Ai mes tjerash tha se vepra e juaj është e pashembullt dhe se ata që posedojnë vetëdije të lartë fetare, kombëtare dhe intelektuale gjithçka që realizojnë atë e bëjnë për hirë të Allahut që të jetë në dobi dhe interes të shoqërisë tonë. Të pashembullt keni qenë edhe në përkrahjen që i keni dhënë Institucionit të BFI në mirëmbajtjen e objekteve fetare, institucioneve edukativo-arsimore dhe institucioneve tjera



• DIZELDORF



• DIZELDORF

kombëtare në vendlindje dhe gjetiu.” –tha mes tjerash Islami. Pas përfundimit të namazit të Teravisë takimi vazhdoi me xhematin e Nirnbergut të cilët shprehën mirënjohje ndaj BFI dhe të deleguarit të Reis ul Ulemasë që vizituan xhematin në këtë muaj të madhërisëm të Ramazanit. Mes tjerash u bisedua për zhvillimin e jetës fetare në këtë qytet dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet ky xhemat.

SHTUTGART

edhe xhemati i Shtutgartit ishte nikoqir i këtij delegacioni, me ç'rast u vizituan dy xhamitë e këtij qyteti, tek të cilët u vërejt zemërgjerësia e besimtarëve dhe vëllezërve tanë. H. Jakup Selimovski vizitoi Imam Rexhep Sulejmanin dhe xhematin e tij, ku ai në ligjëratën e tij falënderoi pa masë mikpritjen e tyre, dhe se për të njëjtët në këtë muaj të madhërisëm vetëm Allahu është Ai i cili do të shpërblen më së miri veprën dhe punët tjera pozitive. Ai përkujtoi se xhemati juaj dhe të tjerët që

jeni në mërgim vazhdimisht do të jeni të përkujtuar nga prijtësit fetar dhe gjithë atyre që studiojnë teologjinë, për vetë faktin se keni qenë të palodhur në mbrojtje të fesë dhe popullit mysliman në Maqedoni dhe më gjerë. Ndërsa, Abaz Islami ishte nikoqir tek xhemati i Hazbi Sulejmanit, me ç'rast para namazit të Teravisë iu drejtua xhematit me fjalë se ne si shoqëri duhet ti kushtojmë edhe më tepër rëndësi arsimimit ngase ajo është perspektiva e popullit tonë. Ndërsa ju jeni përkrahësit tanë më të mëdhenj dhe të cilët meritoni të mbeten në kujtesa tona të përhershme! Vepra e juaj në shumë aspekte dhe në vazhdimësi ka bërë që sot të kemi një numër të konsiderueshëm të teologëve të diplomuar dhe intelektual të mirëfilltë të diplomuar të profileve të ndryshme që kanë mbaruar shkencat shoqërore në Universitete tjera shtetërore dhe ndërkom-bëtare”-tha mes tjerash Abaz Islami.

DORTMUND

Udhëtimi i delegacionit të BFI për çdo ditë nga një qytet në qytet tjetër vazhdonte për të vizituar xhematin e radhës, tani në mikpritje dolën xhemati i Dortmundit. Edhe këta si gjithë të tjerët të buzëqeshur dhe të lumtur pritën delegacionin e BFI, të cilëve u shtruan iftare solemne. H. Jakup Selimovski ishte tek Vahid Shabani, ndërsa Abaz Islami tek Nezir Ramadani, mes tjerash xhematit të Dortmundit iu prezantuan të arriturat e BFI dhe projektet të cilat janë në realizim e sipër. Ata u njoftuan me aktivitetet permanente të institucionit të Bashkësisë Fetare Islame të cilat do të lënë gjurmë në shoqërinë tonë duke filluar që nga organizimi dhe zhvillimi i jetës fetare, ndërtimi i objekteve fetare islame gjë e cila kjo ka rikthyer fotografinë e vendit tonë të viteve 1918, kthimin e pronave, akreditimin e Fakultetit të Shkencave Islame, fuqizimin e veprimtarisë institucionale mes BFI dhe institucioneve tjera të vendit dhe jashtë sajë, organizimet e ndryshme festive e akademike solemne fetare nëpër qytetet e Maqedonisë, etj.

DIZELDORF

Pas përshëndetjes me xhematin e Dortmundit, konsideratë kishin edhe ndaj xhematit të Duseldorfit gjegjësisht Qendrës Islame në Duseldorf. Delegacioni i BFI qëndroi për namazin e xhumasë tek xhemati në fjalë andaj para namazit të pranishmivë i prezantoi Imami i qendrës Mensur ef. Halili, ndërsa xhematit të Duseldorfit iu drejtua H. Jakup Selimovski i cili në ligjëratën e tij tregoi vlerat e këtij muaji të bekuar, organizimin e jetës fetare dhe bashkëpunimin ndër-xhematet. Edhe më tej duhet të mendoni për kthimin e juaj në vendlindje si dhe investoni nga kapitali i juaj gjithmonë në atdhe me të vetmin qëllim për të pasur edhe më tepër kushte që gjeneratët e reja të mbeten dhe mos të migrojnë-tha mes tjerash Selimovski.

Hutben e namazit të xhumasë e realizoi Abaz Islami, i cili të pranishmëve iu

drejtua me disa porosi, këshilla dhe mesazhe të bazuar në dijen e pashtershme të Allahut xh.sh, Kurani f.l. Ai porositi që ardhmëria e popullit mysliman duhet edhe më tej të ndërtohet në bazë të parimeve Islame meqë këtë e kanë ndihmuar gjeneratat e kaluara me kontributin e dhënë, gjë të cilën vepër ua kanë bërë të dashur edhe juve si trashëgimtarë të tyre. Ai vlerësoi pjesëmarrjen e të rinjve në ndjekjen e studimeve të shkencave të ndryshme dhe se rruga e arsimimit të tyre është rrugë që do të kishte ndihmuar fenë dhe kombin përjetësisht-tha Islami.

DISBURG

Edhe në këtë qendër, anëtarët e delegacionit ishin të ndarë në dy xhami, në dy xhemate edhe pse iftarin solemn e bënë në një familje shqiptare myslimane. H. Jakup Selimovski ishte nikoqir në xhaminë e re të shqiptarëve të Duisburgut, ku xhematit prezent ua përuroi hapjen e kësaj xhamie dhe të njëjtët i porositi që edhe më tej të kontribuojnë për zhvillimin e jetës fetare islame në qytetin e tyre, a njëherit edhe tek trashëgimtarët e tyre. Ai citoi disa ajete Kuranore që kanë të bëjnë me vlerën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së objekteve fetare aty ku kryhen obligimet ditore si dhe për objektet nga të cilat mësohet Islami dhe fjala e përkryer e Allahu f.p.

Abaz Islami vizitoi xhematin tjetër me çka të pranishmëve ua përcjelli uratat e Ramazanit nga Reis ul Ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi me ç'rast i bëri përshtypje që xhemati i kësaj xhamie ishte pothuajse tërësisht përplot me të rinj. Ai bëri apel që edhe më tej të vazhdojnë në këtë drejtim të jenë afër njëri-tjetrit, ngase uniteti i myslimanëve është një nga parimet fundamentale të Islamit. Tani është koha kur të gjithë duhet të jemi pranë njëri-tjetrit, që të dëshmojmë nivelin e lartë të kulturës tonë fetare dhe kombëtare.

LEVERKUSEN

Destinacioni i fundit i delegacionit të BFI për vizitat në muajin e shenjtë të agjërimit ishte Qendra Islame në



• TRIBUNA NË LEVERKUSEN



• LEVERKUSEN

Leverkusen. Në këtë qendër ishte përgatitur iftar solemn në të cilin morën pjesë një numër i madh i besimtarëve mysliman nga të gjitha trojet shqiptare. Delegacionin e BFI para besimtarëve e prezantoi imami i qendrës Amir ef. Xheladini, me çka H. Jakup Selimovski iu drejtua xhematit me një ligjërat para namazit të Teravisë ku shpalosi para tyre aktivitetet dhe të arriturat e BFI në periudhën e fundit edhe atë në instanca më të larta dhe përgëzoi për xhaminë e bukur që kishin ndërtuar me minare në këtë qytet. Ai

falënderoi mërgimtarët tanë ngase edhe pse janë larg vendlindjes ata kishin kontribuar në Leverkusen me ndërtimin e xhamisë së bukur por duke i përgëzuar edhe për veprën kolosale në vendlindje. Namazin e Teravisë e fali Abaz Islami dhe me të përfunduar imami i xhamisë i ftoi që të gjithë xhemati të merr pjesë në tribunën fetare- shkencore. Moderator i kësaj tribune ishte imami i qendrës Amir ef. Xheladini i cili fillimisht ia dha fjalën Abaz Islamit që të bënë hyrjen në këtë tribun me

fjalim të shkurtër. Ai theksoi një nga shumë karakteristikat që posedon ky muaj i madhërishëm. Karakteristikë e veçantë e këtij muaji të bekuar është edukimi, ngase në këtë muaj besimtarët edukohen në shumë aspekte duke theksuar më një theks të veçantë se Ramazani është edhe muaji i Kuranit- edukimit mbarënjëzësor.

TRIBUNA NË LEVERKUSEN

Më të përfunduar të këtij fjalimi të shkurtër, moderatori kërkoi që të shtrohen pyetje të ndryshme, që edhe vetë xhemati të njoftohet me veprimtarinë dhe aktivitetet e BFI-së. Në këtë tribunë u bisedua gjerë e gjatë mbi institucionin e BFI-s; zhvillimin dhe organizimin e jetës fetare në Maqedoni dhe diasporë, mbi ndërtimin e mundshëm të Burmali xhamisë në Shkup dhe Çarshi xhaminë në Tetovë, mësimbesimin fetar nëpër shkollat fillore, kthimin e pronave të BFI-s; mbrojtja e trashëgimisë islame në vend, etj.

Kështu ky delegacion e përfundoi vizitën në Gjermani, i impresionuar nga zhvillimi i jetës fetare në këtë vend, gjë që e dëshmuar edhe takimet me qendrat e përmendura islame. Këto takime u shoqëruan me tribuna të ndryshme, ku të pranishmit u njohën për së afërmi me aktivitetet e ndryshme të BFI-së në realizimin e shumë projekteve të rëndësishme për jetën fetare islame në RM.

Ne, me siguri ju kemi mbetur borxh edhe qendrave tjera islame, por ju premtojmë se në ndonjë rast tjetër do t'i vizitojmë edhe ata.



• LEVERKUSEN

QENDRA ISLAME SHQIPTARE EL-FURKANË NË MUNIH TË GJERMANISË

VATËR E EDUKIMIT FETAR DHE KOMBËTAR

Munihi, ky qytet i madhë i Bavarisë gjermane, i shquar për nga niveli i lartë i organizimit, tipik modern, përfaqësues i vërtetë i kulturës europiane, përfaqëson një jetë përplotë me vlera të kulturës, shkencës, ekonomisë, artit, sportit dhe shumë vlerave tjera. Nëse pak a shum merresh me detajet e këtij qyteti dhe marrë parasyhë prezencën e shumë grupeve religjioze që po organizojnë jetën fetare në këtë qytet, të duket si një vatër e multikultureës dhe multikonfessionalitetit. Përveç gjermanëve, sheh edhe popuj të ndryshëm pothuajse nga të gjithë kontinentet, nga të gjithë racat dhe popujt.

Pjesë aktive në këtë qytet marrin edhe muslimanët nga të gjitha vendet e botës, të cilët mundohen, jo vetëm të jenë puntorë të zellshëm por edhe të integrohen në jetën e këtij qyteti të madhë duke ruajtur edhe origjinalitetin e kulturës dhe fesë së tyre. Ndër to janë edhe muslimanët nga Maqedonija. Mu afër qendrës së këtij qyteti vepron Qendra islamike shqipëtare el Furkanë, qendër kjo që paraqet një ndër qendrat më serioze dhe shumë mirë të organizuara.

Qendra islamike shqipëtare është themeluar në vitin 1994 nga aktivistë muslimanë me punë në Gjermani. Nuk ka qenë lehtë për arsye se përveç angazhimit të organizimit të qendrës, për këtë aktivitete është e nevojshme edhe baza materiale. Por dëshira e flaktë për të mbrojtur identitetin e tyre fetarë dhe kombëtar muslimanët e teritorit të Maqedonisë me zell të madhë kanë ndarë nga të mirat e tyre materiale të fituara me djersë dhe me vështirësi të madhe, vetëm e vetëm të mirëmbajnë dhe të kultivojnë qendrën e tyre fetaro islame.

Tashmë kjo qendër ka anëtrat e saj të rregullt, imamin, kryetarin dhe besimtarët. Vepron konform Statutit të



qendrës e miratuar nga besimtarët e kësaj Qendre ku janë të përcaktuara të gjitha rregullat, obligimet dhe detyrat e Kryetarit të Kryesisë së Qendrës në fjalë, imamit të të qendrës, besimtarëve, etj.

Në fillim të Ramazanit jeta fetare e kësaj qendre fillojë në ndërtesë të re, që tashmë është pronë e vet qendrës të blerë nga besimtarët e kësaj qendre, me çka u plotësua dëshira e kahmotshme që besimtarët e kësaj qendre të kenë ndërtesën e vet. Krytari i kësaj qendre z. Afet nga fsh. Çajle të Gostivarit i cili shquhet për nga afiniteti dhe aftësia organizative, me gëzim të madhë tregon për punën dhe aktivitetin e kësaj qendre jashtzakonisht serioze. **Jemi të lumtur – thotë Z. Afeti, që më në fund arritëm të realizojmë dëshirën e kahmotshme të sigurojmë dhe të blejmë ndërtesën e re të qendrës. Ishte vështirë por vullneti dhe dëshira e fortë e të gjithë besimtarëve tanë me punë në këtë qytet bëri që të na ndihmojë All-**

llahu Fuqiptotë dhe më në fund të kemi këtë ndërtesë jashtzakonisht funksionale.

Qendra në fjalë funksionon në mënyrë të rregullt dhe zyrtare, me të gjitha kërkesat që duhet t'i kryejë një qendër moderne. Ndërtesa në veti përmban hapsirën e xhamisë ku kryhen detyrat fetare, zyrat administrative, sanitarinë, restorantin, rrojtoren dhe parkingun. Gjithsejt janë 250 anëtarë, prej të cilve më aktiv janë 150 të cilët shquhen me rregullsinë e pagesës së anëtarësisë.

Në këtë qendër me sukses kryen obligimet fetare, mësimbesimi islam, ligjërata rë xhumave dhe ditëve tjera kur e kërkon nevoja, etj.

Ndërtesa në t ë cilën vepron kjo qendër islamike është vazhdimësi e qendrave të mëparshme të këtyre besimtarëve nëpër ndërtesa tjera, dhe kjo xhami ka qenë aktive dhe gjithmonë në krye të detyrës, në veçanti në kohërat e vështira të muslimanëve dhe shqipëtarëve

me theks të veçantë. Ishte vatër e pritjes dhe ndihmasve për refugjatët e vëllezërve musliman gjatë kohës së luftës në Bosnje dhe Hercegovinë me rastin e gjenocidit të paparë në hsitroinë e njerëzimit nga ana e sërbeve kundër popullit boshnjak. Ishte bazë e fuqishme materiale për ndihmë kohës së vështirë të kosovarëve në luftë për t'i përballuar politikës diksiminuese të Millosheviqit, ishte qendër e aktiviteteve të bujshme në kohën më të vështirë të refugjatëve nga Kosova në momente më brutale të gjenocidit sërbo-sllav ndaj shqipëtarëve dhe muslimanëve, iste vatër e organizimit të ndihmave materiale për vatrën e arsimit shqipëtarë dhe Universitetin e Tetovës kur të gjitha forcat akademike maqedonase dhe ushtarakeo-policore donin ta shkatrojnë, ishte vatër e ndihmave në kohën më të vështirë të shqipëtarëve të Maqedonisë, në luftën e UÇK kundër diskriminimit sllavomaqedonas, dhe shumë aktivitete tjera. **Kjo qendër**

islamike - thot Z. Afeti, **në mënyrë shumë të kujdesshme dhe serioze ka ndjekur situatën në ballkan, në veçanti në trojet shqipëtare dhe në kohë ka mbushur obligimin islam dhe atdhetarë për të qenë në ndihmë të islamit, kombit dhe vatanit. Kjo na bënë të mburemi si qendër dhe si pjestarë të kësaj qendre islamike dhe në të njetën kohë na na jep frymëzim dhe forcë që gjithmonë në këtë mënyrë t,i përgjigjemi vatanit.**

Këtu në këtë qendër islamike zhvillohen aktivitete shumë të bujshme në edukimin e gjeneratave të reja në frymën islame duke i vetdisuar ata për një jetesë në Europë me vetëdije të lartë për të mbrojtur origjinalitetin fetaro kombëtar. **Nuk ka dyshim** – thot imami i kësaj qendre islamike H. Ujkan ef Sejдини, **se theksin kryesor e vendosim në edukimin e fëmijëve tanë dhe gjeneratave të reja, me qëllim që të mos bijnë pre e asimilimit që është fenomen shumë i rrezikshëm, andaj kujdes të veçantë i kushtojmë mësimbesimit të fëmijëve tanë, mësimin e gjuhës amtare, ligjëratave për besimtarët, dhe gjinisë femrore, dhe shumë aktiviteteve tjera.**

Është e vërtetë se në këtë qendër sheh besimtarë nga të gjitha trojet shqipëtare, pleq e të rinjë, fëmijë, të huaj etj. Por mbi të gjitha sheh besimtarët të gëzuar që Allahu ua ka falë këtë qendër që e duan dhe kujdesen si dy sytë e ballit., sepse kjo i tubon, i njohon dhe i bashkon ndërmjet veti e mbi të gjitha ua përkujton vatanin e tyre dhe i porosit që ate mos ta harrojnë kurr. Sheh fytyra të buzqeshura të aktivistëve të njohur si H. Luta, H. Feriti, Xha Ajeti, Xha Farizi, xha Dina, xha Qebiri, Xha Emini, të gjithë këto që mbi tridhjetë vjet jetuan dhe vepruan në këto troje, por në të njetën kohë sheh me plot optimizëm dhe vullnet të rinjtë si Burhani, Xhemili, Kadriu, Bekimi, Rexhepi, Nebiu, Refeti, Nurimani, Zulfiu, Afrimi, Zekerijaun, Bilali, Aliu, Vexhiu, etj. Të cilët na thonë: **është e vërtetë se jemi të detyruar të punojmë në vendet e largëta, por në të njetën kohë jemi të vendosur të mbrojmë, të kultivojmë dhe ta zhvillojmë traditën tonë fetare dhe kombëtare.**

INFORMATË

Skender Buzaku

Këtë vitë për muajin e shenjtë të Ramazanit Bashkësia Fetare Islame në R.M dërgoi një delegacion zyrtar në SHBA, i cili si detyrë kryesore e primare kishte të bëjë vizitën e qendrave shqiptare Islame në këtë kontinent.

Delegacioni në fjalë ka qenë i përbërë prej Skender Buzakut-Sekretar i Muftinisë së BFI-Shkup dhe hfz. Sabaatin Nuhijut-Hafiz.

Delegacioni i lartpërmendur gjatë qëndrimit të tij në SHBA ka vizituar qendrën Islame Shqiptaro-Amerikane në Çikago të shtetit Illinois në të cilën Imam është Lulzim Musaj, qendrën Kulturore Islame në Nju Jork në të cilën Imam është Zulkarni Vardari, si dhe (Ferit Bedrolli, Omer Musa, Tahir Kukaj, Omer Kadrija), qendrën Islame në Paterson të Nju Xhersit në të cilën Imam është Harun Pollozhani, qendrën Islame në qytetin Varbery të Kenerikës në të cilën Imam është Ediz Umeri, qendrën Islame në Garfilld të Nju Xhersit në të cilën Imam është Rufat Halili, Qendrën Islame Shqiptare në Kuins të Nju Jorkut në të cilën Imam është Imam Jusufi, qendrën Islame në Bruklin të Nju Jorkut në të cilën Imam është Osman Zaga, qendrën Islame në Kenoshë të shtetit Ëiscansen në të cilën Imam është Iljas Fetai.

Me rastin e natës së madhe të Kadrit, delegacioni i BFI-së në bashkëpunim me Imamin dhe këshillin e qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane të Çikagos së Illinoisit organizuan një tribunë me temë “Vlera dhe rëndësia e Natës së Kadrit” në të cilën ishin të pranishëm intelektual dhe mysafir të dallaur nga mbarë komuniteti shqiptar i Amerikës.

Vizita e delegacionit të Bashkësisë Fetare Islame në R.M ka pasur për qëllim që në mënyrë sa më të përafërt Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M të njohet me qendrat të cilat kryesisht janë të përbëra prej komunitetit shqiptar, andaj

edhe qëllimi kryesor dhe primar ka qenë rivënia e kontakteve të rregullta dhe bashkëpunimi Institucional me Bashkësinë Fetare Islame në R.M.

Nga kjo vizitë Imamët këshillat e xhamive si dhe besimtarët kanë ngelur të kënaqur dhe kanë shprehur interesin dhe gatishmërinë e tyre të lartë për bashkëpunimin dhe kooperimin të mëtutjeshëm me Institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në R.M në shumë fusha të jetës shoqërore.

Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M në çdo qendër ka prezentuar me ligjëratë dhe aktivitete të ndryshme me anë të të cilave ka zbuluar programin dhe ambientin e këtyre qendrave.

Në këtë drejtim duhet theksuar se secilës qendër Islame shqiptare në SHBA u janë shpërndarë nga disa ekzemplarë të Revistës “Hëna e Re” dhe “Ikre” si dhe u janë prezentuar aktivitetet dhe rezultatet e Bashkësisë Fetare Islame në R.M, në veçanti duke u fokusuar në rolin dhe punën e Medresesë Isa Beu”-Shkup, si dhe Fakultetit të Shkencave Islame-Shkup.

Nga shumica e qendrave Islame shqiptare të cilat gravitojnë në SHBA është shfaqur interesim i theksuar në dejtim të bashkëpunimit permanent për distribuimin e Revistës Hëna e Re si dhe një sasi të konsiderueshme të literaturës Islame prej Bashkësisë Fetare Islame në R.M dedikuar qendrave Islame Shqiptare në SHBA, me qëllim të njohimit dhe edukimit sa më të drejtë të popullatës shqiptare e cila jeton dhe vepron në SHBA.

Delegacioni i BFI-së poashtu gjatë qëndrimit në SHBA kishte nderin të takohet me përfaqësuesin diplomatik të akredituar në Chicago konsulin z. Muhamed Rakipi si dhe përfaqësuesit diplomatik të akredituar në Nju Jork z. Zulfi Ismaili dhe Zvonko Mucunski.

Në këtë drejtim vlen të theksohet edhe takimi me kryetarin e komunitetit të

Shqiptarëve të Shtetit të Illinoisit Xhevat Sherifin me të cilin në mënyrë të hollësishtme ishim të njoftuar me kërkesat dhe nevojat e komunitetit Shqiptar të Amerikës.

Vlen të thesohet që delegacioni i BFI-së në R.M ka patur takime edhe me disa personalitete të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm siç janë Faik Ajroja, Azem Begzati, Ajjet Rushiti, Musa Zendeli, Sinan Sadiku, Avdi Ajrullau, Zimer Kaliqi, Ajri Hoxha, Lirim Kaba, Sadullah Bekteshi, Rushit Ajroja, Zaim Shaqiri si dhe shumë të tjerë.

Si kërkesë e theksuar nga qendrat të cilat kanë qenë të vizituara ka qenë nevoja e tyre që në të ardhmen në mënyrë permanente të bashkëpunojnë me BFI-në në R.M, të pajisen me kuadro të profesionalizuar të teologëve nga Bashkësia Fetare Islame në R.M, si dhe interesimi i tyre i thellë për edukimin e fëmijëve të tyre në Institucionet edukativo-arsimore të Bashkësisë Fetare Islame në R.M gjegjësisht në shkollën e mesme Islame “Medresenë Isa Beu”-Shkup si dhe Fakultetin e Shkencave Islame-Shkup.

Përfaqësuesit e Bashkësisë Fetare Islame ripërsëritën qëndrimin e kreut më të lartë të Institucionit të Bashkësisë Fetare Islame në R.M respektivisht qëndrimin e Reisul Ulemasë h.Sulejman ef. Rexhepit se BFI në R.M do të jep kontributin maksimal për bashkëpunim dhe plotësim të nevojave të duhura të atdhetarëve tonë të cilët jetojnë dhe veprojnë në SHBA në të gjitha fushat e jetës për të cilat do të paraqitet nevoja.

Në fund duhet nënvizuar se delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M në të gjitha qendrat Islame Shqiptare që ka vizituar në SHBA ka qenë i pritë dhe i përcjellur me nderime dhe respekt të nivelit të lartë, me apel që Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M në të ardhmen të vazhdojë me vizitat dhe praninë e tyre në këtë kontinent.

Bashkatdhetarët dhe Islami në Evropë

As në kohën kur islami kishte ushtri të mëdhaja, as në kohën kur muslimanët kishin tonelata ari, nuk mundën ta çojnë Islamin përtej Danubit. Askujt nuk i nevojiten luftë dhe forcë për ta pranuar dhe respektuar tjetrin ashtu si është. Sot islami e ka kaluar Danubin dhe pikërisht ju të nderuar bashkatdhetarë jeni ata që kanë më tepër meritë për këtë gjë. Por njëherit nuk duhet ta harroni asnjëherë se juve jeni edhe ambasadorë të vendit tonë dhe ambasadorë të islamit në këtë vend të Evropës. Prandaj mirësia juaj dhe veprat e mira do të jenë gjërat e vetme të cilat do të vlerësohen si nga të tjerët ashtu edhe nga ne”.

Nga Agron Vojnika

Kryetari i Bashkësisë Islame të Maqedonisë - Reis Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, ishte i ftuar Special nga Qendra Islame Shqiptare në Austri dhe në Qendrën Islame Shqiptare në Itali.

“Me të vërtetë, All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete.” (Suret er-Rra’d: 11)

VJENA – KRYEQYTETI I EVROPËS

Në vizitën zyrtare që i bëri Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi Qendrës Islame në Vjenë, gjatë muajit të Bekuar të Ramazanit, pos shumë takime që u zhvilluan me mërgimtarët tanë në Austri, u zhvilluan edhe takime të nivelit të lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë me qëllim që të krijohet një klimë më e përshtatshme në bashkëpunimin mes Bashkësisë Fetare Islame të RM-së dhe Institucioneve të shtetit Austriak, si dhe në nivelin akademik mes Fakultetit të Shkencave Islame dhe universitetit të Vjenës, departamentit për çështje ndërkombëtare.

Gjatë tërë takimeve me bashkatdhetarët tanë, Reis ul Ulemaja i njoftoi të pranishmit me punën dhe aktivitetet e vazhdueshme që i bën Bashkësia Fetare Islame e RM-së për të



krijuar një taban më të fortë të Islamit në vendin tonë, si dhe për ta vazhduar traditën disa shekullore në këto troje, duke e kultivuar Islamin burimor. Njëherit duke i aplikuar këto vlera dhe mësimet që burojnë nga Kur’ani i Pavdekshëm, ne do të ndikojmë për të mirën e shoqërisë, kombit dhe atdheut tonë. Promovimi i këtyre vlerave nuk do mend se është në funksion të gjerë dhe me këtë ne i dëshmojmë dhe tregojmë Botës demokratike se ne në Maqedoni jemi të përkushtuar që të ndërtojmë një shoqëri të lirë e demokratik ku diversiteti në kombësi e fe duhet parë si vlerë për integritet në shoqërinë evropiane e jo si pengesë që sjell përplasje e dhimbje.

Pas një dite të gjatë pune dhe me shumë takime, disa orë para Iftarit të 20-të të muajit të bekuar të Ramazanit, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi hypi në aeroplanin e fundit të ditës që fluturonte për në Austri, vendin me plot kulturë i cili ndodhet në zemër të Evropës. Duke mos treguar në asnjë moment të udhëtimit lodhje apo mëdyshje, gjatë

gjithë fluturimit i refuzonte me buzëqeshje stjuardesat të cilat i ofronin diçka për të pirë apo për të ngrënë. Fillimisht ato nuk e dinin arsyen, por më pas e kuptuan se çka ishte qëllimi i një refuzimi të tillë dhe kërkuan falje me plot respekt ndaj Reisit. Pas fluturimit prej një orë e gjysmë, më në fund në horizont u duk edhe qyteti i Vjenës. Nga qielli shikohej lumi Danub, për të cilin Reis ul Ulemaja tha se do të tregonte një sekret, por këtë do ta bënte më vonë.

Në dalje të aeroportit të Vjenës, Reisin e priti delegacioni i pritjes, të cilët gjatë udhëtimit për në qendrën islame, e njoftuan Reisin me të rejtat e komunitetit shqiptar në Vjenë dhe në Austri, në përgjithësi. Ata paraprakisht kishin organizuar një Iftar dhe pjesa tjetër e delegacionit i cili do të bënte pritjen e Kreut të Bashkësisë Fetare Islame të RM-së, ndodhej pikërisht në një restorant me kuzhinë tradicionale turke.

Rruga deri tek restoranti ishte e gjatë, por në asnjë moment e lodhshme. Në

shoqërinë e dy nikoqirëve, ajo u duk shumë e shkurtër, për vetë faktin se gjatë tërë rrugës na njoftonin për qytetin, të cilit askund nuk i dukej fundi. Në çdo rrugë, shiheshin ndërtesa të vjetra, të ndërtuara me shije dhe në secilën kishte statuja të bukura dhe të gdhendura në gur dhe mermer. Pak si në të qeshur, njëri nga nikoqirët tanë tha se Vjena që në kohën kur është ndërtuar, ka qenë e dedikuar me qëllim që të bëhet Kryeqyteti i Evropës. Por kur mbaron qeshja, në esencë, ky qytet vërtet i ka të gjitha atributet për të qenë kryeqendër e Evropës.

Pas një kërkimi prej më shumë se 20 minuta për një vend parkimi, më në fund u gjet një vend i përshtatshëm në afërsi të restorantit. Aroma e gjellëve të ndryshme dhe atmosfera që ishte krijuar në restorant, të jepte përshtypjen se ndodheshe në ndonjë lagje të Stambollit, e jo të Vjenës. Por gjithsesi, rasti për ta shijuar kuzhinën turke në një iftar gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, ishte një kënaqësi shtesë. Delegacioni që priste Reis ul Ulemanë, kishte rezervuar tavolinën qendrore në atë restorant gjigant, ku ishin prezent qindra besimtarë të cilët prisnin të bënin iftar. Nuk shkoi gjatë dhe u dëgjua edhe ezani. Qindra besimtarë filluan iftarin duke u dëshiruar njëri tjetrit që Allahu fuqplotë tua pranojë agjërimin e ditës.

Pas ngrënies së iftarit, me delegacionin e pritjes u drejtuan për në xhaminë – gjegjësisht Qendrën Islame Shqiptare në Vjenë, e cila

njëherit ishte një nga qendrat më të mëdha të bashkatdhetarëve tanë në Austri. Fillimisht Reis ul Ulemaja i vizitoi të gjitha hapësirat e kësaj qendre, përfshi këtu edhe bibliotekën dhe më pas që të gjithë të pranishmit u drejtuan në pjesën e poshtme – faltoren, për ta falur akshamin dhe taravinë. Më pas Kreu i BFI-së mbajti një ligjëratë për rëndësinë e muajit të bekuar të Ramazanit dhe rëndësinë e pasjes së një xhemati të tillë, i cili me dinjitet do të na përfaqëson në Evropë.

Lidhur me këtë, në një moment, Reis ul Ulemaja, u tha të pranishmëve në këtë qendër: “Të nderuar vëllezër. Vendi jonë ka aspirata dhe po bën të gjitha përpjekjet për tu bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Ndërsa ne si Bashkësi Fetare Islame, nëpërmjet jush, kemi kohë që jemi pjesë e kësaj familje të madhe. Ju jeni ambasadorët tanë dhe përfaqësuesit e treguesit më të mirë se edhe atdheu jonë meriton të bëhet pjesë e kësaj familje të madhe demokratike. Njëherit ky është një privilegj, por edhe detyrim që na detyron që të gjithë ne, që veprat tona të jenë të shumta dhe shembullore”.

TAKIMI NË MINISTRINË FEDERALE PËR PUNË EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE

Ditën e dytë, gjithçka shkoi në frymën e përgatitjeve për takimin paraprakisht të akorduar në Ministrinë Federale për Punë Evropiane dhe Ndërkombëtare, ku Reis ul Ulemaja pati një takim me Magjistër Ernest Aichinger, të cilin fillimisht Kreu i BFI-së e njoftoi për punën e Bashkësisë Fetare Islame, dhe sistemin edukativo arsimor në Fakultetin e Shkencave Islame.

Gjatë një bisede të këndshme, u arrit marrëveshje për thellimin e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve në të ardhmen.

Më pas, Reis ul Ulemaja kishte mundësi për një shëtitje në qytetin e Vjenës dhe vizitoi disa ndërtesa me rëndësi historike në këtë vend.

Në mbrëmje ishte orga-



nizuar një iftar në Shoqatën Kulturore të Shqiptarëve Muslimanë në Xhaminë Vëllazërimi në Krems, diku rreth 80 kilometra larg Vjenës.

Reis ul Ulemanë në hyrje të xhamisë e priti xhemati i kësaj xhamie të kryesuar nga h. Zekirija Bajrami.

Gjithashtu në këtë Iftar ishte i Ftuar Kryetari i Bashkësisë Fetare të Austrisë, ambasadorë muslimanë të disa vendeve, si Turqisë, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, e tjerë, si dhe mysafirë të shumtë nga vende të ndryshme Evropiane.

Fillimisht sapo thirri ezani, të pranishmit bënë iftar me nga një urmë e më pas e falën namazin e akshamit, ku namazit i parapriu një imam i përkatësisë boshnjake ndërsa

muezin ishte profesori i Medreses Isa Beu, Mahir Asani.

Më pas në nder të mysafirëve të lartë u shtrua një iftar sipas traditës shqiptare në ambientet e xhamisë, i përgatitur pikërisht në kuzhinën e xhamisë.

Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, ku mes tjerash tha:

“Të nderuar vëllezër, kam kënaqësi të veçantë që sonte përmes këtij iftari të organizuar nga Unioni i Shqiptarëve Muslimanë të gjendemi të gjithë sëbashku këtu në këtë vend, i cili është në kuadër të një tempulli të shenjtë – xhamisë, e cila sipas informatave që kam është pronë e muslimanëve tanë.



Këtë aktivitet që kanë bërë muslimanët tanë dhe kanë ardhur deri në përfundim që të kenë edhe pronën këtu, të gjitha ata që kanë kontribuar janë angazhuar dhe janë aktivizuar dhe kanë dhënë djersën e vetë, Allahu xh. sh. i shpërbleftë me shpërblimet më të çmueshme që i ka Madhëria e tij.

Nga an tjetër kam kënaqësi të veçantë, se iniciativa e fundit është që të shihet forma më e suksesshme organizative, pra të gjitha qendrat, dymbëdhjetë sa janë, të veprojnë nën ombrellën e një unioni. Kjo është një përpjekje maksimale për të realizuar një dispozitë, parim fundamental islam e ai është që sa më tepër të ruhet bashkimi dhe uniteti. Ju të gjithë e dini se imperativi i Kur'anit të Pavdekshëm është se: Obligim e kemi të shenjtë që të gjithë të kapemi për litarin e Allahut fuqiptotë dhe nuk lejohet që të shpërndahe mi, të copëtohem dhe të grindemi”...

Pas këtij mesazhi dhe thirrje për unitet, Reis ul Ulemaja kishte mundësi që të bisedon me të gjithë të pranishmit dhe tu sjell lajmet e mira nga veprimtaria e suksesshme e Bashkësisë Fetare Islame e Maqedonisë.

AMBASADORËT E ISLAMIT NË EVROPE

Pas mbarimit të Iftarit, përderisa po ktheheshim për në Vjenë, të shoqëruar nga z. Rushani dhe Zekiriai, Kreu i BFI-së kërkoi që të vizitonte brigjet e Danubit. Fillimisht Reisi kishte premtuar se do të na tregonte diçka në lidhje me Danubin dhe tani të gjithë ne mezi prisnim të dëgjojmë nga Reisi se çka ishte ai sekret.

Sapo arritëm përreth brigjeve të Danubit, përderisa dëgjohej vetëm zhuzhurima e valëve të lumit, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi u kthye nga ne e me një zë të qartë na tha: “Të nderuar. Sonte po qëndrojnë buzë këtij lumi, aty ku para shumë shekujve më parë ka qëndruar një nga ushtritë më të mëdha Islame. Në vitin 1529, pra pikërisht para 480 viteve, Sulejmani i Madhërisëm i cili udhëhoqi me Ushtrinë Otomane, bëri përpjekjet e para për ta pushtuar qytetin e

Vjenës. Po në të njëjtin vit ai dështoi dhe pranoi se Islami kishte arritur në kufijtë maksimal të Evropës, e nuk mundte të shkon më tej.

Domethënë, as në kohën kur islami kishte ushtri të mëdhaja, as në kohën kur muslimanët kishin tonelata floriri, nuk mundën ta çojnë Islamit përtej Danubit.

Vetë prezenca jonë këtu, na bën të mendojmë për të kaluarën, por edhe për të ardhmen. Askujt nuk i nevojiten luftë dhe forcë për ta pranuar dhe respektuar tjetrin ashtu si është. Sot islami e ka kaluar Danubin dhe pikërisht ju të nderuar bashkatdhetarë jeni ata që kanë më tepër meritë për këtë gjë. Por njëherit nuk duhet ta harroni asnjëherë se juve jeni edhe ambasadorë të vendit tonë dhe ambasadorë të islamit në këtë vend të Evropës. Prandaj mirësia juaj dhe veprat e mira do të jenë gjërat e vetme të cilat do të vlerësohen si nga të tjerët ashtu edhe nga ne”.

NJË IFTAR NË ITALI

Pak minuta pas ngrënies së syfyrit, u nisëm drejt aeroportit të Vjenës. Aeroplani i cili fluturonte me destinacion nga Vjena për Milano ateroi në orët e para të mëngjesit. Jashtë aeroportit prisnin përfaqësues të Xhamisë Nur z. Arben Elezi, Kryetar i Qendrës Kulturore Islame e Shqiptarëve të Maqedonisë dhe imami i caktuar nga BFI-ja në këtë xhami z. Reshat Ibishi.

Pasi u përshëndetën me Reis ul Ulemanë, u nisëm për në qytetin e Casaloldo në rajonin Mantua, diku rreth 180 kilometra larg Milanos.

Gjatë udhëtimit, z. Arbeni, një mërgimtar i vjetër në Itali, e njoftoi Kryetarin në lidhje me jetën e bashkëvendësve tanë si dhe me organizimin e jetës fetare në përgjithësi në shtetin Italian. Ishte shumë mbresëlënës fakti se të gjithë shqiptarët, pavarësisht se nga vinin, Maqedonia, Kosova apo Shqipëria, kishin formuar një komunitet të fuqishëm dhe unik. Organizimi i tyre ishte mjaft i suksesshëm, ndërsa të gjitha manifestimet i bënë bashkërisht. Nga ana tjetër vërehej edhe një respekt nga vendasit të cilët kishin formuar simpati të mëdha ndaj këtyre



mërgimtarëve të cilët me sjelljet e tyre shembullore dhe me punën e ndershme jepnin pasqyrë shembullore për shoqërinë në të cilën vepronin.

Pas një pushimi të vogël, Kreu i BFI-së Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, u nis për të takuar Kryebashkiaken e Casaloldos zonjën Patrizia Leorati, e cila kishte mjaft njohuri për Islamit në përgjithësi si dhe për komunitetin musliman që vepron në qytetin që udhëhiqej prej saj.

Pak para se të fillonte takimi, z. Arben Elezi e njoftoi Kreun e BFI-së për ndihmën e sigurtë që Kryebashkiakja ua kishte ofruar komunitetit musliman në këtë rajon si dhe për administratën tepër korrekte të kësaj komune, gjatë ngritjes së tempullit fetar gjegjësisht Xhamisë Nur.

Në takimin me zonjën Patrizia Leorati, Reis ul Ulemaja ishte i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit Agron Vojnika, Kryetari i Qendrës Kulturore Islame e Shqiptarëve të Maqedonisë dhe imami i caktuar nga BFI-ja në xhaminë Nur z. Reshat Ibishi.

Fillimisht Kreu i BFI-së e njoftoi znj. Loreati me veprimtarinë dhe organizimin e Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni si dhe organizimin dhe veprimtarinë jashtë vendit,



siç është rasti me Qendrën Kulturore Islame e Shqiptarëve të Maqedonisë në Itali dhe simotrave të tjera në mbarë vendet e Evropës.

Kryebashkiakja e Casaloldos u befasua këndshëm nga fjalët e Reisit dhe i premtoi Atij që në të ardhmen do të bën edhe më tepër që ta ndihmon Qendrën Kulturore Islame të Shqiptarëve të Maqedonisë në integrimin sa më dinjitoz në shoqërinë italiane.

Përderisa po i afrohej fundi takimit në Komunë, po afrohej edhe koha e Iftarit dhe delegacioni ishte i detyruar që të përshëndetet me Kryebashkiaken dhe ti falënderohet asaj për gjithë ndihmën e dhënë.

Në brigjet e liqenit më të njohur në Itali, Manerba, ishte përgatitur edhe iftari i shtruar në nder të Reis ul Ulemasë, në Hotel Restorantin Bellerive, ku pronari ishte një shqiptar – biznesmen i suksesshëm, i cili pas rrëzimit të sistemit diktatorial në Shqipëri kishte migruar bashkë me familjen e tij. Familja e tij kishin arritur të bëheshin pronarë të disa restoranteve prestigjioze në atë rajon. Vlen të theksohet fakti se në çdo rast i kishin dalë në ndihmë komunitetit musliman gjatë të gjitha aktiviteteve fetare dhe organizimit të jetës

fetare.

Shumë bashkatdhetarë prisnin në hyrje të restorantit dhe i dëshiruan mirëseardhje Reisit. Iftari ishte shtruar në një kombinim mes kuzhinës italiane dhe asaj shqiptare. Fillimisht u shtrua një specialitet me oriz dhe fruta deti e më pas, sipas traditës shqiptare u soll edhe një qengj i pjekur në hell.

Fatkeqësisht, menjëherë pas ngrënies së Iftarit, delegacioni duhej të çohet, duke mos e shijuar pak më gjatë atë ambient të bukur në brigjet e liqenit “Romantica of Manerba”, sepse rruga deri në xhaminë Nur merrte rreth 40 minuta, e po afronte koha e taravisë.

Sapo u afuam në hyrje të xhamisë, vërehej entuziazmi i të pranishmëve. Turma njerëzish me padurim prisnin të takohem me Udhëheqësin shpirtëror të muslimanëve të Maqedonisë dhe të shtrëngonin duart me të. Sapo hyri Reis ul Ulemaja në Xhami, të gjithë të pranishmit u futën brenda dhe zunë vendet e tyre duke e mbushur përplot xhaminë.

Imami Reshat Ibishi e njoftoi xhematin se ligjëratën e asaj nate do ta mban Reis ul Ulema i Bashkësisë Fetare Islame në RM, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Kreu i BFI-së fillimisht i përshëndeti të pranishmit duke ju dëshiruar agjërim të lehtë dhe suksese në punët e tyre. Ai gjithashtu foli për rëndësinë e muajit të bekuar të Ramazanit si dhe për aktivitetet e BFI-së si në vend ashtu edhe jashtë. Reis ul Ulemaja gjithashtu kërkoi nga të pranishmit që të vazhdojmë me punë të mira dhe të jenë shembullorë në çdo veprimtari të tyre, sepse vetëm ashtu mund ta përfaqësojnë kombin tonë dhe fenë tonë në mënyrë dinjitoze.

Vlen të theksohet se ligjëratë e Reis ul Ulemasë u transmetua drejt për drejt në radion elektronikë që e posedonte kjo xhami, të cilën mund ta ndjekin të gjithë në internet, në ueb faqen www.radio-besimi.com.

Pas faljes së laravisë, reisi i shoqëruar nga Kryetari i Qendrës - Arben Elezi, Nënkryetarët Faik Aliu dhe Fari Saliu, si dhe nga Imami Reshat Ibishi, dolën në tavernën e xhamisë ku për disa orë, deri në syfyr, u shoqëruan me xhematin – bashkatdhetarë tanë që punojnë dhe veprojnë në Itali.

TRIBUNË FETARE ME RASTIN E NATËS SË MADHE TË KADRIT NË QENDRËN SHQIPTARE ISLAME NË ÇIKAGO

Nata, në të cilën filloi të zbret fjala hyjnore

Me datë 15-09-2009 delegacioni i BFI-së i cili po qëndron për vizitë zyrtarë në SHBA së bashku me imamin dhe këshillin e xhamisë së Qendrës Shqiptare në Chicago ka organizuar një tribunë fetare për nderë të natës së madhe të Kadrit me temë: "Vlera dhe rëndësia e natës së Kadrit"

Tribuna në fjalë u hap nga këndimi i një pjese të Kur'anit nga ana e hafiz Sabaatin Nuhijut, e që pastaj për të pasuar fjalimi i imamit të xhamisë së kësaj qendre Lulzim ef. Musaj, i cili falënderoi besimtarët për praninë e tyre duke shpjeguar në pika të shkurtra vlerën dhe rëndësinë e natës së madhe të Kadrit.

Ndërkaq, pas kësaj pasuan prezentimet e përfaqësuesit të BFI-së në R.M Skender ef. Buzakut i cili në mënyrë sitematike elaboroi vlerën dhe rëndësinë e kësaj natë, në veçanti kur kemi parasysh se kjo natë festohet nga shqiptarët e diasporës me plotë gëzim dhe entuziazëm.

Përfaqësuesi i BFI-së Skender ef. Buzaku u përcjelli



urimet e Reis ul Ulemasë së BFI-së në R.M, H. Sulejman ef. Rexhepit, duke nënvizuar edhe rolin dhe rëndësinë e madhe të BFI-së në R.M që tregon edhe për besimtarët te komunitetit shqiptar që jetonjnë në Amerike. Poashtu u theksua edhe rëndësia dhe sukcesi gati tridhjetë vjeçar i Medresesë Isa-Beu Shkup si dhe funksionimi dhjetë vjeçar i Fakultetit të Shkencave Islame në drejtim të

arsimimit, edukimit dhe profesionalizimit adekuat të brezave të ardhshëm. Në fjalim u bashkangjit edhe ish imami i kësaj qendre Arben ef. Tairi i cili theksoi vlerën dhe rëndësinë e kësaj nate në veçanti rolin e qendrës islame për organizimin sa më të mirë të komunitetit shqiptar në Amerikë. Vlen të theksohet se në këtë tribunë madhështore me ftesë zyrtare nga këshilli dhe imami i

kësaj qendre ishte i ftuar edhe konsulli special i Maqedonisë në Chicago, z. Muhamed Rakipi i cili mbajti fjalë rasti duke i përshëndetur të pranishmit dhe qendrën, për punën dhe aktivitetin e tyre në ruajtjen dhe kultivimin e traditës dhe vlerave fetare dhe kombëtare. I njëjti theksoi se konsullata gjenerale e Maqedonisë në Chicago do të jetë e gatshme që në bazë të kompetencave të saja që posedon do të jetë e gatshme që në çdo kohë të plotesojë çdo kërkesë dhe nevojë të qytetarëve të Maqedonisë. Në fund u lexuan pjesë të Kur'anit dhe ilahi nga hfz. Sabaatin Nuhiju, kurse pas namazit të teravisë të pranishmit patën rastin që të marrin pjesë në koktelin i cili ishte i organizuar nga veprimtarët e kësaj qendre shqiptare në Chicago të Amerikës. Ne fund duhet theksuar që në këtë tribunë madhështore prezentuan një numër i madhë i mysafirëve nga tërë rajoni i komunitetit shqiptar të Ilionoisit, duke mos harruar edhe mysafirët e ndershëm së bashku me këshillin e xhamisë së Kenoshes.



RIASETI I BFI-SË NË KUADËR TË AKTIVITETEVE TË RAMAZANIT 2009

Ripërtërirja e vlerave fetare dhe shoqërore

Riaseti i Bashkësisë Fetare Islame në kuadër të aktiviteteve të tij për muajin e shenjtë të Ramazanit për vitin 2009 formoi komision qëndror për realizimin e vizitave të të gjitha Myftinive të cilat janë pjesë përbërëse të saj.

Komisioni i lartpërmendur gjatë muajit të Ramazanit i ka vizituar të gjitha Muftinitë me çka na bëhet me dije se janë vizituar një numër i madhë i qytetarëve musliman në vendin tonë. Kryetari i BFI, H. Sulejman ef. REXHEPI edhe për skaj shumë angazhimeve të tij jasht shtetit ku kishte një numër shumë të madh takimesh me krerë të bashkësisë fetare të shteteve tjera, si dhe udhëtimin e tij zyrtarë për të vizituar xhematin tonë shqiptarë në Austri dhe Itali, ai gjithashtu realizoi disa vizita tek xhematet tona në vend. Anëtarët e komisionit të Riasetit nëpërmjet ligjeratave dhe takimeve me xhematet kanë përcjell porosinë dhe mesazhin e BFI lidhur me këtë muaj të shenjtë, ndërsa me aktiviteteve të tyre të ndryshëm njëherit kanë prezentuar veprimtarinë institucionale të BFI si dhe gjitha projektet të cilat janë në realizim e sipër. Në prezentimet e tyre kanë shpalos edhe të arriturat e BFI, por të mbetur me shpresë se edhe shumë projekte të tjera që janë në vijim do të realizohen së shpejti. Të bindur në kapacitetin intelektual, institucional dhe realizues të BFI kanë kërkuar që ta mbështesin institucionin në fjalë në çdo iniciativë të marrur në interes të besimtarëve musliman dhe të BFI-së. Të vetëdëshëm për kontributin e besimtarëve mbi ruajtjen e fesë, parimeve dhe traditës së pastër Islame në këto hapësira kanë përkujtuar dhe definuar se xhamati i xhamive përbën bazën më të fortë të ruajtjes dhe zhvillimit të jetës dhe vlerave fetare në vendin tonë. Në të kaluarën të

gjitha këto elemente pozitive janë ruajtur nga gjeneratat e kaluara dhe se të njëjtët kanë lënë trashëgimi te gjeneratat e reja dhe se ruajtja e po këtyre vlerave mund të bëhet vetëm në këtë formë. Bashkëpunimi dhe respektimi i institucionit më të lartë fetar BFI duhet të jetë në nivelin e duhur dhe se përmes veprimtarisë së këtij institucioni edhe më tej fuqizohet interesi i mbrojtjes së kulturës, traditës dhe gjithë asaj që është trashëguar në të gjitha format nga gjeneratat e kaluara. Poashtu nga ligjëruesit e komisionit të BFI-së është theksuar se Ramazani duhet të shërbejë te ne në formën më të përsosur që të edukohet shoqëria e në veçanti perspek-

tiva e këtij populli. Agjërimi luan rol pozitiv në shumë aspekte për vet faktin se llogaritet muaj i edukimit, zbritjes së Kuranit, kulturës, devotshmërisë, faljes, pendimit etj. Muaj ku dominojnë solidariteti dhe humanizmi në mesin e myslimanëve, nuk hetohen vështirësitë që i përjetojnë të varfërit në përditshmëri për dallim nga të pasurit, e as nevojtarët nga ata që kanë me bollëk, ndërsa në anën tjetër na edukon që urrejtja, përgoimi, egoizmi, dhuna, mendjemadhësia janë dukuri devijante dhe patologjike të cilat e infektojnë dhe e dirigjojnë shoqërinë kah çrregullimet e njësimeve. Bashkësia Fetare Islame është

syçelë kur janë në pyetje zgjerimi i institucioneve edukativo-arsimore, ngase vetëm në atë mënyrë mund të ndihmon në ndërtimin e shoqërisë dhe ta pasuron me vlera të pashterrshme shoqërore. Apeli permanent i këtij institucioni ka qenë se Institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore të BFI-së janë vepër e çdo të punësuarit në BFI, udhëheqësisë së BFI-së, të imamëve, hatibëve dhe të gjithë nëpunësve por mbi të gjitha ato janë vepër e çdo myslimani në RM sepse me mjetet e tyre janë ndërtuar objektet e nevojshme, me kontributet e tyre janë mirëmbajtur dhe po bëhet edhe më tej në atë mënyrë. Por nuk duhet harruar se edhe shumë objekte fetare janë në fazën e ndërtimit e që do të jenë në shërbim të popullatës myslimane. Tani po shihet se sa i dobishëm ka qenë hapi i BFI-së në hapjen e paraleleve të Medrsesë Isa Beu, edhe atë të djemëve në Shtip dhe të vajzave në Shkup, Tetovë dhe Gostivarë. BFI me themelimin e këtyre shkollave posedon të dhëna se teologët e diplomuar në rajonin e Maqedonisë Lindore janë duke dhënë kontribut në shumë drejtime. Meqë ekzistonte mundësia e asimilimit të myslimanëve të asaj ane apo nga zhdukja e përgjeshme të gjurmëve të Islamit dhe trashëgimisë së myslimanëve. Aktivitetet e tyre kanë bërë që të ringjallet Islami, myslimanët dhe shoqëria. Aty edhe më tej të zhvillohet kultura dhe tradita e pastër islame. Me mjetet e tyre ato predikojnë dhe kryejnë misionin e tyre fetar dhe mu për këtë gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, myslimanët janë më të thirrurit që të mos lejojnë mbylljen e tyre por me ndihmat e tyre të vazhdojnë zinxhiri i zgjerimit të tyre edhe nëpër qytetet tjera. Riaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RM në përputhje me



vlerat e shenjta të muajit të bekuar të Ramazanit si dhe në përputhje me traditën ekzistuese vazhdimisht ka apeluar Myftinive të BFI-së, që edhe më tej të kontribuojnë në këto drejtime dhe sfera për të siguruar vlerat e shumtë që kanë mbetur tek ne nga e kaluara dhe për të pasur një të ardhmen të ndritur shoqërore. Në anën tjetër meqë shkollimi i mesëm është bërë obligativ për çdo qytetar atëherë BFI, me shumë arsye vepron që t'u mundëson vazhate myslimane të ndjekin mësimet nëpër shkolla fetare me të vetmin qëllim që të mbron dhe ruan moralin e femrës në shoqëri, a njëherit ta ndërton në frymën më të fuqishme që në të ardhmen si nënë t'i shërben shoqërisë në tërësi. Mes tjerash nga anëtarët e komisionit në fjalë në çdo xhemat janë prezentuar datat më të rëndësishme dhe më me peshë në kalendarin islam dhe duke përcjellur tek ata mesazhet që burojnë nga këto momente të paharruara të historisë Islame dhe njerëzore. Ajo që e ndërlidh njeriun dhe jetën e tij gjatë këtij muaji është fakt i pamohueshëm ngase pikërisht në këtë muaj përfundoi etapa e errësirës dhe filloi etapa e lindjes së dritës së Allahut e cila do të shndërrisë mbi të gjithë ata që ndjekin dhe respektojnë principet e fesë Islame.

Në të është dita kur përgjithmonë edhe në aspektin material u fitua besimi ideologjik dhe atë me një adhurim të lartë dhe besim të fortë mbi të vetmin krijues Allahun xh.sh. dhe ajo ditë është pa dyshim Dita e Bedrit. Në Ramazan është nata e të gjithë netëve, nata më e veçant e vitit, nata e Kur-anit, nata kur njeriu me ndihmën e Allahun xh.sh. e mund jo njeriun në vetvete, ajo është nata e Lejletul Kadrit. Kjo natë është më e shenjtë se një mijë muaj në vitë, është nata kur në çdo zemër të myslimanit sjell shpëtim. Për shkak të meritave të lartpërmendura të muajit të bekuar të Ramazanit dhe shumë meritave të tjera, Myftinjtë e BFI-së në RM ishin të detyruara që të krijojnë kushte për ibadet të përditshëm në shtëpitë e Allahut, në xhami, të sigurojnë vaiz dhe muderisë që të interpretojnë Islamin në përputhje me

burimet nga Kur-anin a.sh dhe sunneti i Muhammedit a.s. në korniza të shpirtit dhe normave në shkollës hanefite e mbrojtur edhe më Kushtetutën e BFI-së në RM si një shkollë e drejtë nëpërmes së cilës i realizojnë ibadetet ndaj Allahut xh.sh. BFI është nisur nga patjetërsueshmëria e interpretimit të drejtë të normave islame dhe vendosjes së etikës dhe ahlakut islam, krijoi rrjetin e institucioneve arsimore fetare në territorin e RM-së.

Që nga viti i largët 1983 rihapi medresenë shumëshekullore të Isa Beut në kryeqytetin e Shkupit, ndërsa vetëm pas një dekade të rihapjes së Medresesë me dëshirën e të Gjithëditurit, për herë të parë në hapësirat tona u hap edhe një institucion fetarë i arsimit të lartë e ai është Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup. Pikërisht këto paralele të disperzuara të cilat i thërrasin kështu për shkak të sistemit të brendshëm arsimorë të BFI-së, në fakt ato janë Medrese të pavarura të cilat mbledhin gati 650 nxënës dhe nxënëse, ku së bashku me fakultetin afër 1000 bijë dhe bijat tona e fitojnë arsimin e tyre në institucionet arsimore të BFI-së në RM. Falë kontributit të besimtarëve në vend dhe diasporë sot po funksionojnë këto institucione edukativo-shkencore fetare në kuadër të këtij institucioni shpirtëror fetar. Andaj, Bashkësia Fetare Islame mbanë llogari edhe për myslimanët nga Maqedonia, të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, në të ashtuquajturën Diasporë, ku gjithnjë e më shumë hapen xhami dhe qendra islame në vendet evropiane: Gjermani, Zvicër, Austri, Itali, Norvegji, Suedi si dhe në vendet tjera më të largëta si Amerika, Kanada dhe Australia. Detyra islame dhe solidarizimi vëllazëror na detyrojnë të mos i lejmë vetë por të jemi së bashku me ata. Pikërisht për këtë çdo herë në Ramazan BFI-ja dërgon delegacione për t'i vizituar dhe së bashku me ata, larg vendlindjes t'i kalojnë ditët e bekuara në ibadet, ligjërata, udhëzime dhe këshilla, dhe se njëkohësisht t'i freskojnë me informata të bujshme pozitive nga vendlindja. Angazhimi i besimtarëve tonë në mërgim deri

tani për të ndihmuar Bashkësinë Fetare Islame në RM me të vërtetë ka qenë shumë i madh. Me ndihmën dhe përkrahjen e tyre janë hapur Medresetë për gjininë mashkullore dhe femërore dhe gjithashtu është hapur Fakulteti i Shkencave Islame. Andaj, në veçanti nxënësit e Medresesë Isa Beu dhe studentët e FSHI janë mirënjohës dhe falënderues për veprën e shenjtë që kanë bërë dhe bëjnë mërgimtarët tanë. Dhe se shpresa e tyre është që Allahu i Plotfuqishmi t'u jep forcë dhe vullnet për të vazhduar ndihmën e tyre ndaj këtyre institucioneve arsimore të BFI-së duke e lutur vazhdimisht Allahun që t'i shpërblen me nimetet e tij të pafundë. Nga të gjithë është dëshmuar se duhet kuptuar që deri sa të ekzistojnë Medreseja dhe Fakulteti i Shkencave Islame do të mbijetojmë si në aspektin shpirtëror fetar ashtu edhe në aspektin kombëtar dhe biologjik. Ne i financojmë ato, ndërsa ata na sigurojnë neve mbijetesën e përhershme. Në kuadër të kësaj nga antarët e komisionit është potencuar se për të gjitha këto gjëra Bashkësia Fetare Islame në R.M në mënyrë maksimale është e përgatitur që të ballafaqohet me të gjitha këto sfida. Në anën tjetër me theks të veçantë është potencuar se BFI gjithnjë ka apeluar dhe porositur që të edukohen dhe arsimohen gjeneratat e reja të cilët janë edhe ardhmëria jonë. Të gjithë të diplomuarit që janë prodhim i këtyre institucioneve edukativo-shkencore tani më janë shërbëtor të shoqërisë dhe kreatorë të ndryshimeve të reja shoqërore. Komisioni në fjalë vazhdimisht i ka falënderuar xhematet për përkrahjen që ia kanë dhënë BFI në fushëveprimin e saj por njëherit u kanë shpreh mirënjohje për kontributin dhe orvatjet e bëra deri më tani. Element shumë i rëndësishëm që është më se e arsyeshme të theksojmë se këtë vitë gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit u realizuan programe të ndryshme me karakter fetar nëpër të gjitha myftinitë e BFI, pjesëmarrja nëpër mediumet elektronike dhe të shkruara gjatë muajit të Ramazanit, realizimi i tridhjetë emisioneve fetare në Radio Shkupin gjatë muajit të madhërisëm

të agjërimit, programet e realizuara nga paralelja e vazhate të medresesë Isa-beu, Shkup, dua hatmeja në fshatin Drogomisht i vogël, mbrëmja Kuranore në Llabunisht të Strugës, programi festiv me rastin e natës së madhe të Kadrit të organizuar nga Myftinia e Shkupit, etj. Dua hatmeja e organizuar nga imami i fshatit Drogomisht i Vogël dëshmoi interesin dhe nevojën e grupmoshave të reja për mësimbesimin fetar. Dua hatmeja u realizua në prani të shumë besimtarëve, shumicë e të cilëve ishin gurbetçarë, ndërsa për nivelin organizativ na fliste atmosfera e këndshme dhe shpresëdhënëse që mbretëroi. Imami në fillim të programit përshëndeti të pranishmit dhe shprehi falenderime për pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së H. Afrim ef. Tahiri, Myftiun e Kërçovës, Murat ef. Huseini, Myftitë të Myftinive tjera të BFI, Dekanin e F.SH.I, Drejtorin dhe Profesorët e Medresesë Isa Beu, etj. Fjalë përshëndetëse para të pranishmëve kishte Myftiu i Myftinisë së BFI – Kërçovë, Murat ef. Huseini i cili vlerësoi angazhimin e Imamit dhe kontributin e tij të dhënë tek fëmijët dhe ardhmëria e popullit. Ai shprehi kënaqësi të veçantë për interesimin dhe vullnetin e lartë që kanë të rinjtë për të mësuar dhe nxënë dije nga Libri shenjtë Kurani famëlartë- fjalë e përkryer hyjnore e Allahut xh.sh. Fjalë rasti mbajti Sekretari i Përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tahiri i cili përshëndeti të pranishmit në emër të BFI-së, në emër të kryetarit të saj Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi si dhe në emër të tij, mes tjerash tha: "Duhet t'i falënderohemi Allahut f.p. që keni arritur të keni kaq shumë nxënës me vullnet të lartë për të mësuar leximin e Kuranit dhe njohuri fetare Islame. Puna që ka bërë imami i fshatit i cili shquhet për nga angazhimet e tija dhe zhvillimit të mësim-besimit fetar vite me rradhë është vepër për çdo lavdatë dhe respekt. Të mësosh leximin e Kuranit dhe të përgatisish gjeneratat e reja në aspektin fetar, etik dhe moral gjithashtu është një punë që vetëm Zoti dinë të shpërblen imamin, ndërsa juve t'iu begaton me të mirat e Tij

që i keni krijuar kushte pune. BFI nuk ka qenë dhe nuk është e interesuar për ta shtuar vetëm numrin e xhamive, Ne edhe më tej jemi të interesuar dhe angazhohemi në atë drejtim që çdo imam në xhamin ku vepron të luan rolin e tij si predikues dhe reformator fetar, të jetë në shërbim të besimtarëve përmes mësim-besimit dhe edukimit të përgjithshëm, përmes ngritjes dhe formimit të gjeneratave të reja. I kënaqur nga këto nxënës që sot para nesh me sukses të lartë u prezentuan, si dhe duke i njohur mundësitë e imamit tuaj të nderuar, kërkoj që tanimë të veprohet edhe më gjërë duke e rritur numrin e nxënësve dhe në këtë formë të ruaj dhe mbrojmë traditën e mësimbesimit fetar nëpër mektebe. Sekretari i Përgjithshëm i falenderoi për ftesën dhe për mundësinë që iu dha të jet pjesë e një atmosfere të atillë, uroi për suksesin nxënësit, prindërit e tyre, imamin, myftininë dhe iu lut Allahut xh.sh. që edhe më tej të ndihmon Imamin e fshatit dhe shoqërinë e kësaj ane që të vazhdojnë edhe më tej të pafalodhur në fushëveprim. Vlenë të theksohet se edhe këtë vitë në muajin e Ramazanit sikur çdo vitë tjetër në fshatin Llabunishtë të Strugës u mbajtë "Mbrëmje Kur'anore" manifestim i cili ishte i organizuar nga imami dhe këshilli i xhamisë së fshatit e që i njëjti ishte në bashkëpunim me Myftininë e Strugës. Në këtë manifestim

ishte i ftuar edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në R.M, h. Sulejman ef. REXHEPI, prania e tij e bëri edhe më famoze këtë mbrëmje për qytetarët e Llabunishtës, për qytetarët e Strugës dhe për mbarë qytetarët e Maqedonisë pasi që aty prezentojnë besimtarë nga i mbarë vendi. Kreu i BFI ishte i shoqëruar nga Myftitë e Myftinive të BFI në krye me Myftiun e Myftinisë së Strugës, dr. Ferat POLISI pasi që nikoqir ishte Myftinia në fjalë, dhe të njëjtit në mënyrë më të denjë u pritën nga imami, këshilli dhe xhemati i xhamisë së fshatit Llabunishtë.

Fjalë përshëndetëse kishte Myftiu i Myftinisë së Strugës Dr. Ferat POLISI i cili në emër të Myftinisë së Strugës dhe në emrin e tij personal përshëndeti Reis ul Ulemanë, Kryetarin e BFI, anëtarët e Riassetit, muftinitë si dhe të pranishmit tjerë duke uruar që ky manifestim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Fjalë rasti mbajti H. Sulejman ef. Rexhepi i cili në emër të tij personal dhe të BFI përshëndeti Myftiun e Myftinisë së Strugës Dr. Ferat POLISIN si dhe operativën e muftinisë në fjalë, imamin dhe këshillin e xhamisë, myftitë të myftinive tjera të vendit, hafizët, imamët, si dhe musafirët tjerë që ishin prezent. Në fjalimin e tij theksoi mbi vlerat që ka ky muaj i madhërishëm, ku një ndër ta është nata ku filloi të zbret fjala më e përsosur hyjnore e Krijuesit Absolut Allahut

xh.sh., Kurani f.l. Mes tjerash Reis ul Ulema shtoi se: "Besimtarët më të denjë janë ata që e mësojnë fjalën e Allahut të njëjtët ua transmetojnë dhe mësojnë të tjerëve dhe po ata përcjellin mesazhet që burojnë nga ky libër. Shoqëria duhet të ketë gjithnjë synim kryesor që të edukohet dhe arsimohet. Të njëjtat porosi janë edhe parim detyrues Islam që determinojnë myslimanin të ndjek rrugën e integritit, zhvillimit dhe progresit." Në këtë mbrëmje kuranore morrën pjesë hafizlarë nga Shkupi, Tetova, Kumanova, lexues nga Struga etj. Për të cilët në fund h. Sulejman ef. Rexhepi u ndau shpërblime për lexuesit në këtë mbrëmje të hareshme kuranore në Llabunishtë të Strugës. Për këtë muaj të bekuar syfyrimin e fundit e realizuam në Kërçovë i shtruar nga Myftiu i Myftinisë së Kërçovës, Murat ef. Huseini, të cilin Reis ul Ulema e luti Allahun e Plotë fuqishëm që ta bekon ate, familjen e tij dhe mbarë besimtarët mysliman. Vlenë të theksohet se me rastin e natës së madhe të Kadrit, Myftinia e BFI-së Shkup në bashkëpunim me Riassetin e BFI-së me datë 15.09.2009 në xhaminë e Haxhi AZEMI-Shkup, pas namazit të Ikindisë organizoi një manifestim madhështorë të këndimit të mevludi sherifit. Në këtë manifestim mori pjesë Kryetari i BFI-së, H. Sulejman ef. REXHEPI, Sekretari i BFI-së Afrim ef. Tahiri dhe Myftiu i Shkupit Ibrahim ef. SHABANI, anëtarët e Myftinisë, hoxhallarë,

hafizlerë dhe xhematë të shumtë. Udhëheqës i këtij programit ishte referenti fetar-arsimor pranë Myftinisë së Shkupit Ismet BYTYQI, i cili kontribuoj që programi përveç të jetë i begatuar me këndimin e disa pjesëve nga mevludi dhe Kurani famëlartë, bëri edhe më madhështorë këtë program me aktivizimin e kënduesve të t j e r ë . Kryetari i BFI-së, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. REXHEPI mbajti fjalë rasti i cili përshëndeti të pranishmit në emër të BFI dhe në emrin e tij personal duke thënë se: "Sonte është nata më e çmuar dhe më e begatshme e vitit, ajo është më e vlefshme se një mijë muaj, mbi të gjitha në këtë natë ka filluar të shpallet Kur'ani! Ai është kushtetuta e myslimanëve, në bazë të asaj duhet jetuar dhe vepruar. Ajo është fjala më e përsosur e shpallur për mbarë njerëzimin dhe periudhat kohore..., me atë fjalë jemi ngritur si popull (ummet, shoqëri) dhe ajo është e vetmja me të cilën edhe më tej do të frymojmë..." Në fund Reis ul Ulema uroi këtë natë të bekuar dhe se të gjithëve u bëri apel që të kalojnë këtë natë në adhurim, përkulje dhe duke kërkuar falje për lëshimet e tyre tek Allahu Fuqplotë, në anën tjetër duke e lutur Allahun xh.sh që çdo lutje, ibadet dhe namaz që bëhet Ai t'i pranon nga besimtarët. Duanë e këtij manifestimi fetar e realizoi Kryeimami i Myftinisë së Shkupit, Sabedin ef. AMETI.

URIMI I FESTËS MADHËSHTORE TË FITËR BAJRAMIT

Drejtuar: Besimtarëve në vend dhe Diasporë

Kam kënaqësi të veçantë që me rastin e festës madhështore Islame, Fitër gjegj. Ramazan Bajramit, i cili sipas Takvimit për vitin 2009 është më 20 shtator (e dielë), besimtarëve mysliman në Maqedoni dhe gjithë besimtarëve në diasporë t'ua uroj Festën e Fitër Bajramit, me dëshirë për shëndet të mirë dhe lumturi në jetë, duke e lutur All-llahun xh.sh. që t'i pranojë lutjet dhe ibadetet tona të bëra gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.

Ju qoftë për hajr Fitër Bajrami!

*Me shumë kënaqësi dhe respekt,
Reisul-Ulema i BFI-së
H. Sulejman ef. Rexhepi*



Manifestimi i festës së Fitër Bajramit

Fitër Bajrami simbolizon ditën e shpërblimit, ditën e faljes, gëzimit, haresë dhe solidaritetit

Më 20.09.2009 besimtarët mysliman shqiptarë në Maqedoni së bashku me gjithë bashkatdhetarët të trojeve etnike dhe të diasporës, ashtu siç po feston e gjithë bota islame, kremtojnë festën madhështore fetare islame - Fitër Bajrami!

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, krerët e shtetit, liderë politik, ambasadorë dhe përfaqësues të bashkësive tjera fetare, kanë përgëzuar kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi dhe qytetarët myslimanë të Maqedonisë.

Pasi që kaluam një muaj nën hijen e mëshirës së Zotit, nën shenjën e mirësisë dhe të përlësisë, të sakrificës, të tolerancës dhe dashurisë ndërvël-lazërore, Fitër Bajrami simbolizon për të gjithë besimtarët myslimanë ditën e shpërblimit, ditën e faljes, gëzimit, haresë dhe solidaritetit.

Gjatë tërë muajit të Ramazanit, në të gjithë vendin u organizuan një sërë manifestimesh me karaktere të ndryshëm, për nder të këtij muaji të rëndësishëm të kalendarit islam, nëpër qindra e mijëra xhami u fal namazi i teravisë, dhe se e gjithë kjo u shoqërua duke mos i harruar edhe ata që kanë nevojë për ndihmën tonë. Qindra besimtarë ishin prezentë në xhaminë e Isa Beut në qendër të Shkupit, ku edhe u realizua manifestimi qendrorë i Bashkësisë Fetare Islame me rastin e festës madhështore të Fitër Bajramit. Pas faljes së namazit të sabahut vijoi program madhështor i begatuar me ashere, ilahi i realizuar nga kori i Medresesë Isa-Beu i udhëhequr nga M-r. Abaz Jahja, të cilën për së afërmi e ndoqën qindra besimtarë nën shoqërinë e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H.

Suljeman ef. Rexhepi si dhe nga myftitë e myftinive të BFI në R..M.

Dita e Fitër Bajramit, pas një muaj agjërimit për të gjithë besimtarët janë momente të veçanta, reflektimi i së cilëve është i paskajshëm. Festë ku gjallëria është e shkallës më të përsosur ngase të gjithë përshëndesin dhe urojnë festën e madhe, nuk ekzistojnë dallime dhe ndasi. Në këtë festë të gjitha opinionet negative eliminohen dhe mbi të gjitha dominon buzëqeshja dhe gëzimi. Bajrami i Ramazanit ashtu siç edhe e quajmë ndryshe njihet si festë e devotshmërisë, por edhe dëshmi e solidaritetit dhe vëllazërisë. Kjo festë fillon në ditën e parë të muajit Shevval, hëna e të cilit lind pas përfundimit të muajit të Ramazanit. Andaj të gjithë besimtarëve në vend dhe në diasporë përmes një mesazhi iu drejtuar, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi, u bëri thirrje për solidarizim me skamnorët, të paafët dhe të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën e njëri tjetrit. Ai tha se Islami është fe e tolerancës dhe e paqes andaj edhe gjykon në formën më të ashpër dhunën dhe përdorimin e saj për qëllime të ndryshme. Kryetari i BFI uroi që kjo festë të sjellë me ndihmën e Zotit gëzim, lumturi dhe harmoni midis njerëzve.

Më pas në ambientet e BFI-së u shtrua mëngjesi tradicional i Bajramit i shoqëruar me bakllavw dhe me ëmbël-sira të tjera, për të gjithë të punësuarit dhe muftijtë prezent, të cilët kishin ardhur nga qytete të ndryshme të vendit për të marrë pjesë në faljen qendrore të Fitër Bajramit.

Ky program u transmetua nga televizioni shtetëror MTV me ç'rast kishin mundësi ta ndjekin të gjithë qytetarët e vendit. Bazuar në Ligjin për festat zyrtare, dita e hënë, 21 shtator, është shpallur ditë pushimi, për nder të festës së Fitër Bajramit.

TAKIMET E REIS UL ULEMASË GJATË DITËS SË BAJRAMIT

Më datë 20 Shtator 2009 mbarë bota islame kremtoi festën madhështore të Fitër Bajramit. Këtë festë e cila nxjerr në pah vlerat tona islame, të cilat ndërtojnë harmoninë dhe bashkëjetesën në atdheun tonë dhe shndrisin rrugën e ardhmërisë sonë, u festua edhe në Republikën e Maqedonisë, me një mesazh të dalë nga Kreu i BFI-së, që këto vlera njerëzore të ruhen, kultivohen dhe të shpërndahen tek të gjithë qytetarët e Maqedonisë

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë manifestimin qendror të kësaj dite të madhe e shënoi në xhaminë e Isa Beut në Shkup. Madhështia e kësaj feste ka bërë që një numër tepër i madh i besimtarëve myslimanë të vizitojnë këtë xhami për të përcjell për së afërmi manifestimin e kësaj feste madhështore të realizuar nga Bashkësia Fetare Islame në R.M., e cila gjithashtu u transmetua drejt për drejt nga Televizioni Nacional i Maqedonisë TVM Kanali i Dytë, si dhe shumë medimeve të tjera Nacionale dhe private.

Pas faljes së Bajramit dhe programit të begatë, Reis ul Ulemaja i shoqëruar nga muftijtë e Muftinive të Bashkësisë Islame, Dekanit të Fakultetit të Shkencave Islame dhe mysafirë të tjerë, u kthyen në zyrat e Bashkësisë Fetare Islame dhe hëngrën mëngjesin tradicional (me byrek dhe simit pogaçe) që shtrohet për nder të ditës së Bajramit.

Deri në ora 10:30 minuta, fillimisht Reis ul Ulemanë e vizituan imamë, besimtarë dhe punëtorë të shumtë të BFI-së me kombësi të ndryshme, të cilët nëpërmjet Kreut të BFI-së përcollën urime të Bajramin tek të gjithë besimtarët myslimanë në vend me shpresën dhe dëshirën që viti i ardhshëm të jetë edhe më produktiv.

Gjithashtu, para fillimit të takimeve të protokollit, Bashkësia Fetare Islame e RM-së, në ambientet e Rijasetit shtroi një koktej modest me lëngje freskuese dhe me bakllave për të gjithë gazetarët, përfaqësues të medimeve të vendit. Në këtë koktej, u shprehën dëshira për një vit të ardhshëm më të begatë dhe me qasje më profesionale dhe të paanshme, gjatë transmetimit të lajmeve, sidomos atyre që kanë të bëjnë me Bashkësinë Fetare Islame, pasi që në të kaluarën, kemi pasur situata kur në opinion janë plasuar gënjeshtër dhe fabrikime, që nuk kanë pasur asgjë të përbashkët me realitetin.

* * *

Fillimisht, në protokollin e BFI-së ishin të parajlmëruar Kryetari i qytetit të Shkupit, z. Koce Trajanov dhe Kryetarja e Komisionit për Çështje Ndërfetare, znj. Valentina Bozhinovska, të cilët të shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tyre, erdhën dhe ia uruan Bajramin Kreut të BFI-së Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili gjithashtu ishte i shoqëruar nga Sekretari Gjeneral i BFI-së h. Afrim ef. Tairi dhe Drejtori i Sektorit Fetaro-Arsimor h. Jakub ef. Selimovski.



Tradita e bakllavës në BFI

Gjatë bisedës të këndshme dhe nën sfondin e ëmbëlsisë së bakllavës, Reis ul Ulemaja i njoftoi mysafirët për rëndësinë e festës së Bajramit dhe traditës shekullore që po vazhdon edhe sot e kësaj dite në këto troje.

Nga ana tjetër, Prefekti i Shkupit, Z. Trajanovski, në emrin e të gjithë qytetarëve të Shkupit, të gjithë besimtarëve muslimanë në vend ua uroi festën e Bajramit, e cila njëherit është edhe ndër festat më të mëdha fetare në vend. Ai me këtë rast u dëshiroi të gjithë muslimanëve mirëqenie nëpër shtëpitë e tyre dhe plot dashuri e paqe.

* * *

Edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z. Arben Çeku, ishte ndër të parët që kërkoi pranim nga Kreu i BFI-së me rastin e ditës së Madhe të Bajramit. Ambasadori Çeku erdhi në shoqërinë e zëvendësit të tij, z. Shpëtim Lika.

Duke qenë se kjo ishte vizita e parë e z. Çeku në ambientet e BFI-së që kur e mori mandatin si Ambasador në vendin tonë, Reis ul Ulemaja i dhuroi një përkthim në gjuhën shqipe të Kuranit të Madhërisëm dhe disa ekzemplarë me libra të cilat kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve të Maqedonisë.

Nga ana e tij, z. Çeku, në emrin e tij personal dhe në emrin e Ambasadës dhe shtetit Shqiptar, nëpërmjet

Reis ul Ulemasë, ua uroi festën e madhe të Fitër Bajramit të gjithë besimtarëve muslimanë në vend, duke u dëshiruar shëndet, mirëqenie dhe paqe. Gjithashtu gjatë bisedës, Ambasadori i sapoemëruar i Republikës së Shqipërisë, i tha Reis ul Ulemasë se kishte pritur që pikërisht në këtë ditë të madhe dhe me plot kuptim, ta bën vizitën e tij të parë në institucionin e BFI-së.

Më pas u bisedua edhe lidhur me Religjionin gjatë periudhës komuniste dhe pos komuniste në Republikën e Shqipërisë. Theks të veçantë u vu në aspektin se si shteti Shqiptar dhe pikërisht populli në Shqipëri e konceptojnë fenë, duke pasur një traditë të gjatë në respektimin e të gjitha religjioneve. Bashkëjetesa dhe mirëkuptimi mes religjioneve për popullin shqiptar gjithmonë është konceptuar si pasuri, e në asnjë rast si përçarje. Kjo traditë vazhdon edhe sot.

* * *

Diku në mesditë, për vizitë të Reis ul Ulemasë erdhi edhe një nga bashkëpunëtorët e vjetër të këtij institucioni, i cili aktualisht është edhe Kryetar i Komisionit për Verifikimin e Fakteve, z. Agim Mehmeti i shoqëruar nga Nënkrjetari i Komisionit z. Çedomir Damjanovski dhe anëtar i këtij komisioni z. Daut Dauti, të cilët erdhën dhe i uruan për shumë vite Bajramin Reis ul



Ulemasë dhe të gjithë punëtorëve në Bashkësinë Fetare Islame.

* * *

Në ora 12:30 minuta në zyrat e BFI-së erdhi edhe Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, z. Menduh Thaçi, i cili në emrin e tij personal dhe në emrin e PDSH-së ua uroi të gjithë muslimanëve Ditën e madhe të Bajramit.

Gjatë vizitës u biseduan disa tema dhe ngjarje të cilat e tangojnë popullatën muslimane dhe shqiptare në përgjithësi, e posaçërisht theks i veçantë u vu në "Enciklopedinë Maqedonase" të publikuar disa ditë më parë nga Akademia e Shkencës dhe Arteve e Maqedonisë dhe e cila në masë të madhe i fyen shqiptarët dhe shtrembëron faktet e historisë, posaçërisht kur janë në pyetje objektet e kultit fetar islam.

Në sfondin e kësaj bisede, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi e falënderoi kreun e PDSH-së për respektin dhe i dhuroi një libër të botuar para shumë viteve nga Meshihati i Bashkësisë Islame, në Maqedoninë pos komuniste me titull: "Shqiptarët e Maqedonisë". Këtë libër kreu i PDSH-së e cilësoi si Enciklopedia Shqiptare".

Gjithashtu Reis ul Ulemaja e njoftoi z. Thaçi me rëndësinë e këtij libri si dhe për kushtet dhe presionet që u bënë autorëve të këtij libri nga pushteti i asaj kohe, me qëllimin e vetëm që ky libër asnjëherë të mos e sheh dritën, për vetë faktin se ky është libri i parë që pas rrëzimit të regjimit komunist, flet për autoktoninë e kombit shqiptar në rajonin e Maqedonisë së sotme.

* * *

Vlen të theksohet se në Kabinetin e Reis ul Ulemasë erdhën mesazhe të shumta dhe telegrame, nga i gjithë kreu Shtetëror, Kryetari i vendit, Kryeministri, ministra, kryetarë të Bashkësive të tjera fetare në vend, kryetarë bashkësive fetare të vendeve të Ballkanit, dashamirë dhe miq nga e tërë Bota.

REIS UL ULEMAJA VLERËSON GAZETËN KOHA

Mirënjohje për vigjilencën

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i ndau mirënjohje gazetës KOHA, për nismën dhe sensibilizimin energjik të popullatës muslimane, gjegjësisht shqiptare, për të pavërtetatat dhe trillimet e botuara në "Enciklopedinë Maqedonase" të botuar nga Akademia e Shkencës dhe Arteve të Maqedonisë.

Ky medium i përditshëm në gjuhën shqipe, ishte i pari që bëri publike të gjitha gënjeshttrat, trillimet dhe të pavërtetatat e botuara në Enciklopedinë e ASHAM-it. Njëkohësisht në mënyrë permanente dhe të



vazhdueshme, tërë stafi i kësaj gazete ka punuar në mënyrë vigjilente për zbardhjen e atyre të pavërtetave dhe ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në bashkimin e opinioneve të

të gjithë mendimtarëve që duan të kontribuojnë për bashkëjetesën dhe të mirën e këtij vendi.

Shërbimi për Informim i BFI-së.

U shënua dita e shtetit të mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë



Më 28.09.2009 Reis ul Ulema i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi morri pjesë në takimin e organizuar nga Ambasada e mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë me rastin e shënimit të ditës së shtetit të mbretërisë së Arabisë Saudite. Në këtë takim morrën pjesë diplomatë të huaj, Ministra të qeverisë së shtetit Shqiptarë, liderët e bashkësive fetare të Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës, figura të tjera nga skena politike, si dhe udhëheqës të institucioneve të ndryshëm, etj.

Ndërsa, më 29.09.2009 kreu i BFI gjithashtu realizoi takim me Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Selim ef. Muça. Krerët e këtyre dy institucioneve fetare biseduan lidhur me organizimin dhe zhvillimin e jetës fetare, si dhe këmbyen ide dhe përvoja rreth veprimtarisë së këtyre dy institucioneve



Islami na fton në dituri

Të mërkurën më datën 01 tetor 2009, në një atmosferë solemne, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi e shpalli të hapur vitin e ri akademik 2009/2010 në Fakultetin e Shkencave Islame. Në praninë e shumë studentëve dhe stafit akademik të këtij fakulteti, me në krye Dekanin e FSHI-së Mr. Fahrudin Ebibi, ora e parë akademike u mbajt pikërisht nga Kreu i Bashkësisë Fetare Islame në RM, H. Sulejman ef. Rexhepi i cili u shpjegoi studentëve për rëndësinë e studimeve dhe hulumtimeve si dhe sfidave që na presin në të ardhmen. Reis ul Ulema gjithashtu i përshëndeti studentët dhe u dëshiroi shëndet dhe të gjitha të mirat me qëllim që ky vit akademik të jetë sa më i suksesshëm dhe me bereqet. Ai gjithashtu kërkoi edhe nga stafi akademik – profesorët që ta ofrojnë tërë ndihmën e tyre të parrezervë për studentët e rinj.

Në vazhdim vijon fjalimi i Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, me rastin e hapjes së vitit akademik 2009/2010, që e mbajti në amfiteatrin e Fakultetit të Shkencave Islame.

Përshëndetje të nderuar studentë, të respektuar profesorë, Dekan dhe staf i Fakultetit të Shkencave Islame. Më lejoni që fillimisht në emrin tim personal dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë tu përshëndes me përshëndetjen absolute Islame Eselamu Alejkum...

Vërtetë është një kënaqësi e veçantë që sot ndodhem para jush, në këtë orë të parë të vitit akademik 2009 / 2010.

Për shumë nga ju, posaçërisht për studentët që sot e kanë nderin ta ndjekin orën e parë, emocionet e kësaj dite do të jenë të paharrueshme për një kohë të gjatë. Rruga të cilën do të filloni ta trasoni në Fakultetin e Shkencave Islame, do të jetë rruga e ardhmërisë tuaj, prandaj shfrytëzoheni sa më tepër këtë mundësi që po ju jepet. Dituria është dritarja e jetës, por ajo duhet të ndahet edhe me të



tjerët.

Në këtë relacion jorastësisht Allahu Fuqiplotë Muhamedin a.s. ia rekomandoi një dua parimore:

“Thuaj (o Muhamed) O zot ma shto diturinë”.

Dhe jorastësisht ajetet e para Kuranore ishin:

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi, Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur ! Lexo, se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (El- Alek: 1-5)

“Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo musliman.”

E mbaj mend, shumë vite më parë, ishte e pabesueshme se një ditë Bashkësia Fetare Islame do të ketë Fakultet të Shkencave Islame. Madje ishte e pamundur që të besohej një gjë e tillë.

Por falë besimit të palëkundur në Allahun Fuqiplotë dhe sakrificave e angazhimeve të brezave para jush, sot po qëndrojmë kokëlartë në ambientet e Fakultetit, ku për çdo vit mbjelljen fidanët e rinj të Islamit.

Ne i kryem detyrimet tona dhe e çuam në vend amanetin e të parëve tanë. Tani radhën e keni ju të nderuar studentë, që nëpërmjet dijes tuaj, ta përçoni edhe më tej traditën dhe besimin tonë, tek brezat e rinj.

Islami është feja përmes së cilës njerëzimi pranon udhëzimet përfundimtare nga Krijuesi i gjithësisë, duke e aftësuar për mëkëmbës të tij në tokë. Kur’ani i Pavdekshëm vlerëson lartë jetën njerëzore dhe insiston në civilizimin duke bërë thirrje në dituri. Kështu gjejmë se fjala dituri dhe të tillat që kanë të bëjnë me të, në Kur’anin e Pavdekshëm hasen mbi 780 herë. Ajetet e para me të cilat filloi shpallja e Kur’anit ishin pikërisht mbi rëndësinë e leximit, penës dhe diturisë:

Kur’ani i Pavdekshëm thotë se ata që dinë, nuk janë njëlloj me ata që nuk dinë:

“...Thuaj:”A janë njëlloj ata që dinë me ata që nuk dinë...?” (Ez- Zumer:9)

Prandaj ne po investojmë në diturinë, po investojmë në krijimin e intelektualëve të

rinj, që në çdo moment do të dinë të mbrojnë vlerat dhe traditën Islame dhe në çdo moment do të jenë të gatshëm tu bëjnë ballë erërave që po përpiqen ta shkulin këtë besim.

Në këtë drejtim kemi edhe hadithe të shumta, ndër to:

“ Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr.”

“ Ngjyra e pendës së dijetarit do të peshohet me gjakun e dëshmorëve në Ditën e Ringjalljes; dhe pastaj, ngjyra e pendës së dijetarëve do të parapëlqehet më shumë se gjaku i dëshmorëve.”

Sipas fesë islame, respektivisht Kur’anit dhe Sunetit të Muhamedit a.s. shihet se rëndësia e shkencës njihet për dy arsye themelore:

- Roli i shkencës në njohjen e Allahut xh.sh.

- Roli i shkencës në zhvillimin e shoqërisë islame.

Edhe në Kur’anin Pavdekshëm ka shumë ajete që kanë të bëjnë me dituritë natyrore dhe njerëzve u kërkohet që të studiojnë me qëllim që ta njohin Allahun xh.sh. Ajetet që ose përshkruajnë elementet përbërëse të objekteve, ose e urdhërojnë njeriun për t’i zbuluar ato.

Por, dija për dukuritë e natyrës na afron te Zoti vetëm po ta kemi frikë Zotin.

Për këtë arsye El Biruni shkruan:

“Kur njeriu të vendos të dalloj të vërtetën nga gënjeshtria, duhet të studioj gjithësinë dhe të zbuloj nëse ajo është e amshuar apo e krijuar: mundet që dikush mendon se ai nuk ka nevojë për këtë lloj dije, por, sidoqoftë ka nevojë të mendoj për ligjet që sundojnë botën tone, pjesërisht ose tërësisht. Kjo e bën atë të njoh të vërtetën për to dhe hap rrugën për të njohur Qenien, që drejton dhe kontrollon gjithësinë dhe atributet e Saj. Kjo është, në fakt e vërteta që Zoti ua ka urdhëruar robve të Tij të ditur ta kërkojnë dhe Allahu ka folur të vërtetën kur ka thënë

:“...dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të Tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijoje

Reportazh me Qendrën Islame Shqiptare të Çikagos

Skender Buzaku

Qendra Islame Shqiptare në Çikago të Illinosit paraqet një rëndësi të madhe nga qendrat mjaft me peshë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe më gjërë.

Madhështia e saj shtohet edhe më tepër kur dihet se në këtë shtet ekziston njëra nga qendrat Islame Shqiptare e cila vite të tëra është duke lulëzuar me aktivitete të përditshme.

Duke patur parasysh rëndësinë e madhe që ka kjo qendër nëse I kthehemi disa dekada më tepër veprimtarë të cilët jetojnë në këtë kontinent të largët me shumë aktivitete dhe punë të palodhshme kanë arritur që kësaj qendre t'i japin imazhin e vërtetë të cilin e meriton.

Me formën e saj të bukur, dhe me pejsazhin e saj joshës kjo qendër e rëndësishme islame Shqiptare e josh dhe ofron secilin vizitues dhe kalimtarë të rastit.

Eshtë pse jo shumë afër për të gjithë bashkëvendësit tonë të cilët jetojnë në SHBA duke patur parasysh hapësirën e gjërë të shtetit Illinois prapëseprapë largësia e saj nuk ishte pengesë që kjo qendër të vizitohet rregullisht nga bashkëvendësit tonë.

Jo vetëm kaq po nëse shikojmë ndërtimin dhe punët të cilat janë realizuar në këtë qendër morëm informata të sakta se shumica e tyre janë të kryera në mënyrë vullnetare.

Andaj ne si vizitues të BFI-së në R.M duke qëndruar në këtë qendër në shpirtin tonë thonim ky kompleks famoz i vendosur në këtë vend është shumë afër çikagos por ë anën tjetër është shumë më afër zemrave tona

HISTORIKU I SHKURTËR PËR QENDRËN:

Qendra është regjistruar si Shoqatë që nga viti 1996 kurse si xhami ka filluar të funksionojë prej vitit 1968.

Në vitin 1995 është blerë



lokacioni në të cilën gjendet tani xhamia, prej vitit 1995 ka filluar procedura për sigurimin e lejes për ndërtimin e qendrës në fjalë, kurse me punimet është filluar në vitin 2001 dhe ka zgjatur tetë vite.

Duke i falënderuar aktivitetet dhe punës së madhe të shumë aktivistëve dhe humanistëve kjo qendër Islame Shqiptare deri tani numëron 1100 familje (anëtarë) të regullt, me gjasa të sigurta që në të ardhmen ky numër të rritet.

Ky kompleks famoz në kuadër të tij posedon Xhaminë, shtëpinë e Imamit, zyrën e Imamit, zyrën e këshillit të xhamisë, klasat për zhvillimin e mësimbesimit fetar dhe orëve plotësuese të gjuhës dhe kulturës shqipe, bibliotekën, kuzhinën së bashku me sallën

për dasma dhe zhvillimin e ceremonive të ndryshme fetare dhe kombëtare, fushën e Sportit, parkingun e automjeteve, parkun, funeralin etj.

Donatorët kryesor për sigurimin e mjeteve materiale kanë qenë veprimtarë të komunitetit Shqiptar që veprojnë dhe jetojnë në SHBA, ndërsa kur bëhet fjalë për sigurimin e kuadrove profesionale për zhvillimin dhe kultivimin e jetës fetare në këtë qendër autoritetet e kësaj qendre kanë një mirënjohje të lartë ndaj institucioneve të Bashkësive Fetare Islame të të gjitha trojeve Shqiptare.

Deri tani janë harxhaur më tepër se 1 milionë dollarë, kurse deri në përfundimin total të punimeve harxhimet për këtë qendër do të arrijnë deri 2 milionë dollarë.

ANËTARËT E KËSHILLIT TË XHAMISË

Vllaznim Sherifi-kryetar, Azem Begzati-nënkryetar, Pëllumb Shemsedini-arkëtar, Bardhyl Shatku-Sekretar-anëtar, Faik Ajroja-anëtar, Sadullah Bekteshi-anëtar, Safet Rojba-anëtar, Fanol Cami-anëtar, Pajazit Murtishi-anëtar, Samedin Mehmeti-anëtar, Lutfi Abdullahi-anëtar, Ali Memishi-anëtar, Selman Elmazi-anëtar, Abdyl Kraja-anëtar, Zija Milla-anëtar, dhe Fadil Topçiu-anëtar.

Këshilli i lartpërmendur mban mbledhje një herë në muaj, mandate i tij është dy vjeçar kurse për rregullimin dhe organizimin sa më të mirë të punëve dhe objektivave është hartuar statut dhe rregullore e



veçantë në të cilën parashihen obligimet dhe të drejtat e secilit anëtar apo nëpunës.

IMAMI I XHAMISË

Lulzim ef. Musaj, i lindur me 13-04-1979 në Kërçovë.

Shkollimin fillor e kreu në Zajaz të Kërçovës, kurse mësimet i vazhdoi në shkollën e mesme Islame "Medresenë Isa Beu"-Shkup në vitin shkollor 1996/1997.

Mësimet në Medresenë Is beu-Shkup i mbaroi në vitin shkollor 1999/2000 me sukses të shkëlqyeshëm, kurse studimet i vazhdoi në Universitetin e Az'harit në Kajro dega e Akaidit-besimit në vitin viti akademik 2000/2001.

Lulzim ef. Musaj studimet i kreu me sukses të shkëlqyeshëm në vitin 2006.

Pas studimeve ka shërbyer në disa fshatra të rrethinës së Kërçovës, kurse prej qershorit të 2009 gjendet në Çikago dhe shërben si Imam në këtë qendër.

AKTIVITETE E KËSAJ QENDRE

Falja e namazeve kryerja e ceremonive fetare, mësimi i fëmijëve, organizimi e piknikeve si dhe takimi me rininë dhe besimtarët.

Organizimin dhe pritjen e dy darkave të Bajrameve;

Memorial Day-Dita e Dëshmorëve të Amerikës e cila shënohet të hënën e fundit të muajit Maj;

Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës më 4 korrik

Xhemati dhe anëtarët zakonisht janë nga Maqedonia, Mali i Zi, Çamëria, Shqipëria, Republika e Kosovës, dhe çka është puna më e mirë se në këtë qendër në mënyrë të përpiktë ruhet harmonia dhe respekti nga të gjithë.

NDARJA NGA KJO QENDËR

Për këtë shkak edhe imami i kësaj qendre shprehet shumë i kënaqur se gjendet në këtë qendër dhe njëkohësisht me punën dhe kontributin e tij të përditshëm shpreson se do të ketë sukses në ruajtjen hde kultivimin e islamit.

Poashtu Imami dhe këshilli i xhamisë shprehen të gatshëm që të bashkëpunojnë dhe koepojnë me Bashkësisnë Fetare Islame në R.M.

Koha derisa qëndruam në këtë qendër ishte gëzim, harmoni e lumturi kurse momnemnti i ndarjes nga qendra dhe bashkëvendasit të trojeve tona ishte lot dhe madh, por shpresë që së shpejti prap ti vizitojmë si Institucion më i lartë fetar.

"ENCIKLOPEDIA MAQEDONASE" OFENDON EDHE MYSLIMANËT

Përseshh puna me enciklopedinë

Driton Dikena

Përseshh doli puna me "librin e librave", "Enciklopedinë Maqedonase" që para disa ditësh pa dritën e botimit. Kjo, gjoja akademia, me shqiptarët e përdhosi punën si në aspektin kombëtarë ashtu edhe në atë fetarë, por futi veten në shamatë edhe me amerikanët dhe britanikët, ndërsa pritet që të reagojnë ashpër edhe bullgarët, grekët. Nga A deri në ZH enciklopedia u shndërrua në "shpatë të Demokleut" që i qëndron mbi kokë ekzistencës së shtetit shumetnik maqedonas, ndërsa më këtë edhe një herë dëshmuar se "kokat më të mençura" të këtij shteti janë pesë më dymbëdhjetë dhe se kanë kuptuar se vetëm vullneti i mirë i deritanishëm i shqiptarëve për të qëndruar në këtë shtet është peri që e mban për të mos rënë. Dhe ky pe u prek aty ku dhemb më shumë. Kombëtarisht u përçmuan u quajtën "arbanasë", "arnautë" dhe "shiptari", kjo e fundit shoqërohet me shpjegimin përkatës në kllapa "pllaninci" (njerëz mali), ndërsa gegët si fis. Shqiptarët janë edhe zaptues, ndërsa rrugën drejt "pushtimit" të Maqedonisë, mësohet se ua ka "shtruar" Ali Pashë Tepelena, ky i fundit, në disa njësi më poshtë përshkruhet, si një satrap, zulumqar e të tjera.

Por, ky aspekt kombëtarë u trajtua në mediat e vendit. U sensibilizua opinioni dhe kjo është për t'u uruar. Ajo që u prek shumë pak, për të mos thënë aspak është përçmimi fetar që ju bë shqiptarëve. Vetëm gazeta "Koha" alarmoi edhe për përçmimin fetarë që ju bëhet shqiptarëve, mediat e tjera qoftë të shkruara apo eletronike aspak nuk e përmendën këtë atak shqiptarë, thuajse nuk kanë lexues dhe shikues shqiptarë. Ky është ataku i dytë, atak shpirtëror, por ky atak nuk prek vetëm shqiptarët, por edhe turqit, romët, torbeshët dhe ata që për interesa politike e quajnë vetën maqedonas mysliman. Madje, këta (turqit, romët, torbeshët ...) as edhe si shifër nuk figurojnë në "përseshh enciklopedinë", për sa i përket besim-

it fetar.

Sipas gjoja akademikëve të bazuar në statistikë, në Maqedoni paska mbi 674 mijë myslimanë, ndërsa po ajo statistikë tregon se aq ka shqiptarë dhe së bashku me turqit, romët, boshnjakët janë mbi 890 mijë myslimanë. Këtyre të përseshh enciklopedisë, aspak nuk është kujtuar se mysliman në Maqedoni, përveç shqiptarëve janë edhe turqit, romët... madje një numër i mirë edhe i atyre që veten e quajnë maqedonas. Aspak nuk është pyetur BFI-ja për shifrën e myslimanëve që ka në statistikën e veta dhe që e kalon njëmilionëshin.

Të qeshësh dhe të qash. Te qeshësh për budallallëkun që s'ka fund në gjoja akademinë maqedonase, ndërsa të qash për popullin maqedonas, i cili ka kësaj akademikësh që kanë mbet me zhvillimin intelektual të mesjetës, kur të gjithë popujt e botës, përfshirë këtu edhe shqiptarët, i dhanë fund nacional-shovinizmit.

Por, nuk është vetëm ky diskriminim në shifra që ju bëhet myslimanëve. Figurat dhe udhëheqësit shpirtërorë të myslimanëve, përfshirë këtu edhe kryetarin e BFI-së, Reis Ul Ulema Sulejman ef. Rexhepi, janë të trajtuar me nga dy rreshta, kurse tjetër arshin përdorët për klerikët ortodoks. Për këto është shkruar me faqe të tëra, thuajse enciklopedia u është dedikuar atyre.

Edhe objektet e kultit islam, xhamitë dhe teqetë janë trajtuar si objekte pa vlerë. Plot të pavërteta edhe në ato pak rreshta. Për Xhaminë Burmalë, e cila ka qenë perla e Ballkanit, që kohën e fundit zgjoi disa herë debat, thuhet se është ndërtuar mbi një kishë. As emër i kishës, as kush e shkatërroi atë kishë të paqenë, as fakt, as dëshmi. Të bën të mendosh se gjoja akademikët kanë shkruar për çmimin e specave në Bit Pazar, e jo për një objekt kulti që shpesh di t'i trajtoj shpirtat.


Por, nuk është vetëm Burmalë Xhamia ajo që është "përdhunuar" nga vetë "të mençurit e dynjasë". Nga mbi 600 xhamitë funksionale në vend, vetëm një dorë xhamish zënë vend në "përseshh enciklope-



Për objektet e kultit islam, xhamitë, teqetë, hamamet, hanet shumë pak është shkruar në “Enciklopedinë Maqedonase” dhe për ato që është shkruar ka gënjeshtër me thes, ndërsa janë anashkaluar edhe lid-erët fetarë të fesë njëmilionëshe në vend, ndërsa me të madhe është gënjer edhe për numrin e muslimanëve. Thuajse këto të akademisë kanë shkruar për çmimin e specave në Bit Pazar, e jo për një çështje që di të trazoj shpirtat dhe të vë në rrezik “këmbët e kristalta” të një shteti të brishtë si Maqedonia

dinë” dhe ato të gjitha me gabime në të dhëna.

Edhe Shkupi është paraqitur sikur ka një dorë mysliman. Asnjë fjalë për 39 xhamitë dhe 4 tyrbet e shkatërruara. Vetëm për Xhaminë e Ibni Pajkos jepen dy rreshta, por jo edhe për objektet e kultit islam që sot nuk ekzistojnë, si p.sh. Pasha Jegit Xhaminë, Muradie Xhaminë, Xhaminë e Jelen Kapanit, Vardar Teqesë, Haxhi Gazit, Haraxhi Sakahudinit, Haxhi Ine Begovit, Haxhi Gazës, Ajshe Hatunit, Ibni Muhtesibit, Tusxhu Sulejmanit, Emir Hoxhinës, Bahri Hoxhinës, Kazanxhilit, Qatip Shahinit, Ibni Koxhaxhikut, Vardar Teqesë, Haxhi Ajshe Hatunit, Axhem Zadesë Xhamisë..... dhe të tjera, e të mos flasim për 50 xhamitë e shkatërruara në Maqedoninë Lindore, 2 xhamitë e shkatërruara në Tetovë, Gostivar, Dibër, Ohër (një ndër xhamitë më të



bukura rreth liqenit). Edhe për 18 xhamitë e vjetra shekullore që i kanë bërë ballë egërsisë sllave dhe që sot janë funksionale dhe që janë shpallur si objekte me karakter të veçantë historiko-kulturor, nuk është shkruar asnjë fjalë. Për kishat po, ka, qoftë edhe për një kishë të vogël që është në Gorno Dupeni dhe që është funksionale vetëm gjatë ditës së Shën Mërisë.

Asnjë fjalë edhe për xhamitë e shkatërruara në Prilep dhe Manastir nga vetë studentët e këtyre gjoja akademikëve dhe për shovinizmit e tyre nuk lejohen që këto të rindërtohen.

Asnjë fjalë në përshtesë enciklopedinë edhe për 57 xhamitë e rrënuara gjatë konfliktit të vitit 2001, pjesa dërmuese e të cilave u rindërtuan me vullnetin e myslimanëve, ndërsa gati 20 prej tyre vazhdojnë të mbesin jashtë përdorimit.

Përveç xhamive, në po të njëjtin “pamflet politik” siç e quajtnë disa të ashtuquajturën “Enciklopedinë Maqedonase”, teqetë figurojnë shumë pak. Dy rreshta për Arabati Baba Teqenë, por asnjë fjalë për teqetë historike me karakter islam, si ajo e Shej Medah Babaës, Emir Hoxhës, Huma Shej Sulltanit, Gjureshçilerit, Anabaxhit, Kara Mustafës, Shej Adem Babës, Qupeli Babës, të gjitha këto sot të shkatërrua që nga Luftërat Ballkanike dhe periudhës komuniste, por asgjë edhe për Teqetë e Shkupit që sot janë funksionale, si ajo e Vefa Babës dhe Teqes Rifai.

Të dhëna të vobekta ka edhe për hanet si ai Suli Hanit, Kurshumli Hanit, Kapan Hanit ndërsa asnjë fjalë për Hanet e Isak Begut, Daut Pashës, Karavan Sarajet e Karli Zades, Mustafa Pashës, Jahja Pashës, Rustem Pashës dhe të tjera.

Edhe për Hamamet, vetëm ai i Daut Pashës zë vend në përshtesë enciklopedinë, ndërsa jo edhe Hamami i Ajshe Hatunit, Jahja Pashës, Hamami i Urietit, Isak Begut, Banja e Vardarit, Hamamit të postës dhe të tjerë.

Akademikët e një populli pa komb, pa fe, pa shtet dhe territor aspak nuk e kanë marrë parasysh “selamin “ e Deni Diderosë- njërit nga baballarët e enciklopedisë franceze, ku si kriter shprehte se “të gjitha faktet duhet të ekzaminuar, debatuar e studiuar pa asnjë përjashtim dhe pa marrë parasysh ndjenjat e asnjërit”.

“Këto ndjenja të tjerëve” me të cilat Didero nënkuptonte qëndrimin debatues rreth problemeve të ndryshme filozofike dhe historike të kohës, në enciklopeditë e popujve ballkanikë u reflektuan si qëndrime dhe shtrembërime të fakteve historike të popujve dhe kombeve. Problemi më i madh filozofik i përpiluesve të përshtesë enciklopedisë nuk ishin dilemat filozofike të ekzistencës, por justifikimi i përvetësimit të ekzistencës së tjetrit.

Një shembull klasik sllav, ku të kompleksuar nga autoktonia e shqiptarëve dhe të ardhjes së sllavëve në shekujt VI-VII në Ballkan, gjoja

akademikët maqedonas u munduan që të jepnin një variant tjetër më të përshtatshëm për kombin e tyre ardhacak. Kështu, faktin historik të ardhacakut u munduan t’ua vishnin shqiptarëve duke i shpallur si të ardhur në Ballkan.

Por çdo përpjekje për t’i trajtuar shqiptarët si minoritet ardhacak në Maqedoni, dhe jo si popullsi shtetformuese, i minon vetë themelet e shtetit maqedon dhe tërë stabilitetin në rajon.

Njeriu i parë i pseudoakademikëve, Georgi Stardelov i dha shenjat e para të zbrapsjes ose të zbutjes së qëndrimit, duke paralajmëruar se do të bëhen korrigjime në disa pjesë të kontestuara. Por, për fat të keq, pasojat që u shkaktuan nga kjo prurje pseudoshkencore, kanë mbetur në skenë. Dhe, si të tilla, nuk do të mund të mënjanohen një kohë shumë të gjatë. Kjo do të thotë se, qarkullimi i kopjeve të këtij libri te lexuesit maqedonas, do të mbjellë edhe më tej helm kundër shqiptarëve. Edhe përkundër premtimit se do të ndryshohen disa pjesë të saj, pa u përcaktuar se cilat, është një tentim për të mbuluar diellin me shoshë. Populli thotë: I shkull gozhdët, por mbeten vrimat. Dhe këto vrima të cilat dhe një kohë të gjatë do të trullosin rininë në këtë shtet tepër të brishtë të çojnë me zor të thuash këtyre të “mençurve të dynjasë” ua përshtetshëm enciklopedinë.

EKSKLUZIVE: INTERVISTË ME KRYETARIN E BFIM-SË, REIS UL ULEMA H. SULEJMAN EF. REXHEPI DHËNË PËR GAZETËN 24 ORË

Me mercenarë s`mund të përmbysset Islami tradicional

Intervistoi: Naser PAJAZITI


Por fatkeqësisht, dikush mundohet ta dëmton Islamit duke përdorur metoda dhe stil perfid, ndërsa këta që shihni në sipërfaqe në ambientet tona, me sjelljet e tyre janë shumë naivë dhe primitivë. Me vjen shumë keq që nuk kanë ndërgjegje dhe vetëdije ta kuptojnë se tentojnë ta dëmtojnë Islamit duke bërë grindje, copëtim, duke mbjellë mosmarrëveshje dhe urrejtje në radhët e popullit tonë, vepra këto të cilat Kurani Famëlartë i sanksionon dhe tradita profetike i mallkon. Kjo është një nga vlerësimet e kryetarit të BFIM-së, Reis Ul Ulema H.Sulejman Ef.Rexhepi, lidhur me ate se si i vlerëson rrymat destruktive që po tentojnë të rrënojnë islamit tradicional. Por kreu i BFIM-së në intervistë fletë për rrymat e përhapura islamike radikale, nismën për Burmalit Xhaminë, kthimin e vakëfëve, organizimin e Haxhit, etj

24 Orë: Jemi në prag të festës së Fitër Bajramit. Cili është mesazhi juaj në cilësinë e kreut të BFIM-

së në Maqedoni me rastin e kësaj feste madhështore islame ?

H. Sulejman ef. Rexhepi: Për të gjithë ne, Bajrami të cilin po e përjetojmë me mëshirën dhe dëshirën e Zotit, është edhe një rast që t'i falënderohemi Allahut të Plotfuqishëm, që po mundemi të jetojmë nën rrezet e besimit tonë, t'i gëzojemi njëri tjetrit dhe ta ndajmë dashurinë mes vete, të shprehim humanizmin tonë dhe dhembjen ndaj atyre që për shkaqe të ndryshme nuk mund t'i gëzohen tërësisht çasteve të lumturisë të përgjithshëm.

Por, duke u mbështetur përherë në urdhrat e Allahut dhe në parimet esenciale të fesë Islame, ne edhe sot si gjithmonë do të jemi afër të varfërve, afër të ngratëve, afër të sëmurëve, afër të gjithëve që kanë nevojë për ndihmën dhe zemërgjerësinë tonë të ndërtuar në bazë të mësimëve hyjnore... Sepse, të mos harrojmë asnjëherë, Islami është fe e cila i inspiron besimtarët që të bëjnë jetë që mbështetet në drejtësinë Hyjnore, duke mos e injoruar asnjëherë përgjegjësinë personale. Duke



ju dëshiruar gëzime dhe lumturi në këto ditë Bajrami, i ftoj të gjithë besimtarët myslimanë, si edhe të gjithë njerëzit tjerë me vullnet të mirë që të kultivojnë vlerat njerëzore e civilizuese, dashurinë ndaj familjes dhe miqve e fqinjëve, të respektojnë konceptin universal për lirinë e të nderojnë ndryshimet me të cilat na ka karakterizuar Allahu.

24 Orë: Cilat kanë qenë aktivitetet kryesore nga ardhja e juaj në këtë institucion, i cili ka qenë i përfshirë nga goditjet dhe tensionet e ndryshme. Si është gjendja tani në BFIM ?

Ef. Rexhepi: Prioritetet e mia me kthimin si Kryetar në BFI në mandatin e tretë ishin:

Rikthimi i rendit dhe qetësisë në suazat e institucionit. Rikthimi dhe riaktivizimi i sistemit normativ në sistemin e BFI-së në të gjitha segmentet e saja. Konsolidimin e strukturave udhëheqëse në të gjitha organet dhe entet e Bashkësisë Islame. Harmonizimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore. Konsolidimin financiar të BFI-së dhe krejt në fund funksionimin e sistemit juridik dhe sistematizimin e të gjitha vendeve të punës në aspektin profesional dhe kërkimin e përgjegjësive.

Për sa i përket goditjeve që i kishte përjetuar Institucioni BFI në të kaluarën, vërtetë ato ishin destruktive dhe tragjike. Tërë destruktiviteti dhe tragjedia vinin nga një shtresë

njerëzish të pandërgjegjshëm, të udhëhequr nga interesa personale të cilët në asnjë moment nuk dinin çka është Institucioni. Këto elemente me siguri ishin të stimuluar nga qarqe të ndryshme antiislame. Është interesant të theksojmë se tërë atë rrënim të kobshëm që bënin, e bënin në Emrin e Interesit të Islamit, që për mua personalisht kjo metodë shkatërruese kundër Islamit është e njohur dhe ajo koordinohet mirë nga qendra të ndryshme antiislame dhe atë si në planin e brendshëm gjithashtu edhe në planin e jashtëm. Këto elemente fuqimisht kanë qenë të stimuluar dhe të paguara në cilësi të mercenarëve. Kështu që me ato sjellje rrënuese duke përdorur dhunën, ata institucionin e shndërruan në një labirinth pa dalje. Nga ana tjetër, në aspektin financiar e grabitën me forma të ndryshme deri në themel. Më kujtohet që atëkohë, në arkën e BFI-së gjeta jo më tepër se 400 denarë. Aktualisht gjendja në BFI është jashtëzakonisht e përmirësuar. Shumë pak njerëz kanë besuar në këtë përmirësim dhe shumë pak e kanë paramenduar se për një kohë kaq të shkurtër mund të krijohet një pozicion mjaft i lakmueshëm dhe atë brenda kësaj kohe të shkurtër arritëm të realizojmë të gjitha prioritetet që i kisha në agjendën time. Gjithashtu BFI tani ka një akt më të lartë normativ siç është Kushtetuta e BFI-së e cila është një sintezë e shëndoshë që i garanton perspektivë këtij Institucioni, duke i mbyllur boshllëqet e ndryshme nga të cilat nxitej dhe ushqehet destabilizimi i saj. Pa kaluar një vit, BFI arriti të harmonizon të gjitha rregulloret dhe statutet e organeve dhe institucioneve të saja me këtë Kushtetutë.

Edhe sukseset nuk vonuan shumë. Ato menjëherë dolën në sipërfaqe. Zhdukja e dhunës, hapja e paraleleve të nxënësve në Tetovë, Gostivar dhe Shkup, rritja e numrit të nxënësve në këto paralele dhe Medrese, hapja e dhjetëra xhamive dhe trefishimi i pronës dhe pasurisë së Vakëfit, akreditimi i Fakultetit të Shkencave Islame, implikimi i mësim besimit në sistemin arsimor, e shumë suksese të tjera për të cilat opin-

ioni publik ka qenë i njoftuar edhe më herët.

24 Orë: Temë e fundit e debatit që ndërlihet edhe me BFI-në është ndërtimi i një xhamie në sheshin e Shkupit, krahas një nisme tjetër paralele për ndërtimin e një kishe. Po, çfarë bëhet me Burmal Xhaminë. A jeni të informuar për këtë ?

Ef. Rexhepi: Kërkesa për kthimin e Burmal Xhamisë nuk filloi me paraqitjen e disa shoqatave joqeveritare, por në fakt me paraqitjen e tyre, filloi radikalizimi i palës tjetër, për të mos u kthyer Burmal Xhamija. Që nga viti 1997, Bashkësia Fetare Islame vazhdimisht po bën kërkesë zyrtare drejtuar strukturave Qeveritare – pra Qeverive për ta rikthyer Burmal Xhaminë në anën e djathtë të Vardarit. Me këtë rast dua të përmend se atëkohë, në atë anë të rrjedhës së lumit Vardar, kanë ekzistuar katër xhami, prej të cilave sot nuk ekziston asnjë. Kërkesat tona për rikthimin e Burmal Xhamisë kanë qenë permanente dhe në mënyrë institucionale. Muftinia e Shkupit në bashkëpunim me Rijasetin e BFI-së, ka krijuar Këshill Iniciues dhe ka bërë kërkesë në Komunën Qendër për ndryshimin e planit urbanistik. Gjatë gjitha kohës para se të fillonte çështja e kishës, kemi pasur kontakte dhe fjalë miradije.

Sa u përket shoqatave është për të habitur fakti se ato njëherit në opinion paraqiten si 80, e më pas kinse ato kanë ndonjë Këshill Koordinativ në emrin e të cilit flet z. Ramadan Ramadani. Neve si Bashkësi Islame, mbështetja e të gjithë myslimanëve mbi përcaktimet tona në interes të Islamit nuk na pengon, mirëpo këta siç duket me sjelljet e tyre të tepruara dhe të pakontrolluara si dhe me gjeste joserioze na duket se janë në shërbim që Xhamia Burmal mos të lejohet asnjëherë. Edhe pse akoma nuk ka përgjigje zyrtare, por sikur duket Qeveria ka hequr dorë nga ndërtimi i kishës e ajo me të madhe do të ndikojë te Komuna Qendër që ajo të ketë qëndrim negativ të kërkesave tona. Më në fund dalin në sipërfaqe Shoqata Joqeveritare Maqedonase me pretekst se aty duhet të plani-

fikohet rikthimi i një kishe që në përrallat popullore maqedonase paska pasur emrin Shën Nikolla, ndërsa Xhamia Burmal paska qenë e ndërtuar mbi themelet e saja. Ndërsa nga ana tjetër, shkenca dëshmon dhe vërteton krejtësisht të kundërtën. Në vendin e Burmal Xhamisë asnjëherë nuk ka pasur kishë, madje Burmal Xhami ka qenë ndërtuar 430 vite para kishës së Shën Konstantinit dhe Helenës. Këtë të vërtetë e pohon dhe e konfirmon edhe vetë Prof. Dr. Kosta Ballabanov i cili ka qenë drejtor i Entit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike.

Por, edhe pse mesa duket ekzistojnë edhe disa indikacione të cilat flasin se edhe Bashkimi Evropian po i bën presion Qeverisë që të heqë dorë nga ndërtimi i objekteve fetare, ne si Bashkësi fetare islame jemi gjallë të interesuar që ta rikthejmë Bukuroshen e Ballkanit në qytetin e Shkupit, i cili përfundimisht duhet të merr pamjen e një qyteti multikonfesional.

Maqedonia si një shtet multietnik, multikonfesional, nuk guxon të ketë arshinë të ndryshme për sjelljet e saja. Maqedonia duhet të ketë një arshinë të vetëm. Nëse për momentin nuk do të tregon gatishmëri për dhënien e lejes për ndërtim, atëherë minimumi që duhet të bëjë është rikthimi i lokacionit në pronën e Bashkësisë Islame. Ne nuk kërkojmë privilegj, por kërkojmë trajtim të barabartë me Kishën Ortodokse Maqedonase në këtë drejtim. Ne si Bashkësi Islame vazhdimisht kemi qenë dhe jemi të interesuar edhe për ndërtimin e Tupan Xhamisë në Tetovë.

24 Orë: Çështja e vakëfeve mbetet një problem i pazgjidhur në Maqedoni. Sa po punohet në këtë drejtim ?

Ef. Rexhepi: Çështja e denacionalizimit dhe kthimi i pronës së Vakufit, gjithmonë ka qenë brengë dhe preokupim i përditshëm për Rijasetin e Bashkësisë Islame. Në këtë drejtim vazhdimisht u bëhet presion organeve dhe për këtë arsye BFI ka sektor të posaçëm që merret ekskluzivisht me këtë punë, ku janë angazhuar ekspertë të

specializuar të kësaj lëmie. Ka të dhëna të një lëvizje pozitive dhe kohën e fundit kemi regjistruar rezultate të kënaqshme dhe shpresojmë se brenda një kohe të shkurtër do të arrijmë qëllimet dhe synimet tona.

Nëse ndodh që edhe pas kalimit në të gjitha instancat nuk realizohen kërkesat tona imediatë të BFI-së, jemi të përcaktuar dhe përkushtuar që kërkesat tona për padrejtësitë ti kërkojmë në jurispodencën evropiane dhe drejtësinë ta kërkojmë në Qendrën e Drejtësisë në Strasburg. Do të përmend se kusht për të dërguar lëndët në Strasburg, është kalimi i lëndëve në të gjitha shkallët juridike në vend dhe më pas nëse palët mbeten të pakënaqura, për to do të vendosën Drejtësia Evropiane. Aktualisht kemi një lëndë e cila i ka kaluar të gjitha shkallët juridike në vend, dhe tani ka filluar procesin në Gjykatën e Strasburgut. Është fjala për Jeni Xhaminë në Manastir, për të cilën shpresojmë në drejtësinë Evropiane.

24 Orë: Si i vlerësoni elementet fetare që kanë marrë hovë në disa ambiente fetare dhe predikojnë ndryshe nga parimet e islamit. Këtu kemi fjalën për grupe që deklarohen si vebahistë apo selefistë ?

Ef. Rexhepi: Lëvizjet e ndryshme në emër të Islamit dhe predikimet e tyre provokuese në të drejtë aspak nuk i kontribuojnë interesit Islam. Pavarësisht çfarë emri mbajnë, -Ista apo -Izma të ndryshëm, këto që bëjnë trazira në ambientet tona, goftë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni apo gjetiu, betohem në Allahun e Plotfuqishëm se motivet e tyre nuk janë në interes të Islamit, por ato bëjnë përpjekje të realizojnë interesat e tyre individuale apo grupe, ndërsa patronët e tyre kërkojnë rezultate në këtë drejtim, përndryshe u ndërpriten pagesat. Këta nuk janë të vetëdijshëm se gjeneratat para tyre kanë studiuar në të njëjtat qendra, por kur janë kthyer, nuk kanë ardhur si ushtarë të dikujt, por janë kthyer si bijtë e këtij vendi dhe populli, në shërbim të këtij vendi dhe këtij populli.

Por fatkeqësisht, dikush mundohet ta dëmton Islamin

Strategjia e huaj për deformimin e traditës islame

duke përdorur metoda dhe stil perfid, ndërsa këta që shihni në sipërfaqe në ambientet tona, me sjelljet e tyre janë shumë naivë dhe primitivë. Me vjen shumë keq që nuk kanë ndërgjegje dhe vetëdije ta kuptojnë se tentojnë ta dëmtojnë Islamin duke bërë grindje, copëtim, duke mbjellë mosmarrëveshje dhe urrejtje në radhët e popullit tonë, vepra këto të cilat Kurani Famëlartë i sanksionon dhe tradita profetike i mallkon. Këtë e them me një bindje të plotë, se libër më të fuqishëm dhe më perspektiv se Kurani Famëlartë, muslimanët nuk duhet të kërkojnë.

Të kërkojë libër më efikas se Kurani, sikurse pretendimet e një lideri në botën arabe me librin e gjelbër, ajo është lajthitje.

Person më i përkryer me mësimet e tija është Muhamedi a.s., si dhe çdo tentim për të nxjerr në sipërfaqe emra të tjerë është lajthitje.

24 Orë: Cilat janë aktivitetet që po bën BFIM për Haxhin?

Ef. Rexhepi: Bashkësia Fetare Islame e RM-së organizimin e vet rreth Haxhit, pothuajse në një segment e ka përfunduar, e ajo është udhëtimi i haxhilerëve për tokë përmes bashkëpunësorëve teknik, siç janë agjencitë e ndryshme. Tani në mënyrë ekskluzive i është përkushtuar udhëtimit të haxhilerëve nëpërmjet rrugës ajrore. Kemi bindje se këtë vit Bashkësia Fetare Islame nën ombrellën e vet do të ketë 2000 haxhilerë. Është rezultat historik që Bashkësia Fetare Islame në mënyrë ekskluzive është i vetmi organizator dhe ombrella e saj i mbulon të gjithë haxhilerët.

Shpresojmë se të gjithë ata që e kanë borxh haxhillëkun do t'u mundësohet të udhëtojnë në vendet e shenjta pa kurrfarë problemi dhe gjatë qëndrimit të tyre në Arabinë Saudite, Bashkësia Fetare Islame do ti ketë nën përkujdesje të vetë edhe organizatorët teknikë me një qëllim të vetëm që haxhilerët të kryejnë Haxhin, gjegjësisht zbatojnë kushtin e pestë islam, në frymën e normave Islame.

Shaqir Fetahu

Falënderuar All-llahun xh.sh Islami gjeneratë pas gjenerate arriti deri tek ne, në kohën dhe vendin tonë. Kjo gjithë më tepër na obligon ta ruajmë, ta kultivojmë dhe ta zhvillojmë, ashtu siç vepruan gjenerata e mëparshme. Andaj, mbi ne bie përgjegjësia për këtë ndaj All-llahut xh.sh ndaj, gjeneratave që kaluan para nesh, si dhe përgjegjësia ndaj atyre që do të vijnë. Kjo përgjegjësi është edhe më e madhe, kur tashmë është zbuluar e vërteta se në planin global në qendra të ndryshme botërore, ekzistojnë konkluzat unanimesisht të pranuar rreth Islamit dhe myslimanëve, gjegjësisht rreth ardhmërisë së tyre në botë e në veçanti këtu në Europë dhe Ballkan si:

-Islami dhe muslimanët në Evropë dhe Ballkan janë të huaj dhe si i tillë janë rrezik për Evropën dhe kulturën e saj në përgjithësi;

- Shpëtimi i vetëm i Evropës është asimilimi i tyre apo shkatërrimi i tyre fizik.

Për t'u realizuar kjo, sot realizohet platforma mirë e planifikuar me një strategji perfide dhe afatgjate që në veti përmban dy parime kryesore, e qe janë:

Mbajtja e myslimanëve në një gjendje të infeoritetit në

çdo sferë të jetës duke filluar prej asaj politike, ekonomike, shkencore, fetare etj. me qëllim të dirigjimit sa më të lehtë të tyre. Thjeshtë thënë, sipas këtij parimi muslimanët nuk guxojnë të dinë, të shkollohen, të profesionalizohen, të ngritin vetëdijen mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Qysh para njëzet e sa vjetësh njëri ndër udhëheqësit e ministrisë së punëve jashtme të Francës jep deklaratë të cilën edhe sot e kësaj dite e ndjek Evropa dhe bota:

“Le t’u jepet myslimanëve e gjithë ajo që dëshirojnë, përveç dijes.

Nëse nuk arrijnë që myslimanët, këta viganë të rijnë lidhur me zinxhirë të paditurisë dhe të kompleksimit, ta dini se atëherë do të pësojmë dështimin fatal...dhe kështu rreziku do ti kanoset Perëndimit dhe do t’ia marr rolin e saj udhëheqës në botë”

Dezintegrimi i tyre në çdo vend ku jetojnë me qëllim të mosposedimit të forcës dhe ndikimit në rrjedhat e kohës. Sipas kësaj muslimanët nuk guxojnë të jenë të bashkuar

në qëllime të njëjta, parime e strategji e cila do t’ua siguronte të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Misionari i njohur Evropian me emrin Lorens Baruni në një rast në mes tjerash thotë:

“Nëse muslimanët ngelin të përçarë, atëherë do të mbetet faktorë pa ndonjë rëndësi të veçantë...Prandaj muslimanët duhet përçarë që të mosparaqesin asnjëfarë force dhe të jenë pa kurrfarë ndikimi”.

Fatkeqësisht, kjo platformë perfide sot po realizohet apo tenton të realizohet në tërë botën, e ajo që është për t'u brengosur tentohet të ndodhë edhe në trevat e Ballkanit, gjegjësisht në trevat tona. Duke shfrytëzuar boshllëkun shpirtëror që la pas veti sistem monist dhe, duke parë vullnetin e jashtëzakonshëm të myslimanëve të këtyre trevave për përtëritjen e besimit të tyre si dhe traditës së tyre shumëshekullore, me të madhe tentojnë të depërtojnë fraksione të ndryshme, ideologji, mënyra të llojllojshme të praktikimit të fesë, me qëllim të deformimit të traditës së tyre shumëshekullore të këtyre trevave, të cilat në veprimtarinë e tyre nuk zgjedhin mjete, duke filluar prej atyre materiale e deri te ato fetaro-politike me qëllim të shkatërrimit të parimeve kryesore të besimit Islam, imunitetit fetar të popullatës myslimane, këtu edhe më gjerë dhe për të arritur këtë bëjnë përpjekje për institucionalizimin e tyre për të vepruar në mënyrë legjitime.

Të gjitha tendencat, sektet apo fraksionet e këtilla mund ti ndajmë në tri grupe kryesore:

1. SEKTET ANTIISLAME

Në grupin e parë bëjnë pjesë sektet antiislame që veprojnë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të qendrave apo shteteve të ndryshme joislame, veprimtaria e të cilëve është plotësisht në shërbim të tyre, pasi që përkrahen nga ato materialisht dhe ideologjikisht. Në këtë grup të sekteve antiislame bëjnë pjesë: Ahmeditë me qendër në Londër të Anglisë, sektin e babive të përkrahur nga Rusia dhe sektin behajjë me seli në Telaviv të Izraelit.

Sekti më i rrezikshëm i cili pandërprerë bënë përpjekje të përhapet në botë e në veçanti në trevat tona është sektin Ahmedian i

cili formohet në nënkontinentin Indian në vitin 1889 nga Mirza Gulam Ahmedi i cili u lind në vitin 1835 në fshatin Kadijan të krahinës Penxhabi ne Indi.

Ideja për formimin e këtij sekti lindi në Londër nga ideologët e kolonializmit anglez të atëhershëm. Idealistët, strategët dhe ideologët e kolonializmit anglez gjatë përpilimit të planeve dhe strategjive për pushtimin e vendeve myslimane në botë si dhe për mbajtjen e tyre nën pushtimin e vendeve kolonialiste ishin të vetëdijshëm se myslimanët megjithatë kanë një fuqi lëvizëse e cila është force lëvizëse e myslimanëve kundër çfarëdo force okupuese, e ajo forcë është Islami .Atëherë është e domosdoshme që kjo forcë të shkatërrohet me të gjitha mjetet. Kjo mund të arrihet vetëm me një metodologji jashtëzakonisht perfide dhe me strategji mirë të planifikuar. Andaj, vendosën që në nënkontinentin Indian të formohet sekti, i cili do të deklarohet si islame, por në të vërtetë do të veprojnë në deformimin e parimeve akaidologjike dhe juridiko morale të Islamit, duke ia parashtruar mësimet të kolonializmit anglezo-krishter. Sekti i këtillë duhet të formohet përbrenda myslimanëve dhe bartës i tij duhet të jenë vetë myslimanët. Andaj për nënkontinentin Indian zgjedhën Mirza Gulam Ahmedin, familja e të cilit njihej mirë në krahinën e Penxhabit si pro-angleze dhe tradhtarë e intereseve të myslimanëve. Pra, Mirza Gulam Ahmedi u josh nga premtimet e anglezëve se do të bëhej i dërguar i Allahut dhe shërbëtor i denjë i anglezëve. Vërtetësinë e gjithë kësaj që u tha më lartë, e vërtetojnë vet fjalët e Mirza Gulam Ahmedit, i cili gjatë përhapjes së mësimet të tij shpikuraka thënë:

“E kam parë melekun (Xhibrilin) në formën e anglezit të ri, i cili në vitet e 20 të jetës së tij u ul në karrige, e unë i thashë :Ti me të vërtetë je personifikimi i bukurisë “Ai tha:”Po”.

“Nuk i lejohet muslimanit të ngritë armët

kundër anglezëve, për shkakë se xihadi është ngritë. Anglezët janë mëkëmbësit e Allahut në tokë dhe nuk lejohet kryengritja kundër tyre”.

Si çdo aspekt tjetër edhe Ahmeditë mundohen të paraqiten si drejtim serioz duke u munduar të kenë metodën dhe mësimet e tyre . Megjithatë, sado që mundohen të kenë mësimet të bazuara në islam , qëllimet e tyre lexohen shumë lehtë dhe shumë shpejtë del në shesh destruktiviteti i tyre për arsye se idetë e tyre, e mos të them mësimet e tyre bazohen në ide të shpikura nga vetë Mirza Gulam Ahmedi, si dhe në ide të mësimetve krishtere dhe gënjeshtre të ndryshme që nuk kanë kurrfarë baze fetare e logjike .

Mësimet e ahmedive si: dhënie Zotit cilësi të njeriut , pastaj mësimi mbi atë se pejgamberllëku nuk ka mbaruar ,prandaj Mirza Gulam Ahmedi është pejgamber ëë ka ardhur pas Isaut dhe Muhamedit a.s, pastaj se Kadijani ku ka lindur Mirza Gulam Ahmedi, është i shenjtë si Mekka dhe Medina dhe se Haxhi duhet te kryhet në të, bile edhe njëherë në vit, në xhenet do të shkojnë gjithë njerëzimi, myslimanë, të krishterë dhe jehudë, xihadi është ngritur dhe nuk është obligim për myslimanët, dhe se armiku anglezë duhet të respektohet dhe t'u shërbehet atyre, pse ato janë të zgjedhur nga Zoti për të qeverisur; mysliman është ai i cili beson Mirza Gulam Ahmeidt dhe se nuk i lejohet ahmedistit të falet pas joahmedistit. Të gjitha këto që u cekën, tregojnë që me te vërtetë këto mësimet nuk kanë asgjë të përbashkët me mësimet Islame.

Pra, marrë parasysh sektiin Ahmedi, si dhe të ngjashme me të në qëllime dhe strategji, si Babijtë dhe Behajjtë, do të shohim se ato veprojnë pandërprerë në mesin e myslimanëve .Gjatë veprimit të tyre përdorin strategji të veçantë, duke i marrë parasysh rrethanat e vendit dhe të rrethit ku jetojnë, kështu që në vendet ku Islami është thellë i rrënjosur dhe ku vetëdija e myslimanëve është në nivel më të lartë, ata fshehin idetë e tyre në masë,

analizojnë mirë vendin dhe kohën se ku duhet të veprojnë dhe kur duhet të veprojnë. Përgatitjet bëhen në atë mënyrë siç i kërkon mesi ku duhet të veprojnë. Zhvillojnë propagandë me një demagogji të paparë duke përdorur mjete të ndryshme si: pasuria dhënia e bursave për shkollim, aftësimin e misionarëve,shtypit, botimit të literaturës ne gjuhë të ndryshme, mjeteve informative, etj. Ahmeditë në Londër emetojnë dhe programin e tyre satelitor nëpërmes të cilit përhapin propagandën e tyre.

Ahmeditë, Behaitë dhe Babitë ndikimin e tyre mundohen ta ushtrojnë:

- në mesin e rinisë së papjekur dhe e dobët në njohjen e Islamit nëpërmes mjeteve financiare, bursave dhe premtimit të karrierës në jetën e tyre,

- në vendet ekonomikisht të dobëta dhe të varfra, ku nëpërmes të mirave materiale arrijnë t'i blejnë njerëzit dhe t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre,

-në vendet ku më tepër emigrojnë njerëz si dhe në mesin ku më tepër janë prezent refugjatët , në vendet ku ka ekzistuar zbrazëtira fetare, e sidomos në vendet e Evropës Lindore, ku ka sunduar ideologjia komuniste, në veçanti në vendet ballkanike, si në: Shqipëri , Maqedoni, Bullgari , shtetet e ish Bashkimit Sovjetik, etj.

2. TENTIMI I RINGJALLJES SË TARIKATEVE TË NDRYSHME

Në mënyrë të veçantë duhet analizuar dukurinë e paraqitjes dhe ringjalljes së gjithë më tepër të tarikateve, si ai i mevlevive, kadirijëve, nakshibendive, rufaive, etj. Individë të ndryshëm , të cilët aspak nuk e njohin Islamit, po bile edhe tarikatit në të cilën thirren, nën pretekst, se gjoja kultivojnë sufizmin burimor dhe me qëllime të llojllojshme politike, komerciale, destruktive, ngadalë, por me hapa të sigurt po depërtojnë në skenën fetare duke propaguar ide antiislame me qëllim të futjes së hutisë në mesin e myslimanëve, si dhe depërtimin e

tyre në mesin e popullatës-individëve të dobët në njohjen e fesë .

Në mesin tonë, me të madhe po del në skenë sekti bektashian, i cili vepron si shtrirje e linjës Turqi, Shqipëri, Maqedoni. Ajo që brengos, është fakti se ky sekt tenton të paraqitet jo vetëm si tarikat, por edhe si fe e re, në veçanti në trojet shqiptare, me parullën se te ata ekziston “urtësia”, “trimëria” dhe “burrëria”. Nuk është e rastit që në Shqipëri vepron si fe zyrtare, ndërsa në Maqedoni po zhvillon veprimtarinë e vet pa asnjëfarë problemi, edhe atë në pronën e BFI-së, të konfiskuar nga sistemi monist .

Është e nevojshme dhe e domosdoshme të ngrihet niveli i vetëdijes së myslimanëve rreth kësaj dukurie, se i ashtuquajtur tarikatit bektashian është produkt apo kombinim i elementeve të besimit të indusëve, konkretisht besimit Shamanist, duke absorbuar në vete idetë e shiizmit në njërin anë, dhe ato krishtere ne anën tjetër. Në esencë, pjesëtarët e këtij tarikati, jo vetëm që besojnë në 12 imamijtë shiitë, por në të njëjtën kohë kultivojnë edhe trininë bektashiane: Zoti, Muhamedi dhe Aliu, sipas shembullit të trinisë së shenjtë në krishterizëm. Në mësimet e tyre absorbojnë edhe shumë elemente tjera të krishterimit, si: festimi i rastit të pranimit të anëtarit të ri me verë, bukë e djathë, pastaj rrëfimi i mëkatarëve para udhëheqësve të tyre, si dhe preferimi i disa pjesëtarëve të këtij tarikati mosmartesën celibatin. E gjithë kjo, tregon se me këtë tenton te formohet një fe e re, e përzier nga elemente të ndryshme. Kohëve të fundit vërehet edhe tendenca e individëve të ndryshëm, se gjoja sekti bektashian duhet të inaugurohet si fe e re për shkak të “përshtatshmërisë” së tij në ruajtjen e unitetit kombëtar shqiptarë, pasi që në vete përmban elemente të të gjitha feve .

Ajo që është absurde dhe jo e logjikshme se ata tentojnë te veprojnë të pavarur, megjithëqë BI i ka inkuorporuar në suaza të organizimit të vet, duke aprovuar statut te posaçëm, në bazë të të cilit duhet të organizohen ky dhe

shumë tarikate tjera, me qëllim të ngritjes së nivelit të njohjes së Islamit, si dhe për t'i pastruar ato nga elementet joislame.

3. PARAQITJA E "IZMAVE" TË NDRYSHME

Në momentin kur menduam, se pas një ofensive të furishme mbi 40 vjeçare të sistemit monist-komunist-pansllavist, arritëm ta mbarojmë traditën tonë islame të kultivuar mbi 5 shekuj, dhe kur përgatiteshin për shërimin e plagëve që i përjetoi kjo traditë, në trevat ballkanike papritmas paraqiten "izma" të ndryshme me karakter radikal, me pretekst të përhapjes së Islamit burimor. Propaguesit e këtyre "izmave" të ashtuquajtura lëvizje radikale, pa mos i analizuar kushtet, rrethanat, vendin dhe duke mos pasur llogari në gjithë atë që është krijuar deri më tani, propagojnë braktisjen fikhut, të cilin e kanë begatuar kokat kolosale myslimane përgjatë shekujve. Ata, e bëjnë këtë nën pretekstin, se duhet kthyer Islami burimor, për arsye se mënyra e praktikës së Islamit në bazë të medhhebeve, e në veçanti atij hanefij, është i gabuar dhe rrënjësisht duhet të ndryshohet, duke filluar prej çështjes së Teuhidit, e deri te ato juridike-fetare. Qëndrimet e tyre teorike dhe praktike, si dhe forma krejtësisht ndryshe në kryerjen e obligimeve fetare nga ajo që është trasuar në viset tona si: ndalimi i faljes së sunneteve ne xhami, ngritja e duarëve në mënyrë të çuditshme, mos heqja e tespive, veshja e xhelabisë në vend të pantoloneve, ulja në hasr në vend se në ulëse gjatë dëgjimit të ligjëratës, mos organizimi i manifestimit të ditëlindjes së Muhamedit a.s (mevludit), etj. në mesin e besimtarëve fut një huti të paparë që dashtë e pa dashtë bënë të pyesin:

- Çka është kjo fe e re? A thua nuk na qenka e vërtetë kjo praktikë e Islamit që kemi ndjekur dhe ndjekim sot? Çka paskan qenë alimët tanë më parë shekuj me radhë? Çka ka ndodhur me myslimanët shekuj me radhë më parë që jetuan dhe ndërruan jetë duke u sjellë në bazë të traditës islame të deritashme, e bazuar në drejtimin juridik - medhhebin hanefij? Çka më tutje dhe çfarë drejtimi të ndjekim në të ardhmen?..etj.

Nëse në rrethanat e sotshme, e gjithë kjo nëse analizohet mirë, do të vijmë në konkludim se e ashtuquajtura lëvizje selefiste dhe të tjerat me karakter radikalit, nuk janë asgjë tjetër përveç se

- tentim për të krijuar huti dhe probleme aty ku nuk ka;

- kthimi i vëmendjes së myslimanëve drejt çështjeve sporadike dhe jo të rëndësishme, në vend që të merren me çështje esenciale dhe aktuale;

- paraqitja e fesë si diçka e çuditshme, të rëndë dhe jo praktike dhe joracionale për trevat ku jetojmë;

- kthim pas, në vend që të mendohet për

zgjdhjen e çështjeve të cilat janë parësore dhe vendimtare për fatin e Islamit dhe myslimanëve në këto treva;

-vendosja e fatit të shpjegimit dhe praktikimit të Islamit në duar të individëve apo grupeve jo kompetente dhe jo profesionale;

-mohim dhe zhdukje e një tradite shumëshekullore Islame mbi të cilën është ndërtuar e kaluara jonë dhe e cila paraqet bazë për sigurimin e të tashmes dhe të ardhmes sonë;

-pengimi i kontinuitetit të kultivimit dhe zhvillimit të Islamit nga subjektet kompetente legjitime, etj.

-krijimi i një pasqyre të shëmtuar të Islamit në vendin dhe kohën në të cilën jetojmë;

-tentim për t'u mënjanuar, shmangur dhe degraduar subjektet profesionale teologjike të cilët unanimisht kanë vendosur se drejtimi juridik hanefit edhe më tutje paraqet bazë mbi të cilën duhet mbështetur strategjinë e zhvillimit dhe kultivimit të Islamit në këto treva.

Pra, çështja e "izmave" të ndryshme, sot po shqyrtohet edhe në nivele më të gjëra dhe më të larta botërore islame, duke u analizuar si një fenomen që paraqet tendencë e cila nuk përkon me parimet themelore të shpjegimit të Islamit në rrjedhat e kohës dhe vendit. Sa për ilustrim për këtë po e sjellim mendimin e dijetarit me famë botërore në botën Islame Jusuf El Kardaviu i cili në lidhje me këtë çështje thotë:

"Disa radikalist tashmë kanë filluar të propozojnë braktisjen e fikhut të cilin (si shkencë) e kanë begatuar kokat kolosale myslimane përgjatë shekujve, duke kërkuar kthim në shariat burimor në vend që të favorizojnë idenë mbi përtëritjen, përshtatshmërinë dhe modifikimin e këtij mësimi klasik. Ata të drejtën Islame historike të të gjithë medhhebeve e krahasojnë me petkun që shqepet dhe qepet si modele rreptësisht të kufizuara, ndërsa Sheriati, në realitet është pëlhurë e gjatë dhe e gjerë që i përgjigjet çdokujt që e përdor për veshje, vetëm që duhet të merret e të qepet sipas masës përkatëse. Ky mendim me të vërtetë është jopraktik, absurd dhe i dëmshëm, meqë shkenca zhvillohet, prosperon dhe kompletet me inovacionet dhe plotësimet e gjeneratave që vijnë, me të arriturat e gjeneratave pararendëse, e jo përmes shembjes rrënimin dhe mos përfilljes totale të tyre...

Nuk mund të pranohet, e as të paramendohet që ai që dëshiron të komentoj Kur'anin të lë pas dore krejtësisht komentet e alimëve të mëparshëm, e nga ana tjetër, t'i përvishet asaj pune vet. I këtili detyrimisht do të devijojë, njëjtë siç

ka ngjarë edhe me ca dijetarë të tjerë mendjelehtë e arrogantë".

Është e vërtetë, se ka çështje të cilat nuk janë shqyrtuar në medhhebet që ekzistojnë ose ka nevojë disa çështje të ritudiohen, apo ripërtërihen për arsye se sot, me ndryshimin e rrethanave dhe kushteve, çdo ditë lindin gjithnjë më tepër çështje të cilat kërkojnë zgjidhje në baza të Sheriatit Islam. Çështjet të tilla kemi në të gjitha fushat, si ato shoqërore, po ashtu edhe në atë politike, ekonomike, ndërkom-bëtare, etike, etj. Kjo kërkon hapjen e dyerve të institucionit të Ixhtihadit, të cilin jo vetëm që nuk e mohon Sheriati islam e as medhhebet, por është kërkesë e domosdoshme e kohës në të cilën jetojmë.

Por, edhe hapja e dyerve të institucionit të ixhtihadit nuk nënkupton braktisjen e trashëgimisë së fikhut ose reduktimin e vlerës dhe efektit të saj, porse me të nënkuptohet mbështetja e domosdoshme, së pakti, në tri parime kryesore:

Të bëhet rishqyrtimi i trashëgimisë së pasur të fikhut (shkollave

Juridike, drejtimeve dhe mendimeve autoritative) nëpër epoka të ndryshme në frymën e kushteve dhe pozicioneve të reja, më pastaj të bëhet seleksionimi i pikëpamjeve autentike në to dhe i atyre më optimale për sëndërtimin e intencave të Sheriatit dhe për vendosjen e mirëqenies së Umetit në kohën e vet;

Kthimi i burimeve duke i studiuar ato në prizmin dhe dritën e

objektivave e qëllimeve të përgjithshme të Sheriatit;

Zhvillimi i Ixhtihadit në çështje dhe situata te reja, të cilat s'i kanë

njohur juristët e mëparshëm, e as që kanë sjellë vendime për çështje të ngjashme me ato, për të cila duhet zgjidhje përkatëse në dritë të argumenteve të Sheriatit.

Bashkësia Islame në RM, si institucion shumë shekullor dhe i vetmi kompetent në organizimin e jetës fetare dhe si shprehje e forcave intelektuale-teologjike që janë produkte të këtij populli dhe i kësaj tradite islame shumë shekullore, me përgjegjësinë e nivelit më të lartë mban timonin drejtë rrugës për mbrojtjen, zhvillimin dhe kontinuitetin e islamit në këto treva dhe më gjerë. Njëherit me një strategji dhe metodologji të karakterit bashkëkohor dhe një veprimtari të kualitetit më të lartë jo vetëm që ju përgjigjet nevojave dhe kërkesave që i paraqet koha dhe vendi, por zgjeron ndikimin vet edhe më gjerë, duke shfrytëzuar origjinalitetin e punës së vet si dhe përvojën që e përfiton si anëtare e shumë organizatave botërore islame. Kjo shihet në formën e organizimit juridik ekonomik si dhe në ngritjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve fetaro-arsimore që janë bazë për kultivimin e islamit si dhe sigurimin e ardhmërisë së tij dhe myslimanëve në këto treva dhe më gjerë.

Autori është Myfti i Myftinisë së BFI- Gostivar

Të Drejtat e Njeriut sipas Sheriatit

Nga thëniet e Muhammedit a.s. është kjo: “Kush dhunon të drejtat e të krishterëve dhe hebrenjve, apo i mundon me atë çka ata nuk mund të durojnë dhe rezistojnë, unë do t’i jem kundërshtarë në Ditën e Gjykimit”.

Aplikimi i Deklaratës mbi të Drejtat e Njeriut në periudhën e kalifëve të drejtë:

“Kush dhunon të drejtat e të krishterëve dhe hebrenjve, apo i mundon me atë çka ata nuk mund të durojnë dhe rezistojnë, unë do t’i jem kundërshtarë në Ditën e Gjykimit”. Pas Muhammedit a.s. pasardhësit e tij në të njëjtën mënyrë sillëshin ndaj jomyslimanëve, duke u mbështetur në atë çka udhëheqësi dhe shëmbëlltyra e tyre kishte bërë marrëveshje. Ata në gjithçka vazhduan ta zbatonin atë që Muhammedi a.s. ishte pajtuar me jomyslimanët.

Shkrimi dhe shpirti i dokumentit medinas, i vërtetuar gjatë fjalimit në Arafat, ishte prezentë edhe atëherë, kur myslimanët mbetën pa praninë fizike të Muhammedit a.s. autoritetit të paprekshëm. Kjo në mënyrë të veçantë vjen në shprehje gjatë udhëheqjes së katër kalifëve, si pasardhës të Muhammedit a.s.: Ebu Bekrit, Omerit, Osmanit, dhe Aliut r.a.

Marrëveshja me krishterët e Ebu Nexhrenit ishte pa kurrfarë dyshimi, pohim i asaj që theksuam më sipër. Por, krahas vërtetimit të dokumenteve të proklamuar, të cilët trajtonin pozitën dhe çështjet e të drejtave të jomyslimanëve, në varësi të situatës në të cilën ndodheshin, si dhe për shkak të faktit se në kohën e tyre, sidomos në kohën e kalifit Omer, shteti islam u zgjerua shumë, gjithashtu janë disa dokumente në lidhje me këtë problematikë.

Përveç në tituj, apo në zgjidhjen e ndonjë çështjeje e cila nuk ishte aktuale para rolit të tyre politik si kalif, nuk kishte ndonjë ndryshim



themelorë në mes atyre dokumenteve dhe rezolutave të reja dhe atyre që ekzistonin më parë.

Kalifi i parë Ebu Bekri r.a. duke e përcjellë komandantin e ushtrisë Jezid ibn Ebu Sufjan, të cilit i ishte besuar ndalja e bizantinëve në Siri, e urdhëroi duke i thënë:

“Të urdhëroj t’iu përmbahesh këtyre parimeve:

Mos vrit gra, fëmijë dhe pleq;

Mos prit palma dhe drunj dhe perime;

Mos digj të mbjellat;

Mos shkatërro asgjë që është duke u rrëzuar;

Mos therë bagëtinë, vetëm aq sa të nevojitet për ushtrinë;

Mos u bën qyqar;

Mos e tejkalo kufirin as në luftë as në fitore;

Do të gjesh njerëz të cilët thonë se vullnetarisht janë mbyllur në vetmi. Mos i zemëro ata, por lëri të qetë;

Spiunët dhe ndërsyesit në luftë nuk duhet të kursehen!”

Omer ibn Hatabi (i cili u zgjodh kalif në vitin 635) pas çlirimit të Egjiptit i dërgoi një letër mëkëmbësit të tij Amr ibn El-As, i cili e çliroi këtë vend, ku mes tjerash e paralajmëron:

“Në Egjipt me ty gjenden edhe të mbrojturit (dhimijët) e shtetit islam!

Muhammedi a.s. na ka urdhëruar të sillemi mirë ndaj tyre.

Nga thëniet e Muhammedit a.s. është kjo: **“Kush dhunon të drejtat e të krishterëve dhe hebrenjve, apo i mundon me atë çka ata nuk mund të durojnë dhe**

rezistojnë, unë do t'i jem kundërshtarë në Ditën e Gjykimit”.

O Amr! Ruaju që Muhammedi a. të mos jetë kundërshtari yt në Ditën e Gjykimit, sepse ai që e akuzon Muhammedin a.s. do ta humb gjyqin (pro-cesin)!”

Katër kalifët e parë, si dhe të gjithë besimtarët e sinqertë, janë munduar që me përpikmëri të ndjekin udhëzimet e Muhammedit a.s. si dhe të kryejnë të gjitha urdhrat e tij dhe t'i kthejnë në vepra të gjitha obligimet dhe dekretet. Gjithsesi këtu është fshehtësia e të vepruarit të katër kalifëve ndaj nënshtetasve të tyre jo myslimanë. Fakti që ata ishin prezent kur ishte shkruar dokumenti medinas flet në favor të ndikimit real dhe reflektimit të këtij dokumenti në të gjitha dokumentet tjera të ngjashme të cilët u aktualizuan më vonë.

DOKUMENTI E OMERIT (UHDETUL-UMERIJE)

Kalifi i dytë i cili erdhi pas Ebu Bekrit dhe mori rolin e udhëheqjes së shtetit islam, Omer ibn Hatab, është njëri nga më meritoret që shpirti i dokumentit medinas arriti deri në Jerusalem, qytet i shenjtë që për të akoma sot e kësaj dite pretendojnë të krishterët, hebrenjtë dhe myslimanët. Ushtria muslimane në kohën e Omerit r.a. hyri në Jerusalem. Patriarku krishterë Sofronijus insistoi që kalifi Omer person-

alisht të vijë në këtë qytet të shenjtë, dhe me këtë kishte për qëllim vetëm atij t'ia dorëzoj çelësat e kryeqytetit të tri religjioneve. Atëherë mes atyre të dyve, si përfaqësues të anëve u arrit një marrëveshje, e cila në çdo gjë, përveç në vëllim, ishte vazhdimësi e dokumentit medinas, kjo marrëveshje quhej Dokumenti i Omerit (**Uhdetull-Umerije**):

Teksti i dokumentit të Omerit:

“Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Ky është dokument i robit të Zotit Omerit, Prijësit të besimtarëve, që u dedikohet banorëve të Jerusalemit:

Të drejtat e qytetarëve të Jerusalemit:

U sigurohet jeta dhe pasuria e tyre;

U jepet siguri kishave dhe kryqeve;

Të ndihmohen të pafuqishmit dhe të dobët;

Askush nga besimtarët e besimeve tjera nuk do të vendoset në faltoret e tyre;

Askush nuk guxon t'i kufizoj dhe t'i shkatërroj, e as t'i largoj skulpturat e tyre; dhe

Nuk guxon askush t'i detyroj që ata ta ndërrojnë fenë e tyre.”

Me insistimin e vet banorëve të Jerusalemit, në dokument është vendosur edhe një nen i pazakontë, që për rastin e tyre ishte produkt i rrethanave reale të cilat mbretëronin në atë kohë i cili

nen thotë:

“Asnjë nga hebrenjtë pa dëshirën e tyre nuk do të shpërngulet nga Jerusalemi.”

Ky nen qartazi ishte pasojë e përleshjeve krishtero- hebrenje, që ekzistonin që më parë Jerusalem, para ardhjes së myslimanëve, sepse raporti i myslimanëve ndaj hebrenjve na jep të drejt të themi se myslimanët nuk kanë insistuar në këtë, por kjo ishte pasojë e kërkesës nga ana e të krishterëve.

Obligimet e banorëve të Jerusalemit:

- Duhet të japin xhizjen siç e japin jomuslimanët në pjesët tjera të shtetit islam;

- Nga rrethi i tyre t'i largojnë bizantinët (që atëherë ishin në luftë me muslimanët);

- Nëse ata personalisht (banorët e Jerusalemit) dëshirojnë të shpërngulen, do të kenë siguri për veten dhe familjen e tyre gjatë shpërnguljes deri në vendin e sigurt për ta;

Nëse dëshirojnë të mbeten, do të kenë mbrojtjen e shtetit islam për veten, familjen dhe pasurinë e tyre; dhe:

Ata që mbeten do të paguajnë xhizjen;

Shkrimi i më sipër është i garantuar nga Zotit dhe i Dërguari i tij, ndërsa i obliguar për realizimin e kësaj është zëvendësi i të Dërguarit dhe Prijësi i

besimtarëve, deri sa banorët e Jerusalemit duhet të japin xhizjen ashtu siç janë marrë vesh.

Dëshmitarët e kësaj marrëveshjeje janë:

Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi, Abdurahman ibn Avfi dhe Muavi ibn Ebi Sufjani.”

Gjithsesi duke pasur para vetes këtë dokument, njeriu nuk mund të mos jetë i impresionuar kur ka në mendje vendosmërinë e përfaqësuesve të vërtet të Islamit dhe të filloj të ndjek diturinë burimore islame.

Duke krahasuar këtë dokument dhe situatë, e cila ishte pasojë e shkrimit të tij, me atë çka sot ndodh në këtë Qytet të Shenjtë, është shumë lehtë të arrijmë në përfundim në atë se çfarë ndikimi civilizues ai ka në të gjitha principet që janë aktuale kur kihet parasysh çështja e të drejtave të njeriut. Forca e këtij dokumenti nuk është vetëm në përmbajtjen e tij, por mbi të gjitha në vendosmërinë e atyre që ishin të obliguar për implementimin e tij.

Kur në vitin 1917 Jerusalemin e okupojnë anglezët, mareshali Allanby deklaroi se u jep liri fetare të gjithë njerëzve, duke marrë si shembull Omerin e Madh.

Marrë nga:
www.glas-islama.info

Nga boshnjakishtja:
Arsim Dauti



Mendo mirë para se të flasësh

Zuhdi Hajzeri

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. i cili thotë: kam dëgjuar Pejgamberin a.s. të ketë thënë : “ Vërtetë robi e fletë një fjalë e cila e dërgon në zjarr në një largësi sa në mes lindjes dhe perëndimit “ .

Pejgamberi a.s. thotë : “Vërtetë robi flet një fjalë duke mos e pasur të qartë se çka përmban ajo fjalë dhe kjo e dërgon në zjarr ...” .

Para se të fillojmë me përmendjen e mendimeve të dijetarëve në lidhje me kuptimin e këtij hadithi, dua të potencoj se udhëheqësit e familjeve, pasi All-llahu xh.sh. i ka nderuar me martesë dhe i ka larguar nga harami dhe dyshimet, duhet të kenë kujdes në ruajtjen e gjuhës nga fjalët e ndyta dhe nga ato gjëra që rëndojnë të thuash fjalë të këqija, në mënyrë që të mos nxjerrë nga goja asnjë fjalë të keqe, por vetëm të mirë, në mënyrë që ta fitoi kënaqësinë e All-llahut xh.sh në këtë botë dhe xhenetin në botën tjetër.

Transmeton Maliku dhe Buhariu se Pejgamberi a.s. ka thënë : “ Kush më garanton mua atë çka ka në mes të nofullave dhe atë çka ka në mes të këmbëve, unë ia garantoj atij xhenetin “ .

Si përforsim i këtij hadithi, cekim edhe hadithin tjetër të transmetuar nga Ebu hurejre, ku thotë: “ Atë që e ka ruajtur All-llahu xh.sh nga e keqja e asaj që e ka në mes të nofullave dhe nga e keqja e asaj që e ka në mes të këmbëve ka hyrë në xhenet” .

Mendimtari i njohur Ibni Abdulberr në lidhje me kete hadith dhe thotë: fjala e cila e dërgon personin në zjarr (e shkatërron) është fjala e vërtetë para një udhëheqësi zullumqar, ndërsa Ibni Betal thotë : fjala që e dërgon personin në zjarr është ajo fjalë që bëhet shkak për dëmtimin apo shkatërrimin e

“**Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë)**”
(u'minun: 1-2-3),

një myslimani.

Për vlerën e ruajtjes së gjuhës Ibni Haxher ka përmendur disa hadithe, në të cilat tregohet vlera e ndalimit nga fjalët e këqija,transmetohet nga Ibni Xhuhejfe i cila ka thënë : puna më e dashur tek All-llahu xh.sh është ruajtja e gjuhës.

Në lidhje me këtë çështje janë transmetuar një numër hadithesh, të cilat bëjnë të qartë edhe vlerën e heshtjes, hadithi i transmetuar nga Sufjan bin Abdullah Ethe kafij i cili thotë : i kam thënë të dërguarit të All-llhut xh.sh. më trego o i dërguar një punë që të kapem për saj , i dërguari i All-llahut xh.sh. më ka thënë : “ thuaj zoti im është Allahu dhe qëndro fort në te “ , pastaj i thash çfarë është ajo gjë që ti ke frikë për mua nga ajo? Ka kapur gjuhën e tij dhe ka thënë : “ kjo “ .

Po ashtu hadithi i transmetuar nga Abdullah Bin Amr bin As i cili thotë: kam dëgjuar Pejgamberin a.s. të ketë thënë: “ kush hesht shpëton “ .

Hadithi i transmetuar nga Berrae bin Azib i cili thotë : ka ardhur një person te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë : o i dërguari i Allahut më mëso një punë e cila më bënë të hyj në xhenet(në fund të hadithit thuhet) ,ka thënë Pejgamberi a.s. : “ ushqeje një të uritur, jepi të pijë të eturit,urdhëro në të mirë dhe ndalo nga e keqja e nëse nuk ke mundësi atëherë ndaloje gjuhën tënde nga fjala e keqe dhe thuaje vetëm të mirën “ .

Të gjitha këto hadithe, të cilat i cekëm më lartë, e shumë të tjera që nuk i kemi cekur, tregojnë qartë se e keqja më e madhe njeriut i vjen nga gjuha e


tij! Nëse flet pa menduar mirë, dhe duke mos e pasur të qartë se çfarë është duke folur, mysliman i vërtetë është ai i cili e kontrollon gjuhën e tij, dhe nuk e thotë përveç atë fjalë me të cilën All-llahu është i kënaqur, pa marrë parasysh se sa është në vështirësi ose sa të këqija e rrethojnë, dhe sa është ngushtuar zemra e tij, shembullin më të mirë për këtë e kemi te Musai a.s. i cili thotë : “**do të më shtrëngohet krahrori (shpirti) im dhe nuk do të më lëshohet gjuha ime**“ (Shu'ara: 13) .

Kjo edukatë e ruajtjes së gjuhës, dhe shqiptimi vetëm i fjalëve të mira e të bukura, është edukatë e robërve të All-llahut xh.sh., këtë e tregon kurani famëlartë ku thuhet : “**E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët , ata thonë : “Paqë!”**“ (Furkan: 63).

Fjala e mire, ishte ligj dhe urdhër për Benu Israilët, në kuranin famëlartë thuhet: “**thuani fjalë të mira; falnie namazin dhe jepni zeqatin**“ (Bekare: 83).

Madje All-llahu xh.sh e ka sqaruar edhe më tepër, duke treguar se tek ai ngjitet vetëm fjala e mirë dhe vetëm puna e mirë : “**te Ai ngritet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mire**” (Fatir: 10).

Vërtetë begatia e quajtur gjuhë është begatia më e madhe që All-llahu xh.sh i ka dhënë krijesës njeri ,njeriu me gjuhën e tij adhuron All-llahun xh.sh ,përmes gjuhës komunikon me të tjerët ,përmes gjuhës njeriu tregon atë që e ka në brendësi, tregon atë se çfarë e preokupon



zemrën dhe shpirtin e tij.

Me anë të gjuhës besimtari e shqipton shehadetin (dëshminë), falë namazin dhe kryen shumë obligime, urdhëron për punët e mira dhe ndalon nga punët e liga.

Nëse gjuha përdoret në këtë mënyrë, ajo mund të përdoret edhe për të kundërtën e kësaj.

Imam Ebu Hamid Elgazali thotë: Vërtetë gjuha është një nga mirësitë e mëdha dhe të shumta që All-llahu xh. sh i ka dhënë njeriut dhe, po ashtu është një gjymtyrë shumë e çuditshme, sepse edhe mosbesimi në zotin nuk bëhet i qartë plotësisht, vetëm atëherë kur gjuha tregon për këtë, mosbesimi është kulmi i mëkateve dhe besimi kulmi i nënshtrimit ndaj k r i j u e s i t . Të gjitha këto që i cekëm, bëjnë të mundshme lehtësimin njerëzve që të largohen nga fjalët e pavlera, të biseduarit çdo gjë që dëgjon dhe çdo gjë që thuhet, përhapjen e gënjeshtreve, e shumë cilësi të dëmshme për njeriun.

Më poshtë do cekim disa të vërteta në mënyrë që besimtari të ketë kujdes para se të flasë:

1. Fjala dhe thënia tregojnë për thëniesin e saj, duke zbuluar të vërtetën rreth tij si për të mirë ashtu edhe për të keq, All-llahu xh.sh thotë : **“Të këqijat (gra ose fjalë) janë për të këqinjët edhe të këqinjët janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit edhe të ndershmit janë për të ndershmet.**

Ata janë të pafajshëm nga ajo që u thonë atyre. Ata kanë falje të madhe dhe furnizim të begatshëm “(Nur: 26), Ibni Abas në lidhje me komentimin e këtij ajeti thotë : fjalët e këqija janë për burrat e këqij, burrat e këqinjë janë për fjalët e këqija, fjalët e mira për burrat e mirë.

2. Fjalët vetëm shtohen dhe nuk pakësohen ,rriten dhe nuk zvogëlohen ,forcohen dhe nuk dobësohen,rriten degët e sajë dhe zgjaten, All-llahu xh.sh thotë : **“A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart, E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. All-llahu, pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar. All-llahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët All-llahu i bën të humbur. All-llahu punon çka të dojë”**(Ibrahim: 24-27).

3. Fjala është shumë e gjerë dhe nuk ka fund, të gjitha gjërat që ekzistojnë, përmes gjuhës tregohen, të gjitha që duken gjuha i sqaron, çdo gjë që ndodhë përmes gjuhës mund të analizohet dhe sqarohet, kjo veçori nuk ndodhet tek gjymtyrët

tjera.

All-llahu xh.sh i udhëzon në disa ajete kur'anore besimtarët duke iu thënë : **“O ju besimtarë, pëmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thuani fjalë të drejta. Ai (All-llahu) iu mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.** (Ahzab: 70-71) , **Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paaftë për të cilët kanë dro (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen All-llahut (dënimin të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindore.**(Nisa: 9), **A je i njoftuar për atë që mohoi argumentet Tona e tha: “Mua githqysh do të mëjepet pasuri e fëmijë (në botën tjetër)?” Jo, nuk është ashtu, po Ne do të shënojmë atë që po e thotë ai, dhe do të vazhdojmë atij dënim pas dënimi Dhe Ne e trashëgojmë atë (në pasuri e fëmijë) që të thotë ai, e ai ka për të na ardhur i vetmuar.”** (Merjem: 77-80).

Feja islame kërkon nga besimtarët që të flasin pasi të mendojnë mirë, dhe duke e pasur të qartë se çfarë do të flasin, nëse është e mirë shpërblehet, e nëse është e keqe, atëherë ruhet nga ajo dhe hesht, transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “ Kush beson All-

llahun xh.sh dhe ditën e fundit (le ta thotë të vërtetën) ta thotë atë që është e mirë ose të hesht” .

Imani besimi i robit të All-llahut xh.sh nuk është i plotë përveç atëherë kur i shmang dhe largohet nga ato që i ka ndaluar krijuesi i gjithësisë, dhe duke i lënë ato gjëra me të cilat krijuesi nuk është i kënaqur, po ashtu duke iu larguar edhe gjërave të dyshimta, pejgamberi a.s. thotë : “ islami i mirë është i atij që i le ato që nuk kanë vlerë”.

Sheriati islam marrjen me fjalët e kota dhe të pavlera dhe që janë larg nga e mira, i emërton me shprehjen *Lagv*, e cila do të thotë: e pa vlerë e pa dobi dhe e pakuptimtë, besimtari nuk duhet ta futë veten në gjëra të tilla si nga fjalët ashtu edhe nga veprat e liga, All-llahu xh.sh thotë: **“Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përuhur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë)”**(Eu'minun: 1-2-3), **“(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.”**(Furkan: 72) , **“Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: “Ne kemi vepra tona e ju tuajat, qofshit larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!”**(



Kasas: 55), po ashtu All-llahu xh.sh i shpërblen besimtarët në xhenet me mos dëgjimin e këtyre fjalëve të kota e të pavlera, në lidhje me këtë në kuranin famëlartë thotë: **“Aty nuk dëgjojnë fjalë të këqija as që janë mëkat (gënjeshtër). Vetëm thënie: selam pas selami.”** (Vakia: 25-26).

Ata të cilët flasin shumë fjalë të kota e të pavlera, bisedojnë në lidhje me çdo gjë që dëgjojnë, përhapin gënjeshtër, ata persona janë më të këqij tek All-llahu xh.sh., sepse jo çdo gjë që dëgjohet edhe flitet, peygamberi a.s. thotë: “Mjafton për njeriun të jetë gënjeshtar të flasë krejt atë që e dëgjon “. Edhe më të këqij se këta persona janë ata të cilët fabrikojnë gënjeshtër, i akuzojnë njerëzit me gjëra nga të cilat janë të pastër, ua mveshin atë që nuk e kanë thënë, apo nuk e kanë vepruar All-llahu xh.sh thotë: **“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me shpifje dhe me një mëkat shumë të madh.”** (Ahzab: 58).

Mu për këtë islami ka ndaluar të flitet ajo çka njerëzit flasin rrugëve, po ashtu ndalon gënjeshtër dhe përhapjen e sajë, peygamberi a.s. thotë: “vërtetë All-llahu ka bërë haram tri gjëra dhe ka ndaluar nga tri gjëra ,ka bërë haram mosrespektimin e prindërve, varrosjen e vajzave për së gjalli dhe mosdhënien e zekatit ,dhe ka ndaluar nga tri gjëra: thashethemet, pyetjen e shumtë dhe humbjen e mallit” . T hashethemet janë ato fjalë, kur një person thotë: është duke u folur kështu, ka thënë filani kështu, kjo është një nxitje për besimtarin që ta thotë vetëm atë për të cilën është i sigurt, kemi rastin e akuzimit të Aishes r.a., All-llahu xh.sh ua ka tërhequr vërejtjen myslimanëve dhe i ka frikësuar, që të mos e bëjnë një gjë të tillë kurrë, në lidhje me këtë në Kur’anin famëlartë thuhet: **“Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishit kurrfarë dije folëshit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te All-llahu ajo është e madhe.”** (Nur: 15).

Pas kësaj ngjarje All-llahu xh.sh i ka porositur të edukohen me disa edukata, e një nga to është që nëse dëgjon ndonjë fjalë që nuk përshtatet me mys-

limanin, atëherë duhet të ketë mendim të mirë për besimtarin, dhe ta marrë atë për të mirë sikur është thënë në kur’anin famëlartë : **“E përse, kur e dëgjuat atë, nuk thatë: “Ne nuk na takon të flasim për këtë. I lartë je Ti, kjo është shpifje e madhe!”** (Nur: 16).

Kush dëgjon fjalë të liga dhe pas kësaj fillon të ketë në vetvete mendime të këqija për besimtarin , atëherë menjëherë duhet që ti largoi dhe të mos i flasë askujt për atë që e ka dëgjuar, në lidhje me këtë All-llahu xh.sh thotë : **“E përse, kur e dëgjuat atë, nuk thatë: “Ne nuk na takon të flasim për këtë. I lartë je Ti, kjo është shpifje e madhe!”** (Nur: 16).

Pastaj All-llahu xh.sh i ka mësuar dhe ua ka bërë me dije atyre që përhapin ndyrësi , se All-llahu xh.sh i ka mallkuar , dhe për ta ka përgatitur dënim të dhembshëm ,në këtë botë dhe në botën tjetër,këtë e sqaron All-llahu xh.sh në disa ajete kur’anore ku thuhet : **“All-llahu nuk do publikimin e shprehjeve të këqija përveç (publikimit) të atij që i bërë padrejtë. All-llahu është dëgjues, i dijshtëm”** (Nisa: 148), **“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk dini.”** (Nur: 19).

Ndërsa pyetjet e njerëzve në lidhje me gjendjet e njerëzve, siç janë pyetjet rreth detaleve të jetës së personit,duke pyetur si e fiton pasurinë, duke pyetur për lumturinë dhe problemet familjare .. etj , nuk ka dyshim se të gjitha këto dhe të tjera janë të urryera dhe të ndaluara nga All-llahu xh.sh, peygamberi a.s. thotë: “vërtetë Allahu ka ndaluar thashethemet dhe pyetjet e shumta”, ngase këto gjëra, në të shumtën e rasteve të krijojnë fatkeqësi, armiçësi dhe urrejtje, ngase këto pyetje mund ta shtyjnë njeriun të gënjej, në atë mënyrë që ta mbuloi dhe fshehë gjendjen në të cilën gjendet.

Humori në të shumtën e rasteve është i dëmshëm, sepse nxit në përtaci dhe bënë që jeta të mos merret me seriozitet dhe të harrohet dita e fundit, po ashtu humori bënë që të qeshim shumë e në lidhje me këtë Peygamberi a.s.thotë:” Po ta dinin atë çfarë di unë do të kishit qeshur pak e do të qanit shumë

“.

Omeri r.a. thotë: “ Kush flet shumë gabon shumë, kush gabon shumë i pakësohet turpi e kujt i pakësohet turpi i pakësohet devotshmëria e kujt i pakësohet devotshmëria i ka vdekur zemra”.

Humori, i cili është i zhveshur nga gjërat që të krijojnë armiçësi, është i lejuar dhe është moral i mirë, sheriatu ka nxitur për këtë, Imam Gazaliu thotë: “ Nëse dikush thotë se edhe peygamberi a.s. ka bërë humor me shokët e tij, përse atëherë të ndalohej humori “? Ne i themi: nëse mund ta bësh atë që e ka bërë peygamberi a.s. me shokët e tij, me të cilët ka bërë humor, por e ka thënë vetëm të vërtetën, dhe nuk ka lënduar asnjëherë asnjë zemër, duke mos e tepruar asnjëherë, atëherë s’ka problem, por është gabim i madh që njeriu humorin ta bëjë profesion të tij dhe duke e tepruar, e pastaj të mbështetet në atë se edhe peygamberi a.s. ka bërë humor.

Këtu po cekim një shembull nga jeta e peygamberit a.s kur peygamberi a.s. ka bërë humor, që njerit nga shokët e tij i drejtohet me fjalët “ o ti me dy veshë” e kjo është e vërtetë ngase njerëzit kanë dy veshë ,peygamberi a.s. ka bërë humor por e ka thënë të vërtetën.

Përfundim - Të gjithë atyre që e teprojnë në të folur, pa ndonjë kontroll, ta dinë mirë se melaiket e shkruajnë çdo gjë që njeriu e shqipton,këtë të vërtetë All-llahu xh.sh e ka cekur qartë në kuranin famëlartë ku thuhet : **“Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë, Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.”** (Kaf 17-18), pastaj All-llahu xh.sh në lidhje me zullumqarët thotë: **“A mos vëndosët për ndonjë çështje (grackë kundër Muhammedit), por edhe Ne kemi vendosur (ta ndihmojmë). A mendojnë se Ne nuk dëgjojmë ndjenjën e fshehtë të tyre dhe bisedën mes tyre? Po, e dëgjojmë dhe të dërguarit tonë (engjëjt përcjellës) që janë pranë tyre, shkruajnë.”** (Zuhruf: 79-80), i gjithë ky regjistrim bëhet që robi të shpërblehet me të mira apo me të këqija.

Atyre që njerëzit e ligë i dëmtojnë dhe lëndojnë me gjuhën e tyre, u themi që të durojnë dhe

ta fitojnë shpërblimin e All-llahut xh.sh në ditën e kiametit, dhe ta kenë të qartë se askush në këtë botë nuk shpëton nga gjuhët e njerëzve, madje kanë gënjyer edhe për All-llahun xh.sh e ai është larg çdo të mete që ata i përshkruajnë, pastaj kanë gënjyer edhe për peygamberin a.s., po ashtu edhe për shumë besimtarë të devotshëm siç kemi rastin e Aishes r.a., peygamberi a.s, thotë : “ askush nuk është më durimtarë se Allahu ndaj të këqijave që ka dëgjuar ,ata e kanë akuzuar që ka djalë e ndërsa ai i falë dhe i furnizon” .

Çdo besimtari i themi që të ketë kujdes me gjuhën e tij dhe ta mbyllë atë me drynin që i ka dhënë All-llahu xh.sh, e që ky dry janë dy buzët , në mënyrë që të shpëtoi nga gabimet duke e mundur shejtanin e mallkuar, në lidhje me këtë All-llahu xh.sh thotë : **“A nuk i dhamë Ne atij dy sy? Edhe gjuhë e dy buzë? Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët. E ai nuk u hodh në përpjetëzen (rrugë e vështirë - qafmalit). E ç’gjë të mësoi ty se ç’është Akabe (rruga e vështirë)? Është lirimi i një skllavi, Ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: Ndonjë jetimi që është i afërt, Ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria. E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).Të tillët janë të zotët e anës së djathtë“** (Beled: 8-18).

Kjo është pasuri e të urtit dhe të gjithëdijshmit, i cili e dinë çfarë është e mirë për robërit e tij , All-llahu xh.sh thotë : **“E ti robve të Mi thua: “Le ta thonë ata që është më e mira, pse djalli ndërren mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut”. Zoti i juaj më së miri e di gjendjen tuaj, nëse Ai do, ju mëshiron dhe nëse Ai do, ju dënon, e ty (Muhammed) nuk të kemi dërguar rojë të tyre (nuk ta besuam ty punën e tyre e t’i fusësh me dhunë në besim). Zoti yt e di më së miri gjenden e atij që është në qiej e tokë. Ne kemi dalluar disa peygamberë nga të tjerët, prandaj, Davudit i kemi dhënë Zebur (shënime).“** (Elisra: 53-55)

Martesa në Islam (2)

“Institucioni martesë përbëhet prej dy postulateve të familjes, burrit dhe gruas. Thirrja Islame për zgjedhjen e shokut të jetës është tejet transparente dhe e qartë.”

Ismet BYTYQI

Allahu xh.sh. në Kuran, thotë: “Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por përgatitni për veten tuaj, dhe kine frikë Allahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepu myzhde.” (El-Bekare: 223)

Ky ajet qartëson rëndësinë e gjenezës dhe vendmbjelljes së bazës suaj. Gjithë ky proces është në mbikëqyrje të një sistemi i quajtur Sheriat-Juridik dhe i rregullores ligjore e përmbajtur nga shkëlqimi i djepit të imanit, të quajtur shpirt.

Faktori pozitiv, animi i në gjinie kundrejt një gjinie tjetër përbën mënyrën e të ndërtuarit dhe vendosjes të marrëdhënieve jetësore, duke ndërtuar ndërgjegje tek besimtarët e sinqertë, se jeta pa martesë legale nuk meriton kënaqësinë dhe bekimin e Allahut xh.sh.

Andaj, Muhamedi a.s. i këshillonte të rinjtë që të martohen duke thënë: “O ju të rinj, kush ka mundësi prej juve për tu martuar, le të martohet, pasi martesë ndihmon në ruajtjen e shikimit dhe mbron nga amoraliteti, e ai i cili nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë, pasi ai (agjërimi) është mbrojtje për të.” (Buhariu dhe Muslimi)

Martesa është bazë për formimin e një gjeneze besimtarësh në parimet e shpirtit të pastër, në parimet e ruajtjes së nderit.

Institucioni i quajtur martesë është kriteri parësorë i ruajtjes së familjes, ruan karakterin dhe në mënyrë efikase ndikon në baraspeshën psikike në mes të bashkëshortëve.

Martesa e shëndoshë e ndërton në themelet e besimit Islam siguron një shoqëri të shëndoshë dhe normale, anasjelltas statusi singël është një mundësi për t’u sfiduar me një shoqëri përplot anomalish shoqërore.

Institucioni martesë përbëhet prej dy postulateve të



familjes, burrit dhe gruas. Thirrja Islame për zgjedhjen e shokut të jetës është tejet transparente dhe e qartë.

Muhamedi a.s. thotë: “Gruaja martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për pozitën e saj shoqërore, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj, zgjidhe at për nga ana fetare se përndryshe u varfërovet”. (Buhariu dhe Muslimi)

Kërkesa, që del nga kjo thënie e Muhamedit a.s. drejtuar të pamartuarve është kjo: zgjedhja e shokut të jetës duhet bërë në mënyrë precize, pasi që martesë është strofull ku kalon pjesa e mbetur e jetës.

Me këtë zgjedhje njeriu vetes i mundëson dy mënyra të zhvil-

limit të jetës:

a-Martesë e cila mbushë zemrat e tyre ma dashuri dhe lumturi dhe kështu lulëzon shtëpia e tyre, hijeshohet me dashuri dhe lumturi;

b-Martesë e cila shkatërron zemrat tyre me mjerim dhe kështu shkatërron shtëpinë e tyre;

Pikërisht shkurorëzimet e shumta që ndodhin në një shoqëri, sipas sondazheve që bëhen për të njohur shkaqet e shkurorëzimeve, mendimet dhe qëndrimet janë rrjedhim i zgjedhjes jo të mirë dhe të padrejtë, të shokut të jetës.

Thirrja Islame, që u bë në hadithin e larttheksuar: “Zgjidhe atë për nga ana fetare”,

dhe sekundarizimi i faktorit të bukurisë në përzgjedhjen e bashkëshortit ose bashkëshortes, ose i statusit shoqëror apo i pasurisë, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se Islami është kundër bukurisë, pasurisë apo komoditetit jetësorë, apo të statusit të mirë shoqërorë. Krejt ndryshe nga se mund të mendohet, zbukurimi dhe stolia janë prej vetive fizike dhe morale të një gruaje, të cilën e dallojnë nga një burrë. Synimi, pika në të cilën përpiket dhe kërkon Muahmedi a.s. që ne të arrimë, me këtë thënie është: Që besimtarë nuk duhet të veprojnë dhe tregojë qëndrim të guximshëm dhe të jepet vetëm pas bukurisë dhe pasurisë në llogari të anës fetare.

Ashtu siç ka të drejtë në zgjidhje të bashkëshortes një burrë, Islami të njëjtën ia mundëson dhe femrës. Madje përzgjedhja sipas kriterëve dhe parimeve Islame dhe pëlqimi i saj janë vendimtarë në kurorëzim.

Ngjarja në mes dy të dërguarve të Allahut xh.sh., Musait a.s. dhe Shuajbit a.s. me rastin e martesës së Musait a.s. me të bijën e Shuajbit a.s., e bënë më të qartë dhe ma të dukshme mënyrën dhe qasjen e të hyrit në jetën bashkëshortore. Ngjarja në vete përmban njohuritë e nevojshme për të zotëruar një mjeshtëri për të arritur sukses në jetën bashkëshortore. E gjithë ndodhia filloi atëherë, kur Musai a.s. u takua me të bijat e Shuajbit a.s., kur të bijat e Shuajbit a.s. ishin në detyrën e tyre të përditshme, për të mbartur ujë nga vendi i quajtur bunar më afër vendit ku i mbante delet Shuajbi a.s.

Musai a.s. takoi vajzat dhe pa se ena e madhe dhe e thellë e mbushur me ujë, është e rëndë për ta bartë fuqia e një vajze, Musai a.s. u vajzave se do të ishte më mirë që ai ta bartë këtë enë, se fuqia e tij premtonte një gjë të tillë. Vajzat pranuan.

Një natë Shuajbi a.s. ftoi Musain a.s. në darkë. Një prap vajzave të Shuajbit a.s. i’u afrua

në vesh babait dhe i tha: Unë kamë pëlqyer Musain për bashkëshortë të jetës.

Shuajbi a.s. i qetë dhe i sigurt, doli në dhomën tjetër për të biseduar me të bijën dhe e pyeti: Në bazë të të cilit parim dhe norme je përcaktuar o bija ime që zgjodhe Musain për bashkëshort?

Vajza me gjuhë të sigurt dhe të qetë iu përgjigj babait: Musai kishte cilësi të burrit të sinqertë, ndershëm dhe punëtorë. E hetova se ishte i sinqertë dhe i ndershëm, sepse sa herë që e takonim në rrugë sillej në mënyrë korrekte. Ndërsa, sa u përket aftësive të tij fizike, dhe se është punëtor, flet fakti se enën e mbushur me ujë, për ta sjellë te delet nga bunari, është aq e madhe saqë për ta bartur nevojiten shumë burra, kurse Musai e solli vetë.

Kështu, vajza e Shuajbit a.s. morri bekimin e babait për martesën me Musain a.s., pasi që pa se vajza kishte parime të sigurta për zgjedhjen e bashkëshortit, parime që garantojnë një lumturi të një baze që quhet martesë.

Vetitë e burrit ideal për një vajzë që është në moshën e pjekurisë dhe që përmbush konditat e martesës janë po ato të cilat përmenden në Kur'an, me rastin e martesës së Musait a.s. me të bijën e Shuajbit a.s.

Feja, sinqeriteti, ndershmëria dhe aftësitë e tij fizike për punë të krahut, për të mbijetuar me mall të hallallit, për t'i ushqyer bashkëshorten dhe gjenezën, janë norma dhe parimet kryesore në momentin, kur një vajzë zgjedh bashkëshortin.

Vetia e sinqeritetit është kundrejt hipokrizisë, e cila është bazë për të prishur marrëdhëniet e mira bashkëshortore dhe familjare. Ndershmëria është një moral i shëndoshë i një individi që sillet dhe punon me nder, ndërsa drejtësia dhe ndërgjegjja janë pikësnyim i njeriut të ndershëm në jetën bashkëshortore dhe familjare. Punëtori, është i dobishëm, duke përdorur forcën e tij të krahut dhe të veglave e bën jetën bashkëshortore më të lumtur dhe përmbushë nevojat esenciale familjare, dhe krijon një komoditet të kësaj jete për bashkëshorten dhe gjenezën e tij.

Kjo është zgjidhja islame, ky është mësimi islam, për të gjithë ata që janë të gatshëm për të hyrë në jetën bashkëshortore.

Kocka delikate-fenomeni i rilindjes

Mr. Sc. Fahrudin Ebibi

"Periudha kohore në mes dy fryrjeve është dyzetë. Dyzetë ditë? Të pranishmit e pyetën transmetuesin por ai nuk u prononcua. Dyzetë muaj, pyetën ata? Ai nuk u prononcua. Dyzetë vite, pyetën ata por ai nuk u prononcua. Allahu do të zbret ujë nga qielli (shi) dhe do të mbijë ashtu siç mbin grosha. Asgjë nuk do të mbetet pa u shkatërruar nga trupi i njeriut me përjashtim të një ashti, ai është një asht delikat (i stërholluar në fund të kryqeve) Ditën e Kiametit nga ai do të strukturohet ose do të formohet (njeriu)." (Hadith)

Në përmbledhjen e vetë imam Muslimi ka regjistruar këtë hadith të transmetuar nga Ebu Hurejreja. Gjithashtu edhe Ebu Davudi e ka regjistruar në përmbledhje të tij një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejreja me këtë përmbajtje por me formë tjetër: "Tokat do ta gëlltis tërë trupin e njeriut (do ta shkatërrojë) me përjashtim të kockës delikate (të stërholluar në fund të kryqeve). Nga ai është krijuar (njeriu) dhe (Ditën e Kiametit) nga ai do të strukturohet (formohet)." (Hadith)

Edhe Imam Ahmedi në Musnedin e tij ka regjistruar

një hadith të këtillë të transmetuar nga Ebu Seidi: "Dheu (toka) do të shkatërrojë çdo gjë nga njeriu (trupi i tij) me përjashtim të kockës delikate (të stërholluar në fund të kryqeve)." Të pranishmit duke kërkuar shembull nga Pejgamberi alejhi-s-selam, thanë, si është ai? "Është sikur kokrra e hardallit, nga e cila mbini, u përgjigj Pejgamberi alejhi-s-selam."

SHKENCA DHE FEJA RRETH KRIJIMIT TË NJERIUT

Ekspert e embrionologjisë në Anglia kanë konfirmuar, përkatësisht, kanë vërtetuar se fetusi zhvillohet nga një kordele e stërholluar e ashtuquajtur kordele e parë. Kjo kordele krijohet në ditën e pesëmbëdhjetë prej ditës kur arrihet pllenimi i vezores dhe mbjella e saj brenda mureve të mitrës. Si rezultat i paraqitjes së kësaj kordele filon krijimi i sistemit nervor dhe fillet e para të krijimit të shtyllës kurrizore, më pastaj krijohen pjesët e tjera të trupit. Mos krijimi i saj shkakton mos fillimin e krijimit të pjesëve të tjera të trupit. Grimcat e para delikate të fetusit nuk transferohen në periudhën e krijimit të mëtejme të pjesëve të tjera të

“

“Ekspert e embrionologjisë në Anglia kanë konfirmuar, përkatësisht, kanë vërtetuar se fetusi zhvillohet nga një kordele e stërholluar e ashtuquajtur kordele e parë. Kjo kordele krijohet në ditën e pesëmbëdhjetë prej ditës kur arrihet pllenimi i vezores dhe mbjella e saj brenda mureve të mitrës...”

organizmit, përfshirë këtu edhe sistemin nervor.

Rëndësia dhe vlera e kësaj kordele nxiti shkencëtarët, respektivisht, specialistët e fushës së pllenimit (pjalimit) dhe të embrionologjisë, të vënë



ose të caktojnë një interval shumë delikat kohor që do t'ju kishte mundësuar mjekëve dhe studiuesve, të bëjnë eksperimente dhe prova në këtë periudhë të hershme të pazënë të fetusit, në pllenimin e tij artificial në epruvetë. Konstatimi i këtij ekipi ekspertësh qëndron në atë se eksperimentimi në fetus lejohet deri atëherë kur nuk është paraqitur kordelja e parë. Me paraqitjen e saj ndalohet rreptësisht çdo lloj eksperimentimi ngase në këtë periudhë kohore startojnë fillet e para të krijimit të sistemit nervor. Pasi të kishte mbaruar misionin e vetë kjo kordele, në javën e katër, fillon gradualisht të zhduket përveç një pjesë e saj tejet e stërholluar, në fund të shtyllës kurrizore që nuk mund të vërehet me syrin e thjeshtë mbetet dhe, assesi ajo nuk zhduket as nuk humbet.


Një ekip i mjekëve nga Kina provuan asgjësimin ose flakjen e tërësishme të asaj kordeleje gjatë eksperimenteve të bëra. Tentuan përmes rrezatimeve të ndryshme, përdorën acide nga më të fuqishmet, u munduan të djegin me flakë por asnjë herë nuk arritën shkatërrimin ose likuidimin e tërësishëm të saj nga ai vend.

SHKENCA VËRTETON POHIMET E MUHAMMEDIT A.S

Kjo pjesë e çuditshme në trupin e njeriut është ai ashti delikat për të cilin ka folur Pejgamberi sal-lallahu alejhi vesel-lem në shumë hadithe të tij para 1400 vjetëve. Me këtë e ka bërë të qartë se nga ajo pjesë delikate dhe tejet e stërholluar njeriu është krijuar dhe ajo nuk do të shkatërrohet as pas vdekjes dhe tretjes së trupit të njeriut. Nga ajo koskë siç vërteton Muhamedi alejhi-s-elam do të lind njeriu së dyti atëherë kur Allahu do t'i ringjallë njerëzit për të dhënë llogari dhe marrjen e shpërblimeve. Atëherë kur Allahu do të zbret ujë (shi) nga qielli dhe çdonjëri do të mbijë nga ajo pjesë e patretur, përkatësisht, nga ajo kockë delikate, ashtu siç mbinë bima nga fara e vetë. Përmes këtyre haditheve Pejgamberi alejhi-s-selam vë në pah këtë të vërtetë shkencore, e cila arriti të zbulohet viteve të fundit nga ekspertët e embrionologjisë, zbulohet fenomeni shumë i çuditshëm në organizmin e njeriut, i cili do të shërbej si dëshmi e gjallë për ata që mohojnë fenë dhe pejgamberllëkun e Muhamedit alejhi-s-selam.

Pa mëdyshje ky zbulim ka vërtetuar pejgamberllëkun e tij dhe thërret logjikën e shëndoshë të shqyrtoj qëndrimin ndaj Pejgamberit alejhi-s-selam dhe ndaj asaj që ai e ka komunikuar. Për të vërtetuar se ai Muhamedi alejhi-s-selam asgjë nuk ka folur nga hamendja por në bazë të asaj që iu është komunikuar nga Krijuesi i Gjithësisë. "Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" (Kur'an: 41:53.)

NGA SURET E KURANIT



Shejh Mehmed Hanxhiç

"Sikur të gjithë njerëzit tjerë në këtë botë kalimtare, ashtu janë të përzier edhe myslimanët e vërtetë dhe ata të cilët vetëm mbajnë emra myslimanësh, kurse me Islamin nuk kanë po thuaj se asgjë të përbashkët. Islami nuk është vetëm çështje deklarimi. Në Islam kërkohet besim i fortë dhe i paluhatshtëm, në përputhje me atë çka është përcaktuar në Kur'anin Fisnik dhe burimet tjera të besimit. Kërkohet të veprohet sipas rregullave të cilat Kur'ani Fisnik dhe Hadithi profetik në detaje i kanë përshkruar. Ai që nuk merr pjesë në këto dy shtylla kryesore islame, ai edhe nuk ka Islam, pa çka se ai mban emër myslimani dhe me emrin e tij, bën vetëm rritjen e numrit të myslimanëve në statistikat e feve botërore..."

(Shejh Mehmed Hanxhiç)

Në këtë sure, e cila mban emrin **El-Gashije**, janë të përmbledhura pikat

më kryesore të besimit islam. Në këtë sure Allahu i Madhërishtëm i flet Muhammedit s.a.v.s. dhe thotë:

"Hel et?ke hadithul-g?shijeti - A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kijametin)?"

Kjo do të thotë: A e din se çka në të vërtetë do të ndodhë në atë Ditë të tmerrshme? Rrënja e fjalës **el-g?shijetu** në gjuhën arabe ka kuptimin: **të mbulosh, të përfshish**. Allahu i Madhërishtëm me këtë emër e ka quajtur Ditën e Gjykimit, ngase atë Ditë njerëzit do të mbulohen dhe do të përfshihen me mundime të mëdha - mundime të dhënies së llogarisë edhe për gjënë më të imët të bërë në këtë botë, mundimeve dhe vështirësive të pritjes - se a thua vallë si do të zgjidhet ardhmëria e amshueshme e çdo individi...

Me një pyetje të këtille dëshirohet të madhësohet Dita e Gjykimit, t'i tërhiqet vëmendja çdo kujt i cili e dëgjon këtë sure, ta nxitë që me vëmendje ta dëgjojë përmbajtjen e kësaj sureje dhe të përfitojë nga kjo.

Në këtë botë të gjithë njerëzit jetojnë



Nën rrezet e sures el-GASHIJE

bashkë si pjesëtarë të një bashkësie njerëzore. Jeton besimtar pranë jobesimtarit. Jeton ai që morali i tij është shembull pranë atij që mund të shërbejë si shembull i mishërimit të amoralitetit. Jeton ai që është i dashur dhe e don Allahu i Madhërishëm, pranë atij që Allahu e urren. Jetojnë bashkë edhe miqtë e Allahut edhe armiqtë e Tij. Në botën tjetër të amshueshme nuk është më kështu. Atje do të ndahet arri nga bakri dhe i lumturi nga jofatlumi.

Do të ndahen në dy grupe, siç thotë Allahu i Madhërishëm:

“Ferîkun fil-xhenneti ve ferîkun fis-se’îr - Një grup do të jetë në Xhennet (Parajsë), ndërsa grupi tjetër në Xhehennem (Ferr).”

Sikur të gjithë njerëzit tjerë në këtë botë kalimtare, ashtu janë të përzier edhe myslimanët e vërtetë dhe ata të cilët vetëm mbajnë emra myslimanësh, kurse me Islamin nuk kanë po thuj se asgjë të për-

bashkët. Islami nuk është vetëm çështje deklarimi. Në Islam kërkohet besim i fortë dhe i paluhatsëm, në përputhje me atë çka është përcaktuar në Kur’anin Fisnik dhe burimet tjera të besimit. Kërkohet të veprohet sipas rregullave të cilat Kur’ani Fisnik dhe Hadithi profetik në detaje i kanë përshkruar. Ai që nuk merr pjesë në këto dy shtylla kryesore islame, ai edhe nuk ka Islam, pa çka se ai mban emër mysliman dhe me emrin e tij, bën vetëm rritjen e numrit të myslimanëve në statistikat e feve botërore. Në Ditën e Gjykimit do ndahen dhe veçohen myslimanët e rrejshëm të cilët mbajnë emrin mynafik nga myslimanët e vërtetë dhe të sinqertë, siç thotë Allahu i Madhërishëm në një verset kur’anor: **“Ndahuni sot, o ju keqbërës!”**

Në këtë sure përshkruhet gjendja e fatlumëve dhe fatkeqve, ndaj për fatkeqët, ata që nuk i kanë përmbushur kërkesat e fesë së vërtetë të Zotit, Allahu thotë:

“Atë ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish, që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë). Ata do të digjen në Zjarr të nxehtë e do të pinë nga burime të valuara. Për

ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese, të cilat as nuk do t’i mbajnë, as nuk do t’ua shuajnë urinë.”

Nga fjalët **“që kanë punuar e janë rraskapitur”** këtu mendohet dhe u tërhiqet vërejtja atyre që nga puna e stërngarkuar veç më janë lodhur, po ç’e do që kjo punë dhe përpjekje e tyre fare nuk iu ndihmon, ngase nuk i është përgjigjur kërkesave dhe rregullave të fesë së shpallur nga Allahu i Madhërishëm.

Në këto ajete Kur’ani Fisnik përshkruan vuajtje të ndryshme që jobesimtarët do t’i përjetojnë, përgjithnjë do t’iu ekspozohen dhe tërë amshueshmërinë e tyre do ta kalojnë në këto vuajtje e mynxyra. Zjarri i nxehtë shkakton etje, e cila assesi nuk mund të durohet. Duke qenë në këtë gjendje, kërkojnë ujë dhe u sillet uji, por ç’e do kur uji është i valuar, i cili akoma edhe më shumë ua shton vuajtjet dhe mundimet, ndërsa aspak nuk ua shuan etjen. Për këtë ujë në një ajet thuhet:

“Nëse tentohet që t’iu ndihmohet, do t’iu ndihmohet në atë mënyrë që do t’iu jepet uji i cili është i valuar si hekuri dhe që djeg fytyrat sa po t’i afrohesh. E hidhur është kjo pije, por edhe Zjarri është

një nxehtësi dhe vuajtje e papërshtuar.”

Në një tjetër ajet kur’anor, Allahu i Madhërishëm thotë:

“Do të pinë nga uji i valuar i cili do t’ua djeg barket.”

Sa i përket ushqimit të fatkeqit, i cili do të bie në Zjarr (Xhehennem), ai ushqim ka për të qenë i atillë që as organizmit i sjell dobi, e as që e largon urinë. Ky është ushqim i ngjashëm me ferrat shpuese, që të mbeten në fyt, por të mos harrojmë se nuk është si ferrat e kësaj bote, por akoma më i keq dhe më i tmerrshëm.

Këtu, siç vërejmë në mënyrë figurative janë treguar vetëm disa përjetime, që i kanë merituar jobesimtarët, të cilët tërë jetën e tyre e kanë kaluar në mosbesim, duke i thyer urdhrat e Allahut të Madhërishëm, dhe të cilët kanë vdekur me po të njëjtin qëllim: që të vazhdonin të jetonin ashtu siç kanë jetuar edhe sikur të jetonin pambarim. Së këndejmi, sipas qëllimit të tyre - janë dënuar me dënim të përjetshëm, gjegjësisht të përherëshëm.

Më pas Allahu i Madhërishëm e përshkruan gjendjen e besimtarëve dhe myslimanëve të vërtetë, dhe thotë:

“Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara,

të kënaqura për punët e bëra. Ata do të jenë në Kopshtin e Lartë, në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe. Atje ka një burim rrjedhës uji dhe divane të ngritura, ka kupa të vëna (për t'u mbajtur në dorë) dhe jastëkë të renditur, si dhe shumë qilima të shtruar.”

Në këto ajete të mësipërme, në mënyrë figurative është përshkruar mirëqenia dhe kënaqësitë, të cilat i presin besimtarët e drejtë dhe njerëzit fatlumë.

Shpesh dëgjojmë që armiqtë e Islamit, të cilët dëshirojnë si e si ta dëmtojnë Islamin, të thonë se Islami u premtonte ithtarëve të vet në botën tjetër vetëm kënaqësi trupore dhe fare nuk i njehe kënaqësitë shpirtërore. Vëllezër, kjo nuk është asgjë, pos një gënjeshtër e kulluar, e cila ka ardhur si pasojë e gjykimit armiqësor dhe joobjektiv. Ç'do njeri i mençur, nëse do t'i kthehej logjikës së tij të shëndoshë, do arrijë në përfundim se nuk ka kënaqësi trupore, pa mos pasur kënaqësi shpirtërore, ashtu siç është edhe e kundërta: nuk mund të ketë as kënaqësi shpirtërore, pa mos pasur edhe kënaqësi trupore.

Kënaqësia shpirtërore dhe ajo trupore janë të lidhura aq ngushtë, saqë vështirë se mund të ekzistojnë njëra pa tjetrën. Ndaj, kushdo që i qaset me më vëmendje dhe e shqyrton më thellë këtë çështje, nuk do t'ia mvësh një gjë të tillë Islamit, përkatësisht nuk do ta mohojë atë që ai ua premtonte ithtarëve të vet: kënaqësinë shpirtërore. Gjithashtu, duhet ta dimë dhe atë që Islami i jep prioritet kënaqësisë shpirtërore. Në Kur'anin Fisnik thuhet:

“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve xhennete (kopshte) nën të cilët rrjedhin lumenjë dhe ku do qëndrojnë përgjithnjë, dhe pallate të bukura në xhennetet e përherëshme, ndërsa kënaqësia nga Allahu është akoma më e madhe se të gjitha këto.”

Pra, kënaqësia shpirtërore, do të thotë që besimtarët të jenë nën kënaqësinë e Allahut,

konsiderohet më e madhe dhe nënkupton edhe kënaqësinë trupore.

Por nga ana tjetër, dënimi i caktuar nga Allahu i Madhërishëm për jobesimtarët të mos konsiderohet dhunë dhe zullum, Allahu njeriut i ka dhënë mendjen dhe intelektin dhe përreth tij ka ofruar me mijëra argumente dhe mijëra shembuj nga ku do të arrihej gjer tek përfundimi se ekziston Një Zot, i Cili e ka krijuar këtë botë dhe është i denjë që T'i robërohet dhe T'i bëhet adhurim. Për këto argumente tregon Vetë Allahu i Madhërishëm në këtë sure kur thotë:

“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po Tokën, se si është shtrirë?!”

Pra, Allahu i Madhërishëm thotë që në krijimin e devesë, qiellin e ngritur, ndërtimin e maleve të patundura dhe tokën e shtrirë - ka mijëra argumente që flasin se ekziston Një Krijues, Zoti i gjithçkaje.

Le të marrim si shembull vetëm devenë dhe le të vëzhgojmë me kujdes: Zoti i ka dhënë asaj këmbë me të cilat me shpejtësi ecën nëpër shkretëtirat e mëdha ku jeton. Që të mund nga toka të merr ushqim, Zoti e ka pajisur me qafë të gjatë. Vetëm shputat e saj janë të përshtatshme për ecje nëpër shkretëtirë, ku këmbët zhyten. Allahu e ka krijuar të atillë që të duroj etjen duke ecur nëpër shkretëtirë ku nuk ka ujë. Deveja kur një herë pinë ujë, ajo mund të qëndrojë tërë javën pa pirë fare ujë, ngase një rezervuar i vendosur në barkun e saj kursen ujë dhe e lëshon atë sipas nevojës, aq sa i nevojitet për të kryer funksionin e saj normalisht. Shpinën e saj e ka pajisur me një apo dy gunga të mbushura, të cilat në rast të mungesës së ushqimit të lëshojnë kalori në organizmin e saj dhe kështu, e mbajnë normalisht funksionimin e organizmit të saj. Allahu devenë e ka krijuar për shkretëtirën e shkretë, ndaj dhe tërë organizmin e saj e ka krijuar në përputhje me këto rrethana, prandaj dhe me të drejtë e quajnë **barka e shkretëtirës.**

Pra, gjithçka është e krijuar në bazë të urtësisë së përkryer dhe konform asaj se për çka është e destinuar. Lind pyetja: A thua tërë këtë e ka krijuar natyra e marrë? Apo ashtu janë krijuar nga vetvetja? Jo, mos e dhashtë Zoti, jo, assesi. Por tërë këtë në mënyrën më të bukur e më të përkryer e ka krijuar Krijuesi i Urtë. Pra, ekziston një Qenie e Urtë dhe Ky është Allahu i Dashur, Krijuesi i gjithçkaje.

Le t'i hedhim një shikim qiellit, do të shohim se si aty qëndrojnë dhe lëvizin me mijëra trupa qiellorë, të cilat me një orar preciz dhe mënyrë të përkryer lëvizin, ecin... Gjithashtu, nëse vrojtojmë malet dhe tokën në të cilën jetojmë, do të shohim një rend dhe përputhje të shkëlqyer ku asgjë nuk bie ndesh me njëra-tjetrën... Padyshim, që gjithë kjo na shpie tek Krijuesi Absolut, Allahu i Madhërishëm. Çdo gjë përreth nesh flet qartë: Ekziston Zoti dhe Atij jemi të obliguar t'i falemi dhe t'i bëjmë adhurim.

Përveç kësaj, Allahu i Madhërishëm nuk mjaftohet vetëm me këto argumente që u përmendën, por shkon edhe më tej, ashtu siç thotë Kur'ani Fisnik:

“Ne asnjë popull nuk kemi për të dënuar, përderisa nuk iu dërgojmë të dërguar (profetë).”

Përveç argumenteve të sipërpërmendur, Allahu nga Mëshira e Tij e pakufishme u ka dërguar njerëzve profetë, të cilët në mënyrën më të bukur botës t'ia sqarojnë të drejtën e vërtetë dhe të tregojnë se Zoti ekziston dhe vetëm Ai është i denjë që t'i robërohet dhe t'i bëhet adhurim. Ndaj, nisur nga kjo, Allahu i Madhërishëm në këtë sure duke e urdhëruar të dërguarin e Tij të fundit Muhamedin s.a.v.s. thotë:

“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë! Sa për ata që shmangen dhe nuk besojnë, Allahu do t'i ndëshkojë me dënimin më të madh. Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!”

Në këto ajete është shp-

jeguar detyra e Pejgamberit s.a.v.s., e kjo është që në mënyrën më të bukur të thërras për tek Zoti dhe t'i sqarojë argumentet, po jo edhe që njerëzit t'i detyrojë me dhunë të besojnë, ngase askush me asgjë nuk mund të detyrohet që të besojë. Kjo, padyshim është edhe detyrë e njerëzve të ditur, sepse ata janë trashëgimtarë të profetëve të Zotit. Ata duhet që të argumentojnë dhe sqarojnë, po jo edhe nëpërmjet dhunës t'i detyrojnë njerëzit të besojnë dhe të pranojnë fenë.

Islami ka qëndrim plotësisht të qartë në lidhje me këtë pikë dhe, pikërisht kjo është një nga karakteristikat më kryesore të tij. Allahu është Ai që do të dënoj për mosbesimin, ngase Atij të gjithë do t'i kthehen në Ditën e Gjykimit dhe para Tij kanë për të dhënë llogari.

Në këtë sure janë vënë në pah tri pika kryesore të besimit islam:

- 1. Besimi në Zotin në bazë të argumenteve;**
- 2. Besimi në Ditën e Gjykimit; dhe;**
- 3. Besimi në të dërguarit (profetët) e Zotit.**

Këto janë tri nga pikat më kryesore të besimit islam, ndërsa për të tjerat mund të themi se janë dytësore, ngase kush beson të dërguarit (profetët) e Zotit, ai ka për t'i besuar edhe librat e Tij, engjëjt e Tij, kadanë dhe kaderin dhe tërë çështjet tjera që një mysliman duhet t'i besojë.

Pikat më kryesore të besimit islam janë tërësisht të qarta dhe plotësisht të kuptueshme për intelektin e shëndoshë. Të tilla janë edhe pikët tjera të besimit islam. Në Islam nuk ka fshehtësi për të cilat nuk duhet dhe është e ndaluar që të diskutohet, përkundrazi. Pikërisht kjo është cilësia më e veçantë e Islamit, e cila i hap rrugën për një të ardhme më të ndritur.

Falënderimi i qoftë Allahut, që na ka bërë të jemi pjesëtarë të fesë së lartësuar dhe të qartë - Islamit!

Marrë nga: **IZABRANA DJELA MEHMEDA HAND I?A, ISLAMSKA TEMA**, knjiga III, **Mehmed Hand i?**, Izdava?: Ogledalo, Sarajevo, 1999 god. **Nga boshnjakishtja: Ahmed R. Ramadani**

Veglat muzikore në Islam dhe ndikimi i tyre në muzikën perendimore

Mr. Abas Jahja

Islami posedon një thesar shumë të madh kulturo-artistik, dhe nuk ka dyshim se me zgjerimin e kufive Islam dhe me kalimin e muslimanëve në Spanjë ata patën ndikim të madh në përgjithësi në tërë Evropën si në aspektin shkencor, kulturor dhe artistik.

Ne në këtë shkrim do të ndalemi në aspektin e artit muzikor dhe instrumenteve muzikore.

Evropa e ka dhuratë nga muslimanët edhe origjinën e shumë instrumenteve muzikore, ky ndikim fillon nga shekulli i IX.

Ne edhe sot kur i analizojmë emrat e instrumenteve muzikore perendimore mund ti zbërthejmë lehtë dhe origjinën e tyre e gjejmë në fjalët me prejardhje Arabe, kështu p.sh fjala “Al-ud” është marë nga gjuha Arabe dhe është adaptuar po thuaj se në të gjitha gjuhët evropiane si; në Spanjisht Laud, në Portugalisht Alaude, në Suedisht Lute, në Anglisht Lute, në Frangjisht Luth, në Italisht Luito, në Gjermanisht Laute, në Danisht Lut, në Rusisht Llutnja, në Polonisht Lutina dhe në gjuhën Shqipe Lahuta.

Ky instrument ka një zë shumë mahnitës dhe me kalimin e tij në Spanjë u popullarizua në tërë Evropën. Ekzistojnë disa mendime se këtë Instrument e ka çpikur filozofi i madh Musliman Farabiu, por faktet historike tregojnë se Udi ka ekzistuar edhe para Farabiu dhe lirisht mund të themi se ai ka bërë disa ndryshime në këtë instrument dhe ka bërë ripërtrirje të instrumentit, sepse në shkrimet tona të më hershme

kemi cekur se ai ishte njohës i mirë i teorisë së muzikës, por edhe i binte Udit në nivel të një virtiozi, poashtu ai ishte edhe virtioz i Kanunit.

KANUNI DHE PIANOJA

Kanuni është një instrument që përbëhet nga 78 tela. Në disa raste numri i telave mund të ndryshoj sipas vetë llojit të Kanunit, d.m.th. mvaret nga madhësia e tij, mu për këtë disa janë më nga 72 t e l a . Fjala Kanun don të thotë ligj, këtu bëhet fjalë për ligjin e instrumenteve, sepse është marrë si bazë e të gjitha instrumenteve.

Pijanoja e Evropës ka marë modelin ose shembullin nga Kanuni, dallimi qëndron në atë se te Pianoja telave iu bihet nëpërmjet fushave.

Duhet potencuar se në këtë periudhë muzikantët evropian shkonin nëpër qytetet kryesore Arabe ku në institutet dhe universitetet e tyre mësonin shkencën dhe artin. Në mesin e këtyre arteve muzika ishte në rend të parë. U përkthyen veprat e El-Kindiut, Farabiu, Ihvanu es Safa, Ibni Sinas dhe hollësisht u studiua vepra e Safijjuddin Urmeviut.

Përveç instrumenteve nga ana e evropianëve janë marë edhe terme të veçanta muzikore. Sipas disa muzikologëve fjala “Trubadur” vjen nga gjuha Arabe “Dur Tarb” që do të thotë shtëpia e argëtimit.

Padyshim se duhet të përmendim edhe instrumentin e mirënjohur Kitarën e cila vjen nga fjala Arabe “el-Kajtara”, pastaj El-Daff-adufe (def ose daire), Al-Sumug-Sonajas (cimbali), Al-Nafir-anafil (trompetë e vjetër), Al-Karn-



“Ekziston një instrument tjetër Arab i njohur me emrin “Rebab”, të cilin më vonë Françezët e quajtën Rubella, kurse Italianët Rubeca. Ky instrument me kalimin e kohës pësoi disa ndryshime të vogla dhe në shekullin e XV merr emrin Viola.”

corn (bri).

Ekziston një instrument tjetër Arab i njohur me emrin “Rebab”, të cilin më vonë Françezët e quajtën Rubella, kurse Italianët Rubeca. Ky instrument me kalimin e kohës pësoi disa ndryshime të vogla dhe në shekullin e XV merr emrin Viola.

INSTRUMENTI MISTIK- NAJI

Një ndër instrumentet më të rëndësishme, posaçërisht në muzikën fetare është Naji, vjen nga gjuha Persiane dhe është instrument frymorë dhe është i përhapur në të gjitha vendet Islame, prodhohet nga kallami. Duhet të theksojmë se stili dhe mënyra e fryerjes dallon në mesin e popujve musliman. Mënyra e fryerjes tek Iranianët është se tek ata Naji vëndohet midis dhembëve e jo në buzën e ekzekutuesit, kjo mënyrë e përdorimit i jep tingullit një



veçori dalluese.

Po të njejtit instrument Arabët i fryjnë me buzë. Poashtu ekziston dallim edhe në mes Arabëve dhe Turqive. Turqit në pjesën e sipërme vëndojnë edhe një pjesë tjetër përbërëse që në mënyrë të veçantë i ndërtojnë nga briri i kaut. Kjo pjesë bënë që nga Naji të dalin tinguj më të thellë dhe më shpirtërorë. Lidhur me najin ne këtu i thamë disa fjalë të shkurtëra por mendoj se për najin duhet të flasim më gjërësisht, prandaj në shkrimet që do të vijojnë do të kemi një qasje më të gjërë lidhur me këtë instrument duke pasur parasysh historikun dhe simbolizimin e këtij instrumenti shumë të vjetër.

Kur përmendëm më lartë Rebabin, duhet të theksojmë se edhe ky instrument u përdor nga Persianët, Arabët dhe Turqit dhe është një instrument që ekzistonte edhe para ardhjes së Islamit.

Kjo vegël muzikore vazhdon që të përdoret edhe gjatë shekujve pas Islamit dhe pati ndikim të madh edhe në Evropë. Me kohë forma e saj në perëndim pësoi ndryshime dhe prej saj lindën instrumentet si: Viola, Violoni, Violonçeli dhe Kontrabasi.

Mund të themi lirisht se arti muzikorë Islam është një thesar i pafund dhe i pashterur si në aspektin e veglave muzikore po ashtu edhe në aspektin e terorisë së muzikës.

Gjatë historisë kemi pasur ekzekutues të famshëm të instrumenteve të ndryshme muzikore, si solistë të famshëm dhe teoricientë të mëdhenjë. Këto personalitete kanë lënë gjurmë të thella dhe ndikim të madh në artin e muzikës së perëndimit.

Në fund mund të themi se muzika është pasqyra e një populli ose me fjalë tjera tregon shkallën dhe lartësinë e nivelit të ngritjes së një populli. Nëse dëshirojmë të vlerësojmë se sa është i ngritur një popull duhet të shikojmë nivelin dhe kualitetin e muzikës së atij populli. Filozofi i madh Kinez Konfuçio thotë: "Nëse është prishur muzika e një populli, mund të konkludojmë se tek ai popull janë prishur edhe shumë vlera të tjera njerëzore".

Atributet e Kuranit fisnik

“*Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që ti studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.*” (Sad-29).

Rexhep Ziberi

Kurani famëlartë është burimi kryesor i Islamit, mu për këtë çdo besimtar është i obliguar që sa më mirë të njihet më të dhe më mësimet që burojnë nga Ai.

Në botë për Kurandin famëlartë është shkruar, debatuar dhe ligjeruar shumë, me sa duket asnjë vepër fetare Islame nuk është shkruar e të mos potencohet në secilën vepër Kurani i shenjtë ose ndonjë fjali e Kuranit famëlartë. Për Kurandin famëlartë do të shkruhet dhe ligjerohet edhe në të ardhmen, por fjalitë e tij nuk do të pakësohen asnjëherë.

Në Islam autoriteti i fjalive Kuranore është i pakonkurrencë, sepse Ai ka një kuptim shumë më të gjërë e më të madh për vetë jetën e besimtarit se sa ai mund ta kupton.

KITAB- LIBËR

Parasegjithash vetë Kurani famëlartë zbulon kuptimin e tij në vetë emrat që Ai bartë: “**..Ai është libër që nuk ka dyshim në të..**” (Bekare-2)

Kurani famëlartë është Libri i librave, ai është mbi çdo libër Ai nuk ka nevoj për asnjë libër tjetër ndërsa çdo libër tjetër ka nevoj për të. Libri i Allahut ka ekzistuar edhe para se të shkruhet në faqe madje edhe para se të regjistrohet në burimin e tij në Leuhi Mahfudh. “**Përkundrazi, (ata që gënjejnë), ai është Kuran i famshëm. Në një pllakë të ruajtur mirë** (Leuhi Mahfudh). (Buruxh -21-22)

Çdo libër i shkruar (me plot kuptimin e fjalës libër) në natyrën e vetë prezentuese ose ka kuptim të bukur dhe arsimues, ose zbulon parafytyrime dhe mësim të reja, ose paraqet norma dhe rregulla të fuqishme juridike për jetën, individin, natyrën, shoqërinë ose shtetin, ose zbardhë rrugët e realitetit dhe orientimit të drejtë, ose zgjon kurreshtje ndaj gjërave shpirtërore, ose paraqet të kaluarën si mësim për ardhmërinë, ose paraqet fjalë të zbukuruar dhe të rradhitura në stilin më të përkryer gjuhësor etj.

Karakteristikë e Librit të Allahut është se përmbledh të gjitha llojet e kualiteteve dhe kuptimeve të librave që potenciam më lartë, po gjithësesi edhe të atyre mësimëve dhe kup-

timeve që logjika e njeriut ende nuk ka arritur ti zbulon dhe ti kupton!

Ai është libër i përkryer dhe i gjithanshëm, i kompletuar pa asnjë mangësi, gjithsejtë i përmbledhur në 381121 shkronja, 73412 fjalë, 6219 fjali, 114 kaptina.

Ai nuk la asnjë send pa prekur në brendinë e thellë të tij, ai është i zbritur si sqarim për çdo gjë. “**Shpallja e librit (kuranit) nuk ka dyshim se është shpallje nga Zoti i gjithësisë.**” (Sexhde-2).

Qëllimi kryesorë i këtij Libri është që njeriun logjikisht dhe fizikisht ta tërheq nga ajo që tërësisht jetën e tij ta përputhë me natyrën e tërësishtme si vepër të Allahut f.p.

Në këtë kuptim Libri i Allahut hap horizontet dhe e shpëton trurin nga imagjinatat e kota duke ia bërë me dije se ky Libër është nga Allahu i lartëmadhërishtëm dhe i gjithëditur. Faktikisht vetë faktet e qiellit, tokës dhe të vetë qenies së njeriut vetëvetiu flasin për besimtarët se ky Libër është vepër e Krijuesit absolut.

Ky Libër do të shfrytëzohet drejtë dhe do të arrihet qëllimi vetëm atëherë kur do të lexohet studiohet, hulumtohet dhe do të kuptohet. Libri i Allahut të madhërishtëm u dërgua që të mësohet studiohet dhe të jetohet me të. Ky libër nuk zbriti për ti puthur kapakët e tij ose për tu betuar në emrin e tij, por zbriti që ti puthen e përputhen mësimet e tij me jetën tonë të përditshme. Askund në Librin e Allahut f.p nuk regjistrohet që jemi të obliguar ta puthim e të betohemi në këtë libër, por shkruan se jemi të obliguar që ta lexojmë studiojmë, komentojmë dhe të hulumtojmë mbi të. “**Atyre, të cilëve u dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejtë ashtu si është ata e besojnë atë** (Kuranin).” **E ata që e mohojnë atë, të tillët janë ata që dëshatuan** (në dunja e në ahiret). (Bekare-121)

“(Ky është) **Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që ti studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.**” (Sad-29).

TENZIL- ZBRITJE

Tenzil është emër i Kuranit famëlartë që paraqet karakteristikën më të lartë të Kuranit-Burimin e Tij hyjnor. Zbritja e Kuranit famëlartë ndodhi në një

natë të shejtë. **“Ne e zbritëm ate në një natë të bekuar. Ne dëshiroam tu tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm.”** (ED-Duhan-3)

Ajo natë bart emrin nata e kadrit. **“Ne e zbritëm ate në natën e kadrit.”** (Kadr-1)

Nga Kurani famëlartë mësojmë se nata e shejtë e zbritjes së Kuranit gjendej në Ramazan.

“Muaji i ramazanit është ai në të cilin filloi zbritja e Kuranit...” (Bekare-185)

Në këtë natë ndodhi zbritja e tërësishme e Kuranit të shenjtë në qiellin e parë, ndërsa zbritja e tij në tokë për njeriun vazhdoi në mënyrë suksesive për gjatë 23 viteve.

Me zbritjen e Tij në tokë arritën edhe shenjat e para të dritës së Allahut në tokë, ata të vërtetës, diturisë dhe ndërgjegjes humane. Libri i Allahut është burimi kryesor i çdo drite dhe vetë Krijuesi apsolut këtë dritë e ndanë dhe e dhuron sipas dëshirës dhe planit të Tij. Ai që në fillim ndau nga kjo dritë kur e arsimoi dhe mësoi trurin e njeriut duke i mësuar emrat e sendeve elementare që ai nuk dinte.

Të gjithë çështjet shpirtërore dhe morale në çdo kohë dhe vend janë të njëjta dhe me plotë vlera. E vërteta në çdo kohë dhe vend është e vërtetë. Drejtësia në çdo kohë është drejtësi. Humaniteti në çdo kohë është humanitet. Identik është rasti edhe me të gjitha çështjet tjera që mbuloi zbritja e dritës së Allahut fuqplotë. Drita e Allahut është e pandryshuar ashtu siç është i pandryshuar edhe burimi i tij.

III. NUR-DRITË

Kurani famëlartë është dritë e shpirtit, zemrës dhe mendjes njerëzore. Kjo është e potencuar në disa vende në Kuran a njëherit është edhe karakteristikë e vetë emrit Kuranorë.

“Atëherë pra, pranoni Allahun, të dërguarin e tij dhe dritën që e zbritëm Ne. Allahu është i njohur për atë që veproni.” (Tegabun-8)

Besimi në Kuranin famëlartë dhe dashuria ndaj mësimave të tij e hap shpirtin që të pranoni dritën e tij me të

cilën dritë ndriçon rrugët e realitetit. Kurani u dërgua për këtë qëllim. **“Elif, Lamë, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty me urdhërin e zotit t'i nxjerrish njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të fuqplotit, të falënderuarit.”** (Ibrahim-1)

Qëllimi i Kuranit është që të gjitha botrat ti ngjyrosë me këtë dritë të pavdekur dhe të pashterrur.

IV. DHIKR-PËRKUJTIM

Përkujtimi Kuranor çdo herë është në të njëjtën forcë, i rëndësishëm për çdo kohë, sepse ligjet Kuranore nuk njohin ndryshime. Përkujtimi Kuranor, madje është edhe më i fuqishëm se të gjitha kohërat. **“Ne me madhërinë tonë e shpallëm kuranin dhe ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”** (Hixhr-9)

Apeli Kuranor në ndërgjegjen njerëzore gjithmonë është aktual, që padyshim njeriu duhet të jetë në përputhshmëri me parimet dhe principet e tij që janë të pamposhtura,. Përkujtimi Kuranor është gjithpërfshirës.

V. HUDEN-UDHËRËFYES

“..që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë...” (Bekare-185)

Kurani është udhërrëfyesi më i mirë i njeriut në të gjitha poret e jetës së tij.

VI. FURKAN-DALLUES I TË VËRTETËS NGA E PAVËRTETA

“Ai, që ia shpalli Furkanin (Kuranin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhamedit) që të bëhet pejgamber i botës (këshillues), është i madhëruar.” (El-Furkan-1)

Në mënyrë shumë të shkurtuar këto janë disa nga atributet dhe karakteristikat e Librit që është i përkryer në çdo shkronjë të tij, ky është Libri i Allahut fuqplotë, dhe këto janë vlerat tona, ndërsa për vlerat tjera le të flasim të tjerët.



Haxhi kërkim i identitetit shpirtëror

“Qabeja është një gur kristali në udhëkryqin e katër horizonteve; ajo është një kub i thjeshtë, anët e së cilës shikojnë nga katër anët kryesore; ajo është poli i fiksuar dhe zemra e të gjitha lëvizjeve të besimit islam. Haxhinjtë muslimanë mësyjnë drejt saj nga të gjitha anët e botës dhe nga ajo rrezatojnë në rrathë koncentrikë. Ajo është kibla e të gjitha xhamive. Thekët e të gjithë qilimave ku bëhen lutjet dhe shikimet e të gjithë besimtarëve gjatë namazit janë të magnetizuar nga ky pol i jetës spirituale.” (R. Garodi)

Ajni Sinani

Të gjithë muslimanët në zemrat e tyre kultivojnë dashurinë ndaj Mekës dhe ëndërrojnë të vijnë në gjirin e saj mikpritës, Nënës së qyteteve. Ata nga të gjitha skajet e botës ia mësyjnë asaj sepse shkuarja atje është qëllimi, destinimi dhe fundi i të gjitha udhëtimeve. Meka është zemra e universit islam, ngase në qendrën e saj është Qabeja, faltorja e parë e ndërtuar në Tokë në të cilën madhërohet e adhurohet Allahu, Zoti i vetëm dhe i vërtetë:

"Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo në Bekë (Meke), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin." (3:96)

Qabeja me brendinë e saj të zbrazët nga çfarëdo lloj idhujtarie, pa figura, statuja, afreske apo pikturë murale ofron një atmosferë dhe ambient shpirtëror që i mundëson besimtarit të zbrazë zemrën e tij nga çdo gjë tjetër dhe të kujtojë e adhurojë vetëm Zotin, të Padukshmin. Aty nuk dëgjohet asgjë tjetër pos lutjeve të besimtarëve që gumëzhijnë si bletë.

Duke shkuar në Qabe ne kthehemi drejt Zotit. Dëshmimin dhe pranimin që i kanë bërë shpirtit tanë Allahut për Zot me "kalu bela", ne e shprehim dhe man-

“Qabeja është një gur kristali në udhëkryqin e katër horizonteve; ajo është një kub i thjeshtë, anët e së cilës shikojnë nga katër anët kryesore; ajo është poli i fiksuar dhe zemra e të gjitha lëvizjeve të besimit islam. Haxhinjtë muslimanë mësyjnë drejt saj nga të gjitha anët e botës dhe nga ajo rrezatojnë në rrathë koncentrikë. Ajo është kibla e të gjitha xhamive. Thekët e të gjithë qilimave ku bëhen lutjet dhe shikimet e të gjithë besimtarëve gjatë namazit janë të magnetizuar nga ky pol i jetës spirituale.” (R. Garodi)

ifestojmë me forma të ndryshme. Prandaj ardhja në Qabe do të thotë lirim nga prangat që e ngushtojnë shpirtin tonë dhe me këtë i mundësojmë atij që pa pengesë të përkujtojë premtimin/ mithakun e dhënë. Qabeja ka formën e kubit dhe prandaj ajo quhet me emrin Ka'ba, që në gjuhën arabe do të thotë kub. Ajo ka dimensione, të cilat sipas të të kuptuarit Pitagorian të harmonisë, janë reciprokisht në lidhje harmonike.

Qabeja ka domethënie me rëndësi kozmike e madje edhe metakozmike. Ajo mban harmoninë kozmike. Katër qoshet e saj tregojnë për katër drejtimet kryesore të cilat paraqesin katër shtyllat e kozmosit tradicional. Prandaj të jesh aty do të thotë të jesh në qendër.

QABEJA TOKËSORE DHE QIELLORE

Qabeja është qendra e aspiratave dhe dëshirave tona. Të gjitha mihrabet e xhamive të botës janë të drejtuara në drejtim të saj dhe janë të lidhura me një linjë të padukshme me të. Qabeja në tokë gjendet nën Qabenë (Bejtul Ma'mur) që gjendet në qiell, pra ajo qëndron në boshtin i cili bashkon Qiellin dhe Tokën.

Sipas një transmetimi Allahu i Madhërishëm ka

ndërtuar Bejtul Ma'mur nën Arsh dhe i ka urdhëruar melaiket që të bëjnë tavaf rreth saj. Pastaj Allahu i ka urdhëruar melaiket që gjendeshin në tokë të ndërtonin një faltore të ngjashme me faltoren e qiellit dhe të bënin tavaf rreth saj sikurse bënin tavaf banorët e qiellit rreth Bejtul Ma'murit. Melekët kanë ndërtuar Qabenë me mijëra vjet para së të krijohet Ademi a.s. Kur Ademi, pas një kohe që ka kaluar në xhennet, është zbritur në Tokë, melekët i kanë thënë: "Bëj tavaf rreth kësaj faltore sepse ne jemi duke bërë tavaf në të që 2000 vjet. Ademi i ka dëgjuar melaiket dhe ka filluar të bëj tavaf. Këtë e kanë bërë edhe pasardhësit e tij deri në kohën e Nuhut. Në kohën e Nuhut a.s., kur është përmbytur Toka, Qabeja është ngritur në qiell. Ajo është ruajtur nga përmbytja. Më pas është rindërtuar nga Ibrahim - babai i besimit, ndërsa me ardhjen e Muhammedit a.s. është pas-truar përfundimisht nga të gjithë idhujt.

Në një rast Pejgamberi i pyeti as'habët: "A e dini ç'është El-Bejtul Ma'mur (faltorja qiellore e banuar dendësisht)?" As'habët u përgjigjen: "Këtë e dinë më mirë All-llahu dhe Pejgamberi i Tij". Pejgamberi a.s. u tha: "Ajo është shtëpia në qiellin e shtatë (nën Arsh), e cila gjen-



det saktësisht përmbi Qabe. Çdo ditë në të hyjnë 70 mijë melaqe dhe nuk kthehen më."

QABEJA QENDËR E ENERGISË SHPIRTËRORE

Në drejtim të Qabesë lirohen energji të mëdha shpirtërore nga miliona besimtarë ditë e natë gjatë faljes në namaz. Prandaj ajo është qendër tërheqjeje ku graviton e gjithë forca e tyre shpirtërore dhe më pas ajo e shpërndan atë energji në formë ta valëve magnetike në të gjitha anët, fuqia e së cilës ndihet deri në skajet më të largëta të botës muslimane. Qabeja është epiqendra shpirtërore, morale, fetare e hapësinore e fesë islame dhe atdheu shpirtëror i çdo muslimani. Në drejtim të saj ndërtohen mihrabët e të gjitha xhamive dhe kthehen fytyrat e gjithë muslimanëve të botës gjatë faljes. Por, në drejtim të saj madje duhet të kthehen jo vetëm fytyrat dhe kraharorët tanë, por edhe zemrat, shpirtrat, mendjet dhe mendimet t o n a . Muslimani duhet të jetë i vetëdijshëm që të gjitha pikat në tokë, me linja të padukshme, janë të lidhura me qendrën unike, Qabenë, në drejtim të së cilës e kthen pesë herë në ditë në namaz fytyrën e vet. Shtëpia e Zotit gjatë gjithë kohës është nikoqire e miliona besimtarëve të sinqertë të cilët me vite të tëra kanë qenë në pritje të vizitës së këtij vendi të shenjtë.

Haxhi

Haxhi zhvillohet në një pikë të caktuar gjeografike, në Mekë, dhe në një kohë të caktuar. Ai është udhëtim dhe shkuarje me qëllim dhe çdokush që lëviz në këtë rrugë, me përpjekje dhe devotshmëri, arrin lumturinë dhe të vërtetën. Haxhi është përgjigje ndaj thirrjes së Ibrahimit të bërë qysh prej mijëra vitesh, një zë që jehon nëpër kohë dhe që zë vend në zemrën dhe shpirtin e miliona besimtarëve. Ky lum i qenieve njerëzore nuk është shterur kurrë. Nëpër shekuj, ata kanë ardhur me numër të madh nëpër "Derën e Shpëtimit (Babu Selam)", duke thënë: "Lebbejke All-llahumme lebbejk" - "Të përgjigjem o Allahu im, të përgjigjem ...!" "Të përgjigjem Ty, që je Një dhe i Vetëm ...". Haxhi është një mundësi për të gjithë besimtarët që nga të gjitha anët e ndryshme të botës të shpejtojnë drejt Qabesë së shenjtë që me pendim dhe lutje të pastrojnë trupin dhe shpirtin nga mëkatet dhe, kur të kthehen, të kthehen në vendin e tyre si të rilindur.

Ai ofron një pamje imponante me njerëz me ngjyra dhe pamje të ndryshme, të cilët në haxh janë të barabartë dhe nuk ka asnjë dallim mes tyre, ashtu sikurse në Ditën e Ringjalljes kur njerëzit do të qëndrojnë të barabartë para Allahut duke pritur fatin e tyre, kur nuk do të merret parasysh prejardhja, raca dhe ngjyra e tyre dhe ku dallimi i vetëm do të varet nga niveli i devotshmërisë.

Haxhi është kthim drejt Burimit dhe udhëtim në kërkim të zbulimit të identitetit shpirtëror. Ky identitet shpirtëror i cili i mungon njeriut të sotëm është një nevojë jetike dhe qëndron mbi të gjitha identitetet e tjera sepse në mungesë të tij, ai rrezikon të ardhmen e vet.

RRETH CITATEVE TË DOKTRINËS SË TRINITETIT

Triniteti dhe vërtetësia e tij (2)

“Më 1690 Isak Njutoni (1642-1727) shkroi një dorëshkrim mbi korruptimin e tekstit të Dhiatës së Re, sa u përket citateve të 1 Gjoni 5:7 dhe 1 Timoteu 3:16, titullohej “A Historical Account of Two Notable Corruptions of Scripture” (Një llogari historike e dy korruptimeve të shquara të shkrimeve).”

Senad Maku - Ulqin

Këta të tre janë një. (1 Gjoni 5:7)

Këtu kemi të bëjmë me një citat tjetër të 1 Gjoni 5:7-8, të cilin e gjejmë në tri përkthime të ndryshme. Sipas Biblës, Diodati i Ri, përkthim 1991-1994, është kështu: “sepse tre janë ata që dëshmojnë në qiell: Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjtë, dhe këta të tre janë një”.

Sipas Biblës që e përktheu Dom Simon Filipaj është kështu: “Kështu, tre janë ata që dëshmojnë: Shpirti i shenjtë, uji dhe gjaku. Këta të tre bëjnë një dëshmi të vetme”.

Te shkrimet e shenjtja, përkthim nga “Bota e Re”, shkruan kështu: “Sepse tre janë ata që japin dëshmi, fryma, uji dhe gjaku, dhe që të tre janë në përputhje me njëri-tjetrin”.

Këtu shohim një dallim ndërmjet citateve të Biblave të ndryshme. Citati i lartpërmendur (Ati, fjala dhe fryma e shenjtë dhe këta të tre janë një) nuk paraqiten në asnjë nga dorëshkrimet e vjetra të Biblës, por janë shtuar më vonë me qëllim që të mbështetin doktrinën false të trinitetit. Megjithatë, dijetarët e dinë se fjalët e tilla janë false dhe në përkthimet e sotme të Biblës i lënë jashtë.

Citati “Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjtë dhe të tre këta janë një”, gjendet në versionin e mbretit Xhejms, botuar në vitin 1916 dhe në atë kohë përbënte njëri ndër bazat më të forta për doktrinën e trinisë. Por tani, kjo pjesë është hequr nga “Revised Standard Version”, i vitit 1952 dhe 1971, si dhe nga mjaft Bibla të tjera, pasi kishte depërtuar gabimisht në tekstin grek.

Pra, këtu kemi përsëri të bëjmë me

fjalën “Një”, sikurse e shqyrtoam më parë te citati “Unë dhe ati jemi një” (Gjoni 10:30), duke shikuar edhe citatet e biblave të tjera, këtu kuptojmë se fjala “Një”, nuk do të thotë unitet duke aluduar në trinitet, por në një qëllim, në një veprim, rreth një dëshmie të vetme, apo që janë në përputhje me njëri-tjetrin. P. sh., nëse tre persona në gjyq japin deklaratë të njëjtë, nuk do të thotë se tre personat janë i njëjti person, por dëshmia e tyre është e njëjtë. Mirëpo, këtu shihet qartë se është një shtim i citatit në Bibël, me qëllim të mbështetjes sipas tyre të Doktrinës së Trinitetit.

Më 1690 Isak Njutoni (1642-1727) shkroi një dorëshkrim mbi korruptimin e tekstit të Dhiatës së Re, sa u përket citateve të 1 Gjoni 5:7 dhe 1 Timoteu 3:16, titullohej “A Historical Account of Two Notable Corruptions of Scripture” (Një llogari historike e dy korruptimeve të shquara të shkrimeve). Lidhur me citatin 1 Gjoni 5:7, Njutoni thotë se ky varg për herë të parë është shfaqur në edicionin e tretë të Dhiatës së Re, tek Erasmusi.

“Kur ata krijuan Trininë; në edicionin e tij ata futën gjëra nga dorëshkrimi i tyre, në qoftë se ata kishin një të tillë, si një almanak që i ka kaluar koha. Dhe a ka mundësi që këto metoda jo të pastra ta kënaqin një njeri të arsyeshëm?... Është më tepër rrezik se sa avantazh në besim, që ta bësh atë të mbahet në një kallam të thyer”.

Këtë citat nuk e kanë biblat e botuara të mëparshme, si: “The revised standard version”, “The new revised standard version”, “The new american standard bible”, “The new english bible”, “The philips modern english bible”, e shumë të tjerë. Përse kështu? Përkthyesi Benjamin Willson bën këtë sqarim: “Ky tekst nuk gjendet në

asnjerin prej shkrimeve greke që është shkruar para shekullit XV. Nuk është cituar prej asnjë autori, as prej etërve të hershëm latinë... “. Po ashtu edhe dr. Herbert W. Amstrog pajtohet me atë se ky verset është shtim, sepse nuk gjendet në shkrimet greke.

Lidhur me këtë një hulumtues përfundon: “Mua nuk më duket se doktrina e trinitetit nuk ka të bëjë vetëm me themelet e besimit të krishterë; meqë nga faktet del qartë se lidhur me të nuk gjejmë të shkruar asgjë të drejt-përdrejtë në Dhiatën e Re; ndërsa i vetmi pasazh ku bëhet fjalë për tre që janë dëshmitarë (1 Gjoni 5:7) është pa dyshim i rremë dhe stili i të shkruarit i tij, krejt i panatyrshëm, dëshmon për faktin se sa e huaj është një përmbledhje e tillë nga stili i shkrimeve të Dhiatës së Re”.

Perëndia u shfaq në mish. (1 Timoteu 3:16)

Një citat tjetër, në të cilin, sipas të krishterëve, mbështetet doktrina e trinitetit është te 1 Timoteu 3:16: “Perëndia u shfaq në mish”, (Bibla-Diodati i Ri), që tregon se si Perëndia u shfaq në mish, u bë njeri. Po ta shohim të njëjtin citat te Bibla e Dom Simon Filipajt, na del se Jezusi erdhi në natyrën e njeriut, e jo Perëndia: “Krishti u dëftua në natyrën e njeriut”. Kurse te Bibla, shkrimet e shenjta, shkruan: “Ai u shfaq në mish” (Këtu aludohet në Jezusin).

Vërehet qartë dallimi ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit; në citatin e parë tregohet Perëndia, ndërsa në dy librat tjera fjalë është për Jezusin. Çfarë ndryshimi i madh!

Në manuskriptet e vjetra nuk qëndron “Perëndia u shfaq në mish”, veçse “Ai u shfaq në mish”, por zbulimi i manuskripteve të vjetra e vuri në pah mashtrimin e bërë. William Miller thekson: “Zoti nuk ka një trup si të njeriut dhe Ai nuk është i kufizuar në një vend, apo në një kohë, por është gjithmonë kudo i pranishëm”.

Bart Ehrman lidhur me këtë citat biblik thotë: “Në Kodikun Aleksandrin, që tashmë gjendet në Bibliotekën Britanike (British Library), arritëm në përfundimin se te 1 Timoteu

3:16, ndërkohë që shumica e dorëshkrimeve të vonshme flisin për Krishtin si “Perëndi i shfaqur në mish”, ky dorëshkrim i hershëm e përshkruan Krishtin si ai, “i cili u bë i shfaqur në mish”. Në gjuhën greke ndryshimi është shumë i vogël. Dallimi qëndron mes një *thete* dhe një *omikroni* që grafikisht ngjajnë, pak a shumë, kështu: **Θ** dhe **Ο**. Skribët e mëvonshëm e kanë ndryshuar tekstin fillestar, ndaj edhe tani aty nuk lexojmë më “i cili”, por “Perëndi” (i shfaqur në mish). Me fjalë të tjera, një korrigjues i mëvonshëm e ka ndryshuar tekstin në atë mënyrë që ta vërë në pah sa më mirë hyjninë e Jezusit”.

Perëndia i ngjashëm me njeriun. (Zanafilla 1:26)

Te Zanafilla 1:26 shkruan: “Perëndia tha: *Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne ...*”.

Gjithashtu, mundohen që ta argumentojnë doktrinën e tyre me këtë citat, kinse Jezusi është Zot dhe se Zoti u bë njeri në formën e Jezusit. Sipas citatit këtu tregohet në përgjithësi se si njerëzit janë sipas shëmbëlltyrës së Zotit, d.m.th. ne i ngjajmë Zotit (I pastër është Zoti nga shpifjet e tyre).

Shtrohet pyetja: Nëse Zoti është në ngjasim me ne, apo ne jemi të ngjashëm me Zotin? Nëse mendojmë pakëz, del se Zoti sipas Biblës na qenka në shumë forma, sepse ndër njerëz ka të bardhë, të zinj, të kuq, të verdhë, ka njerëz të gjinisë femërore dhe mashkullore etj. Në cilin grup të njerëzve hyn Zoti?! Këtu shihet një shpifje e madhe, një trillim që i bëhet Zotit të Plotfuqishëm. Kur i lexojmë citatet e tjera të Biblës, hasim në kontradiktë ndërmjet teksteve dhe njëherësh e kundërshton citatin e lartpërmendur. Pasi gjinden shumë citate që i kundërvihen citatit që sapo e përmendëm, ne do t'i paraqesim vetëm dy prej tyre.

Profeti Jeremia e kundërshton këtë citat duke thënë: “Askush nuk është i ngjashëm me ty, o Zot ... nuk ka njeri të ngjashëm me ty”. (Jeremia 10:6-7) Por edhe Jezusi e kundërshton, kur thoshte: “Ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij”. (Gjoni 5:37)

Këtu shihet qartazi mënyra e manipulimit të njerëzve me Biblën.

Në njërën ndër enciklopeditë e njohura të religjionit, lidhur me këtë çështje, pohohet: “Sot teologët janë të një mendjeje se Bibla hebraike nuk përmban ndonjë doktrinë të trinitetit, edhe pse ishte e zakonshme që në tekstet dogmatike të së kaluarës lidhur me trinitetin të citoheshin tekste të ngjashme me ato të Zanafillës 1:26, “*Le ta bëjmë njerëzimin të ngjashëm me ne, sipas shëmbëlltyrës sonë.*” (Shih gjithashtu Zanafilla 3:22, 11:7; Isaia 6:2-3) si një provë e shumësisë së zotave. Edhe pse Bibla hebraike e paraqet Zotin si Atin e Izraelit dhe përdor edhe personifikime të Zotit si: fjala (davar), shpirti (ruah), urtia (hokhmah) dhe prania (shekinah), do të dilte përtej qëllimit dhe frymës së Dhiatës së Vjetër lidhja e këtyre koncepteve me doktrinën e mëvonshme trinitare.

Në një tjetër enciklopedi të njohur gjendet edhe kjo shprehje: “Vështirë se mund të gjenden gjurmë të trinitetit në Dhiatën e Vjetër...” Së fundmi nuk do ta lëmë pa e përmendur Levi Leonard Painen, profesor i historisë kishtarë, i cili në njërën nga veprat e tij shprehet: “Dhiata e Vjetër është rreptësisht monoteiste. Perëndia është një genie më vete, një person i vetëm. Ideja që në të gjendet një trinitet...është krejtësisht pabazë”

Unë jam në Atin, Ati është në mua. (Gjoni 14:11)

Gjoni tregon se si Jezusi tha: “*Më besoni se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua.*” (Gjoni 14:11)

Disa citate më poshtë, përsëri nga ungjilli i Gjonit, pohojnë se Jezusi tha për dishepujt: “*që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, që je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne.*” (Gjoni 17:21)

Pra, këtu tregohet se si Zoti dhe Jezusi janë një, por gjithashtu edhe dishepujt janë një në Jezusin dhe Zotin, sepse ai është në Zotin. Në qoftë se Jezusi është zot, pse atëherë nuk janë edhe dishepujt zot, duke qenë se edhe ata janë si Jezusi, janë perëndi? Nëse Ati, Jezusi dhe shpirti i shenjtë,

janë në trininë, atëherë po qe se do t'i përfshinim edhe dishepujt, bashkësia perëndi do të përbëhej nga pesëmbëdhjetë veta.


Po ashtu te Gjoni 14:20 thuhet: “*Atë ditë do të mësoni se unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju.*” Dhe te Efesianëve 4:6 thuhet: “*një Perëndi i vetëm dhe Atë i të gjithëve, që është përmbi të gjithë, në mes të të gjithëve dhe në ju të gjithë.*”

Askush nuk tha se apostujt apo efesianët janë zota, sepse madhështimi, poshtërimi, dashuria, etj., që u përshkruhen më të ulëtëve, u përshkruhen të lartëve në mënyrë metaforike, prandaj Jezusi, për apostujt në ungjillin e Mateut 10:40, tha: “*Ai që ju pranon, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar.*”

Unë jam! (Gjoni 8:58)

Referimi i të krishterëve për të mbrojtur tezën e tyre sipas së cilës Jezusi është Zot, i referohen citatit, në të cilin Jezusi thotë se ishte para Abrahamit me fjalën “Unë jam”, te Gjoni 8:58: “*Jezusi u tha atyre: ``Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam``.*”

Nëse Jezusi është Zot për



arsye se tha që ishte para Abrahamit, çka do të thoshim edhe për të tjerët që ishin më parë se Abrahami, bile edhe para krijimit të maleve dhe burimeve, para krijimit të tokës, siç e cek Bibla për Solomonin, Melkisedekun, Jereminë, Kirin e shumë të tjerë. Ja disa citate biblike të të përmendurve:

“Sepse ky Melkisedeku, mbret i Salemit dhe prift i Shumë të Lartit Perëndi... Pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete, por i përngjashëm me Birin e Perëndisë, ai mbetet prift në amshim”. (Hebrenjve 7:1,3)

“Para se unë të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet i kombeve”. (Jeremia 1:5)

“Kështu i thotë Zoti të vajo-surit të tij, Kirit, që unë e mora me dorën e djathtë, që të hedh poshtë para tij kombet: Po, unë do të zgjidh brezat që mbretërit mbajnë në ijë, për të hapur para tij”. (Isaia 45:1)

Pra, siç pamë te citatet e lartpërmendura, a mund të themi se edhe këto janë zota? Jo, por fjala e përmendur e Jezusit “Unë jam”, nuk do të thotë se është Perëndi. Për ta krahasuar shprehjen “unë jam”

do ta cekim të njëjtën fjalë te Gjoni 9:9, ku lypësi e përdori këtë fjalë, pasi që Jezusi e shëroi nga verbëria, a mund të themi se edhe lypësi ishte Zot? *Disa thoshin: “Ai është”. Të tjerë: “I përngjan atij”. Dhe ai thoshte: “Unë jam”.*

Një nga librat e krishterë me titull “Bazat e Biblës” thekson: “Vetë përshkrimi i Marisë në ungjill si “nëna” e Krishtit, e shkatërron në vetvete idenë se ai ekzistoi përpara lindjes së tij nga Maria”.

Zoti Jezus! (Marku 16:19)

Në ungjillin e Markut 16:19 thuhet: *“Zoti Jezus, pra, mbasi u foli, u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë”.* Ndërmjet fjalës “Zoti Jezus”, siç e cek Diodati i Ri, dhe asaj te Bibla e Dom Simon Filipajt e te Shkrimet e Shenjta, ku e gjejmë të potencuar si “Zotëria Jezus”, kemi një dallim.

Së dyti, nëse Jezusi është Zot, si ulet zoti te Zoti? Mirëpo, nëse Jezusi është pjesë e trinitetit, po shpirti i shenjtë ku ulet në qiell, pasi që pranë Perëndisë është vetëm një vend; në të djathtën e Perëndisë? Nëse të krishterët mendojnë se fjala “Zot” apo “Zotëri”, që i është referuar Jezusit, është e njëjtë dhe megjithatë mundohen ta

mbrojnë tezën e tyre, atëherë ç’të bëjmë kur në Bibël kemi personalitete të ndryshme të cilat quhen “Zotëri”. P. sh. fjala “Zotëri” përdoret për Esaun, i cili quhej Zotëri (shih Zanafilla 32:4), pastaj edhe Jozefi u quajt Zotëri (Zanafilla 44:20), Davidi po ashtu, bile Davidi quhet edhe “imzot” që do të thotë “Zoti im” (a mund të themi për të se është Zot?) (1 Samueli 25:24) e shumë të tjerë.

Pra, a mund të themi se këta janë zota? Jo, sepse fjala “Zotëri” nuk aludon në “Zot”.

Po ashtu Bibla na tregon se fjala Zot është përdorur edhe në vend të emrit Zotëri dhe jo për Krijuesin e qiejve dhe tokës. Në rastin e Marisë kur shkon tek varri, Maria mendon se është kopshtari dhe i thotë zot, po kështu edhe priftërinjtë e emërtojnë Pilatin zot. Pra, kjo tregon qartë se fjala Zot në Bibël, kur iu drejtohet njerëzve si Jezusit, Pilatit etj. ka kuptimin zotëri dhe jo Perëndi. Le t’i referohemi Biblës lidhur me këto argumente:

“Jezusi i tha: “O grua, pse po qan? Kë kërkon?”. Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha: “Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr”. (Gjoni 20:15)

“Dhe të nesërmen, që ishte mbas ditës së Përgatitjes, krerët e priftërinjve dhe farisenjtë u mblodhën te Pilati, duke thënë: “Zot, na ra në mend se ai mashtruesi...”. (Mateu 27:62-63)

Sikurse thuhet te Korintasve: *“Po a nuk e pashë Jezu Krishtin, Zotërinë tonë?”.* (1 Korintasve 9:1)

Sipas R. P. Roge, vargjet 16:19 të ungjillit të Markut, përbëjnë një tekst “të shtuar më vonë”, edhe pse për kishën është kanonik! Vargjet 9 deri në 20 të kapitullit të 16 në ungjillin e Markut, janë hequr nga mjaft Bibla. Shih në shënimet në “Revised Standart Version”, “New American Standard Bible”, “New World Translation of Holy Scriptures”.

Nëse, vërtet, sipas citatit besohet se Jezusi ishte i shenjtë, ngaqë u ngrit në qiell, pse nuk pranohen si të shenjtë edhe ata profetë të tjerë, të cilët po ashtu u ngritën në qiell? Shih p.sh. te 2 Mbretërve 2:11-12: *“... dhe Elija u ngrit në qiell përmes një shtjelle ajri. Elisha e pa dhe thirri... E më ai nuk e*

pa... “. Po kështu Perëndia ngriti në qiell edhe Enokun: *“Pra Enoku eci me Perëndinë, por nuk u gjend më, sepse Perëndia e mori me vete”.* (Zanafilla 5:24) Kjo përsëritet edhe te Hebrenjve 11:5.

Adhurimi i Jezusit. (Mateu 28:17)

Shprehja se “Jezusi është Zot” arsyetohet me atë se populli e kanë adhuruar atë, siç ceket te Gjoni 9:38 dhe Mateu 28:17, ku thuhet: *“Atëherë ai tha: ‘Unë besoj, o Zot’; dhe e adhuroi”.* *“dhe, kur e panë, e adhuroan; por disa dyshuan”.*

Fjala e përkthyer si “adhurim” apo “lutje” është fjala greke “Prosekunesan” e nxjerrë nga fjala “Proskuneo” (Pros-ku-neh’o), letrarisht e ka kuptimin e “të puthurit”. Kjo fjalë gjithashtu ka domethënie të përgjithshme, si: përsëhendetje, kruspullim, zgjatje e fjalës, gjuhëzim, apo i shtrirë përdhe. Në këtë rast është akt i të puthurit të dorës së dikujt, në shenjë të adhurimit ndaj tij.

Nëse e marrim Biblën - shkrimet e shenjta, do të vërejmë se nuk përputhet me citatin e lartpërmendur, sepse fjala “adhurim” këtu ceket me fjalën “nderime”. Citati është kështu: *“atëherë ai i tha: Unë tregoj besim tek ai, Zotëri. Dhe i bëri nderime”.* Kurse citati tjetër te Mateu 28:17 është kështu: *“Kur e panë, ata i bënë nderime, por disa dyshuan”.* Këtu shihet qartazi ndryshimi ndërmjet fjalës “adhurim” dhe “nderime” dhe përkthimi i tyre gabim, diku si “adhurim” e diku si “ra përmbys”.

Shprehje të tilla biblike nuk i referohen vetëm Jezusit, por edhe të tjerëve, si p.sh:

“Kur Abigaili pa Davidin, zbriti shpejt nga gomari dhe ra përmbys me fytyrën për tokë përpara Davidit. (1 Samueli 25:23)

“Ajo hyri dhe u hodh në këmbët e tij, duke u shtrirë për tokë; pastaj mori djalin e saj dhe doli”. (2 Mbretërve 4:37)

“Pastaj erdhën edhe vëllezërit e tij dhe u shtrinë para tij, dhe i thanë: “Ja, ne jemi shërbëtorët e tu”. (Zanafilla 50:18)

A mund të themi që edhe këta janë perëndi, sepse njerëzit ranë përmbys përpara tyre, me fytyrë për toke?



SHMI "Medreseja Isa Beu"-Shkup

Shkolla e Mesme Islame "Medreseja Isa Beu" në Shkup ka një sipërfaqe prej 7000 m² prej të cilave nën objekt 3500 m². Nga viti 1984 e deri më tani gjithsej janë regjistruar 3400 nxënës prej të cilëve e kanë kryer 1300 nxënës. Medreseja ka qenë dhe mbetet e hapur edhe për nxënës nga jashtë vendit, deri më tani Medresenë e kanë kryer edhe 60 nxënës nga Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Mali i Zi, Bosnja, Sanxhaku dhe Lugina e Preshevës.

Medreseja Isa Beu me paralelet e saja të shtrira për gjininë femërore në Shkup, Tetovë dhe Gostivar si dhe me paralelen e shtrirë për meshkuj në Shtip (gjithsej me 25 klasa), punon në përmbushjen e nevojave të muslimanëve të vendit tonë dhe më gjërë. Tanimë numri i përgjithshëm i nxënësve të rregulltë të Medresesë Isa Beu arrinë mbi 600 nxënës.

Rijaseti i BFI-së, pas një angazhimi të madh përmes investimeve rreth përmirësimeve të ambienteve të Medresesë arriti që këtë shkollë përsëri ta radhit ndër shkollat më të bukura në RM.



Nxënësit e Medresesë Isa Beu falenderojnë dhe lusin Allahun Fuqiplotë t'i shpërblen të gjithë ata që përmes Sadekatul-fitrit, Zeqatit, kurbanëve, lëkurave të kurbanëve dhe ndihmave të tjera vullnetare, ndihmuan dhe inshallah do të ndihmojnë në kultivimin dhe zhvillimin e jetes fetare islame, respektivisht mirëmbajtjen e institucioneve arsimore-islame në vendin tonë, pra SHMI "Medreseja Isa Beu" dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup.

**Allahu xh.sh. ua
pranoftë ibadetet.**

**Urime
Fitër Bajramin**